

VENDIM
Nr. 00-2024-5438(191), datë 18.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Margarita Buhali	kryesuese;
Vojsava Kola	anëtare;
Sokol Ngresi	anëtar;
Enton Dhimitri	anëtar;
Valbon Çekrezi	anëtar,

Sot më datë 18.4.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr. 11243-01311-00-2016 Regjistri Themeltar, datë regjistrimi 21.4.2016, që i përket:

PADITËS: Haxhi Nezha.

I PADITUR: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.).

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

OBJEKTI: Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike me nr. F-138694, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, për sasinë prej 10.000 KWh, në vlerë totale 146,400 lekë e faturuar si energji e pamatur pasi detyrimi nuk ekziston.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 50, 154, 510/e, 609, të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001, nenet 45,46,51,52, të ligjit nr. 9072, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008, vendim nr. 49, datë 21.10.2004, i Entit Rregullator të Energjisë “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik”.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

- pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Margarita Buhali;
- paditësin që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë;
- pretendimet me shkrim të avokaturës së shtetit, që kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe rrëzimin e padisë;
- në mungesë të palës së paditur të njoftuar rregullisht nga kjo Gjykatë;
- dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit dhe referuar fakteve të pranuar nga gjykatat rezulton se paditësi Haxhi Nezha, si abonent jofamiljar, ka lidhur një kontratë furnizimi nr. 138694, me palën e paditur shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., sot Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group (këtu e në vijim OSHEE Group sh.a.) për furnizimin me energji elektrike të lokalit që ka në fshatin Jeta e Re, Lushnjë. Sipas kontratës rezulton se furnizuesi (i padituri) ka marrë përsipër që të furnizojë paditësin me energji elektrike dhe ky i fundit të paguajë detyrimin e shprehur në faturën mujore sipas energjisë elektrike të harxhuar efektivisht. Për të matur energjinë elektrike pala e paditur ka vendosur aparate

matëse të energjisë elektrike. Palët kontraktuese kanë qenë korrekte me njëra tjetrën në përmbushjen e detyrimeve kontraktore të ndërsjella.

2. Në datën 20.10.2011, pala e paditur ka ushtruar kontroll në lokalitetin e paditësit Haxhi Nezha në fshatin Jeta e Re. Për këtë kontroll është mbajtur procesverbali me numër serie 0066095, i cili nuk ka nënshkrimin e palës paditëse. Sipas këtij procesverbali rezulton se tek abonenti Haxhi Nezha, gjatë kontrollit është konstatuar një linjë e dytë, në momentin që limitatori ishte i stakuar ekspresi i kafesë në ambient rezultonte me energji elektrike. Në procesverbal është konstatuar se dëmi ekonomik është 20.000 kwh.

3. Mbi bazën e këtij procesverbali të mbajtur në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur, pa prezencën e palës paditëse, shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., në datën 8.11.2011 i ka faturuar si energji të pamatur dëmin ekonomik 10,000 kwh për periudhën 13.10.2011–30.10.2011 në shumën 146.400 lekë, paditësit Haxhi Nezha.

4. Pala paditëse Haxhi Nezha, duke mos qenë dakord me këtë faturim, ka investuar me padi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv që është fatura e energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011.

5. Në përfundim të këtij gjykimi, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 458 (64-2014-1105), datë 7.7.2014, ka vendosur:**

“Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësi Haxhi Nezha.

Heqjen e detyrimit të parashikuar në faturën tatimore të shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, si energji e pamatur në shumën 146,400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë, që i ka faturuar pala e paditur Shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., palës paditëse Haxhi Nezha, adresa fshati Jeta e Re. (...)”

6. **Në vendimin e mësipërm, kjo gjykatë ka arsyetuar,** në formë të përmbledhur ndër të tjera se; Me ndryshimet që i janë bërë ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008 është shfuqizuar neni 46/c, i cili i jepte kompetencë të paditurit që të vendoste masa administrative në rast konstatimi të shkeljeve të ndryshme nga abonentët, po kështu është shfuqizuar dhe neni 46/1, i cili përcaktonte masën e gjobës për llojin e shkeljes, mënyrën e vjeljes së gjobës si dhe dëmin ekonomik. Në këto kushte gjykata konstaton se pala e paditur nuk mund të përcaktojë në faturë tatimore shitje dëmin ekonomik si titull ekzekutiv, por në rast se kjo palë ka pretendime lidhur me shkaktimin e ndonjë dëmi për parregullsi të vulave të matësve apo furnizimin me një linjë të dytë nga paditësi, duhet t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi me objekt shpërblimi dëmi ekonomik dhe jo ta përfshijë këtë dëm ekonomik të pretenduar prej saj në një faturë tatimore shitje të energjisë elektrike e cila është titull ekzekutiv.

6.1 Legjislatori ka përcaktuar se fatura tatimore që lëshon i padituri shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a. është një faturë tatimore shitje e energjisë elektrike, ku përcaktohet vetëm sasia e energjisë elektrike e shprehur në kwh dhe në lekë që ka konsumuar abonenti. Fakti që i padituri nuk duhet të faturojë në faturën e energjisë elektrike dëmin ekonomik rezulton dhe nga vendimi nr. 90, datë 15.11.2010 i Entit Rregullator i Energjisë Elektrike ku janë konsideruar të paligjshme faturimet e kryera nga i padituri shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a. ndaj klientëve familjarë dhe jofamiljarë, me emërtim “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur” pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008. Në këto rrethana vlerësohet nga gjykata se fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, ku përcaktohet dëmi ekonomik në shumën 10,000 kwh, e faturuar nga i padituri për paditësin Haxhi Nezha në shumën totale 146,400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë është e pavlefshme, pasi dëmi ekonomik nuk mund të faturohet me faturë tatimore shitje të energjisë elektrike e cila është titull ekzekutiv.

6.2 Titull ekzekutiv është fatura e energjisë elektrike që përcakton vetëm energjinë e konsumuar dhe jo dëmin ekonomik siç ka pretenduar dhe në gjykim pala e paditur.

6.3 Pala e paditur ka pretenduar se në bazë të nenit 51, pika 14, të ligjit nr. 10362, datë 16.12.2010, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” shprehimisht parashikohet: “Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”. Dhe ERE në zbatim të këtij ligji ka miratuar metodologjinë e përcaktimit të dëmit. Gjykata vlerëson se ky nen përcakton mënyrën e llogaritjes së dëmit në rast se shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.i shkaktohet ndonjë dëm dhe nuk përcakton se dëmi ekonomik është titull ekzekutiv.

6.4 Nga sa më sipër gjykata konkludon se titulli ekzekutiv që është fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, që i padituri i ka faturuar paditësit Haxhi Nezha, në rubrikën energji e pamatur 10,000 kwh në vlerën 146 400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë është i pavlefshëm, pasi titull ekzekutiv është faturimi i energjisë elektrike i konsumuar dhe jo dëmi ekonomik.”

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ka paraqitur ankim pala e paditur OSHEE sh.a., duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Gjykatës është rezultat i një gjykimi të padrejtë, i pabazuar në prova dhe pa marrë në shqyrtim pretendimet tona.

- Gjykata ka bërë një interpretim të gabuar të akteve të mbajtura nga pala e paditur në gjykim.

- Gjykata nuk e ka bazuar vendimin e saj mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor në kundërshtim me nenin 10 të KPC-së duke dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin.

- Vendimi i Gjykatës nuk është i drejtë pasi në këtë mënyrë ka cenuar CEZ Shpërndarje sh.a. në zbatimin e ligjit “Për energjinë elektrike”, si dhe vendimit nr. 42, datë 22.4.2011 të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.

- Dëmi ekonomik i vendosur ndaj klientit është si pasojë e konstatimit të parregullsive në mënyrën e furnizimit me energji elektrike.

- Faturimi i bërë ndaj paditësit është një faturim i drejtë dhe konform të gjitha dispozitave ligjore.

- Paditësi nuk arriti të provojë pavlefshmërinë, shuarjen e detyrimit apo ekzistenca e një masë më të vogël. Në këto kushte fatura e konsumit të energjisë elektrike e datës 8.11.2011 për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011 për kontratën nr. 138694 përbën titull ekzekutiv dhe është detyrim real i paditësit.

- Përfundimisht kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e plotë të padisë si të pa bazuar në prova dhe ligj, shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit.

8. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 117, datë 9.2.2016, ka vendosur:

“Lëniën në fuqi të vendimit nr. 458 (64-2014-1105), datë 7.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.”

8.1 Në vendimin e mësipërm kjo gjykatë ka arsyetuar, në formë të përmbledhur ndër të tjera se: Është e vërtetë se para ndryshimit të legjislacionit në fushën e energjisë elektrike përcaktohej se në rast të konstatimit të disa parregullsive, furnizuesi vendoste masa administrative, që përfshinte caktimin e një gjobe dhe të një dëmi të caktuar, që mendohej se i ishte shkaktuar entit shpërndarës, porse kjo dispozite ligjore është shfuqizuar që në muajin shtator të vitit 2008, me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008. Pra me ndryshimin e ligjit nuk ekziston me hapësira ligjore për të mundësuar detyrimin e abonentit për ngarkim me një dëm, dhe me të drejtë gjykata ka konkluduar që as në kontratë nuk mund të përcaktohet një e drejtë e tillë, dhe në vijim të kësaj as në faturën përkatëse të energjisë nuk mund të parashikohet një element i tillë.

8.2 Po kështu drejt ka vepruar gjykata edhe kur ka rrëzuar pretendimin e palës së paditur se paditësi i ka shkaktuar dëm, dhe se në bazë të nenit 608 të KC-së atyre ju lind e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Përfundimi i Gjykatës se pala e paditur, ka përlogaritur një dëm ekonomik, që ia ka faturuar paditësit, pa e pasur këtë të drejtë më në bazë të ligjit, është i drejtë. Në këtë rast pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke i ngarkuar paditësit, një detyrim që nuk ekziston, pasi një

detyrim i tillë jo vetëm që nuk provohet se duhet t'i ngarkohet abonentit për shkak të ndonjë veprimi të padrejtë të kryer prej tij, por as nuk mund të vendoset me nga vetë pala e paditur CEZ sh.a.

8.3 Duke iu referuar mosmarrëveshjes në këtë gjykim nuk kemi të bëjmë me rastin e parashikuar nga pika IV.9 e Kodit të Matjes, pasi ajo aplikohet vetëm kur konstatohen pasaktësi në sistemin e matjes dhe jo ndërhyrje të kundërligjshme në sistem, sikurse është rasti konkret. Po kështu, ndryshe nga sa pretendohet në ankim, pala e paditur nuk ka të drejtë që me cilësinë e furnizuesit të legjitimohet të vendoste detyrime ekonomike në mënyrë të njëanshme qoftë në procesverbalin e konstatimit të dëmit apo edhe në faturën e energjisë elektrike për abonentin familjar dhe jofamiljar.

8.4 Në qoftë se pala e paditur ka konstatuar dëm ekonomik në veprimet e paditësit mund t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen ligjore të mosmarrëveshjes në lidhje me dëmin e pretenduar si të shkaktuar prej saj. Si përfundim Gjykata e Apelit, çmon se dëmi ekonomik, që në rastin konkret është vendosur si masë administrative për shkak të furnizimit jashtë kushteve teknike, nuk ka bazë ligjore dhe për pasojë vendosja e të ashtuquajturit "Dëm ekonomik", i vendosur në faturën e energjisë së muajit tetor 2011 për abonentin jofamiljar Haxhi Nezha, është i paligjshëm, duke sjellë si pasojë që edhe fatura konkrete si titull ekzekutiv për këtë pjesë të jetë e paligjshme.

9. Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur Shoqëria CEZ Shpërndarje" sh.a. (sot Shoqëria OSHEE Group sh.a.), i cili kërkon: *"Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë"*, duke parashtruar shkaqet si vijon:

- Paditësi Haxhi Nezha është abonentë i shoqërisë tonë me kontratën nr. 138694. Paditësi kërkoj deklarin e pavlefshëm të titullit ekzekutivë (fatura tatimore e shitjes se energjisë elektrike) nr. F-138694, datë lëshimi 8.11.2011 për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, për sasinë prej 10.000 KWh, në vlerën totale 146.400 lekë, e faturuar si energji e pamatur pasi detyrimi nuk ekziston në bazë të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

- Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.

- Në këto raste, gjykata shqyrton shpejt çështjen dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci.

- Nga interpretimi i dispozitës se mësipërme rezulton se kjo padi që të pranohet nga gjykata, kërkon plotësimin e njëkohshëm të disa kushteve të domosdoshme: 1) Akti që goditet duhet të jetë titull ekzekutiv pra të përfshihet në një nga kategoritë e parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile; 2) Padia mund të ngrihet vetëm nga debitori i titullit ekzekutiv, pra nga pala e ngarkuar me përmbushjen e detyrimit; 3) Titulli ekzekutiv duhet të jete prekur nga "vese të tilla" që e bëjnë atë të pavlefshëm, vese që lidhen me formën apo me përmbajtjen e titullit.

- Neni 510 i KPC-së, ka të përcaktuar qartë se cilët janë tituj ekzekutive. Midis të tjerave janë tituj ekzekutiv 510/e "... aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë "Në bazë të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës se konsumit të energjisë elektrike" të ndryshuar, fatura tatimore e konsumit të energjisë, është titull ekzekutiv. (Kushti i parë përmbushet)

- Pala paditëse në emër të së cilës është lëshuar kjo faturë tatimore shitje energjie elektrike duke u ngarkuar detyrimin e pagimit të vlerës së parashikuar në faturë merr cilësinë e debitorit të këtij titulli edhe si i tille gëzon legjitimitimin aktiv për të ngritur ketë padi. (Kushti i dytë përmbushet)

- Sa i përket kushtit të tretë titulli ekzekutiv mund të jetë i pavlefshëm në dy raste: Për shkak të mungesës së formës; ii. Për shkak të elementeve që lidhen me përmbajtjen, themelin e tij.

- Rasti i dytë do të thotë që detyrimi të mos ekzistojë, të jetë në një masë më të vogël apo të jetë shuar me pas. Në këndvështrim të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile me' pavlefshmëri të titullit ekzekutiv për shkak të mosekzistencës së detyrimit kuptohet ajo situatë kur dikush detyrohet të kryej një veprim të caktuar pa pasur shkak ligjor që ta kryejë atë, sepse detyrimet e përcaktuara në titullin ekzekutiv janë në vetvete të paligjshme.

- Lidhur me formën e titullit ekzekutiv, fatura tatimore e konsumit të energjisë janë tërësisht në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe neni nr. 51/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike" përcakton se; "Energjia elektrike e përdorur nga klienti lexohet dhe faturohet nga furnizuesi sipas regjistrimeve të aparatit matës" ndërsa në pikën 6.1.1 të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin familjar, përcaktohet; "Klienti do të paguajë detyrimin e shkruar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), nga data 2 deri në fund të muajit pasardhës". Nga rrethanat e faktit rezulton e provuar se klienti Haxhi Nezha për shkak të faturimit më pak se konsumi faktik i energjisë elektrike i është shmangur dispozitave të sipërcituara, pra pagesës së konsumit faktik të energjisë elektrike të realizuar prej tij.

- Neni 51 pika 14 të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se "llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE". Me vendimin nr. 42, datë 22.4.2011, ERE miratoi metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik. Në këtë vendim përcaktohet shprehimisht se dëmi ekonomik i korrespondon vlerës në lekë të energjisë së konsumuar mesatarisht nga një konsumator tipik. Për me tepër, edhe llogaritja e dëmit ekonomik (në vlera monetare) bazohet në çmimet e blerjes së energjisë për kategoritë e konsumatorëve. Kjo do të thotë se dëmi ekonomik llogaritet në bazë të konsumit mesatar të konsumatorëve të grupit ku bën pjesë. Në këtë kuptim, dëmi ekonomik duhet të përfshihet në bilancin e energjisë, duke qenë se përfaqëson energjinë e konsumuar nga klienti/jo klienti.

- Për të përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik, vendimi i ERE-s në mënyrë eksplicite konsideron konsumin mesatar të energjisë sipas grupit të konsumatorëve, mbi të cilin aplikohet çmimi i rregulluar dhe jo çmimi i tregut. Rrjedhimisht edhe ERE në metodologjinë e saj të aplikimit të dëmit ekonomik ka adoptuar një model që "bazohet mbi konsumin" dhe jo një model, që bazohet mbi sanksionin. Koncepti i dëmit ekonomik ka të bëjë me rikuperimin e vlerës monetare të energjisë së vjedhur (përveç dëmit që i shkaktohet rrjetit) dhe ky koncept aplikohet për çdo periudhë kohe gjatë së cilës është kryer një lidhje e paligjshme. Sa më sipër I padituri ka të drejtë që të konstatojë lidhjet e paligjshme, si dhe të aplikojë dëmin ekonomik për konsumatorët përkatës sipas niveleve të përcaktuara në vendimin nr. 42 të Entit Rregullator të Energjisë të ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.7.2012, "Për miratimin e disa ndryshimeve në metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik.

- Aplikimi i dëmit ekonomik nga ana e paditur është kryer edhe në përputhje me Kodin Civil Kështu, neni 608 i Kodit Civil citon "*Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar*" Siç del e provuar, paditësi me veprimet e tij ka realizuar shmangien e një faturimi të drejtë të energjisë elektrike të konsumuar, për qëllim përfitimin pa të drejtë, duke na shkaktuar dëm ekonomik.

- Neni 609 i Kodit Civil, përcakton se "Dëmi duhet të jete rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme e veprimit ose mosveprimit të personit". Rezulton e provuar se dëmi që na është shkaktuar për shkak të ndërhyrjes në matës është pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të paditësit. Në kuptim të 608 dhe 609 të Kodit Civil që të ekzistojë "përgjegjësia për shkaktimin e dëmit" duhet të ekzistojnë: 1. veprimi i paligjshëm e me faj 2. dëmi real i shkaktuar dhe lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (dëmit të shkaktuar) rezulton plotësisht e provuar se ekzistojnë këto "element", pasi; ndërhyrja në aparatun matës referuar dispozitave të sipërcituara është veprim i kundërligjshëm, veprimi është plotësisht me faj pasi paditësi është person madhor me zotësi të plotë

për të kuptuar veprimet dhe mosveprimet e tij siç theksuam më sipër dëmi është veprim i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes në aparatin matës të energjisë, pra ekziston lidhja shkakësore midis veprimit të paditësit dhe pasojës së ardhur.

- Pra, aplikimi i sasisë së energjisë elektrike në faturën objekt gjykimi në rubrikën “energji e pamatur” është bërë bazuar në: 1) Kodin Civil, nenet 608 e vijues; 2) ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. (neni 51); 3) vendimi nr. 42, datë 22.4.2011, ERE “Metodologjia e llogaritjes së dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme” i ndryshuar me vendimin “me vendimin nr. 109 datë 31.7.2012, “Për miratimin e disa ndryshimeve në metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik”.

- Paditësi (i furnizuari) është furnizuar rregullisht me energji elektrike nga ana e paditur. Pra, kontrata ka prodhuar plotësisht efektet e saj të dëshiruara nga pala paditëse, por jo efektet e dëshiruara nga pala e paditur, pra nuk jemi shpërblyer me çmimin për energjinë e konsumuar realisht. Pra, duke qenë se aplikimi i dëmit ekonomik është kryer në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë, titulli ekzekutiv edhe në përmbajtje të tij është plotësisht i ligjshëm. (Kushti i tretë nuk përmbushet).

II. Procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, ka marrë në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi në datën 31.1.2024. Pasi vlerësoi rrethanat e rastit në raport me vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë dhe asaj të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga pala e paditur Shogëria OSHEE sh.a., Kolegji vlerësoi se në rastin konkret, shtroheshin për zgjidhje disa çështje ligjore, në lidhje me interpretimin e ligjit nr. 9072/2003 mbi kuptimin e institutit të dëmit ekonomik të llogaritur nga furnizuesi i energjisë elektrike, në faturën tatimore të konsumit të energjisë elektrike, dhe të cilësisë së tij si titull ekzekutiv, si pjesë e faturës së energjisë elektrike. Duke qenë se ligji nr. 9073/2003 aktualisht është shfuqizuar nga ligji nr. 43/2015, Kolegji vlerësoi të analizojë në unitet të dyja këto ligje në lidhje me institutin e dëmit ekonomike dhe faturimit të tij në faturën tatimore të energjisë elektrike pasi kjo e fundit vazhdon të trajtohet si titulli ekzekutiv sipas të njëjtit ligj që është ai me nr. 8662/2002.

11. Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 ka parashikuar ndër të tjera edhe situatat e përfitimit të energjisë elektrike nga konsumatorët pa kontratë, në cenim të aparateve matëse, jashtë tyre ose në cenim të rrjetit të shpërndarjes duke i konsideruar ato si fakte të paligjshme që nxisin përlllogaritjen e dëmit ekonomike të shkaktuar shoqërisë shpërndarëse pasi energjia është përfituar në kundërshtim me ligjin. Për sa i përket llogaritjes së dëmit ekonomik neni 51/14 në fuqi në kohën e faturimit objekt gjykimi parashikonte se; *Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE.*

12. Në zbatim të këtij ligji, ERE nxori vendimin nr. 42, datë 22.4.2011 për metodologjinë e llogaritjes së dëmeve, duke e individualizuar atë me sasi standarde, që i referohej konsumit mesatar vjetor të një konsumatori tipik të kategorisë, ku përfshihen subjekti i dyshuar për shkaktimin e dëmit si pasojë e ndërhyrjes në rrjet. Ky vendim është ndryshuar nga ai nr. 109/2012

13. Aktualisht me ligjin nr. 43/2015 datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” është shfuqizuar ligji nr. 9072, datë 22.5.2003. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87 të dalë nga botimi në datën 28.5.2015. Në nenin 77/9 të ligjit nr. 43/2015 parashikon shprehimisht se; ***Operatori i sistemit*** nëse konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat është ndërhyrë, ***përlllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.*** ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përlllogaritjen e dëmit ekonomike nga ana e operatorit të sistemit. Në bazë të ligjit nr. 43/2015 ***Operatori i Sistemit të Shpërndarjes*** duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. ***Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili ushtron këtë funksion***

përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush detyrimin e ndarjes, jo më vonë se data 31.12.2017. Po sipas ligjit nr. 43/2015 parashikohet se; Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80 të këtij ligji, kanë këto të drejta: a) të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, Kodeve të Rrjetit dhe kontratave përkatëse.

14. Ligji nr. 8662/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10468/2011 parashikon se; *fatura tatimore e konsumit, të shitjes, të blerjes dhe të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv.*

15. Neni 36 i ligjit nr. 7982, datë 27.4.1995 parashikon; *Për qëllimet e këtij ligji fatura përpilohet në formën e caktuar nga ministri i Financave dhe përmban: a) emrin, adresën. NIPT-in dhe kodin fiskal të personit që bën furnizimin; b) emrin, adresën dhe NIPT-in, së bashku me kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm për TVSH-në, emrin, adresën dhe kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm i biznesit të vogël dhe vetëm emrin e adresën për blerësit persona të tjerë; b/1) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit; c) datën në të cilën lëshohet fatura; d) numrin e serisë së vendosur nga shtypshkronja që e ka shtypur; e) numrin rendor; f) përshkrimin e çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; g) sasinë e mallrave apo madhësinë e shërbimeve të furnizuara; h) çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; i) shumën e pagueshme pa TVSH-në; j) përqindjen e TVSH-së së pagueshme ndaj çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; k) shumën e TVSH-së së pagueshme; l) shumën e pagueshme me TVSH; m) çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga ministri i Financave.*

16. Duke mbajtur në konsideratë këto parashikime ligjore, ndryshimet e tyre ndër vite, vendimet e Gjykatës Kushtetuese që në mënyrë konstante ka refuzuar kërkesat e gjykatave për konstatimin si antikushtetuese të ligjit nr. 8662/2002 dhe nenit 51/14 të ligjit nr. 9072/2003, pas një studimi paraprak, Kolegji konstatoi se në praktikën e gjykatave më të ulëta si dhe në Gjykatën e Lartë janë hasur probleme në lidhje me interpretimin e ligjit në këtë drejtim dhe mbahen qëndrime të ndryshme lidhur me cilësinë si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik, të cilat nxisin nevojën për kalimin e çështjes për njësim.

17. Në qëndrimin e parë, -jurisprudenca e gjykatave-, siç është dhe rasti në shqyrtim, mbështet arsyetimin se vlera e detyrimit e pasqyruar si pasojë e dëmit ekonomik në faturën e energjisë elektrike, nuk mund të jetë pjesë e faturës. Sipas këtij qëndrimi, OSHEE-ja nuk ka të drejtë që të përcaktojë vetë se sa është vlera e dëmit të shkaktuar dhe më pas ta përfshijë atë në faturën e shitjes së energjisë elektrike duke e bërë drejtpërdrejtë të ekzekutueshëm. Sipas kësaj linje qëndrimi të praktikës gjyqësore ligji i njeh cilësinë e titullit ekzekutiv, vetëm energjisë së matur sipas regjistrimit të matësit, ndërsa llogaritja e dëmit ekonomik nga njëra palë kontraktore në rastin e ndërhyrjeve në matës ose në rrjetin e shpërndarjes interpretohet si vlerësim i njëanshëm i dëmit në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve në marrëdhënien kontraktore dhe për këtë shkak fatura për këtë pjesë nuk ka cilësinë e titullit ekzekutiv. Nën këtë logjikë dëmi ekonomik i pretenduar nga furnizuesi mund të jenë objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor vetëm në gjykata në gjykime të padive me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga konsumatori i energjisë elektrike, padi këto të iniciuara nga pala e dëmtuar OSHEE-së, ku gjykata duhet të përcaktojë nëse ekziston dëmi, vlerën e tij dhe se kujt i ngarkohet sipas nenit 608 e vijues të Kodit Civil.

17.1 Vendimet që reflektojnë këtë qëndrim, renditen si më poshtë:

-Vendimi nr. 00-2022-1735, datë 20.7.2022 dhe vendimi nr. 00-2022-3612, datë 5.12.2022, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: “*Para gjykatës së shkallës së parë, në rastin konkret, është paraqitur në padi me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, konkretisht të disa faturave të energjisë elektrike, me argumentin se sasia e energjisë elektrike e pasqyruar në to është përcaktuar në mënyrë aforfe nga pala e paditësit dhe jo sipas apartatit matës. Kolegji vlerëson se në gjykime të tilla, të iniciuara me padi sipas nenit 609 të KPC-së, para gjykatave të faktit, objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor, sipas një vlerësimi apriori, është vetëm nëse detyrimi i pasqyruar*

në faturën tatimore të energjisë elektrike, nga pala e paditur, është apo jo pjesë e titullit ekzekutiv. Kjo do të thotë se gjykatat nuk kanë detyrimin t'a nënshtrojnë hetimit dhe debatit gjyqësor bazueshmërinë në ligj dhe në prova të pretendimeve të palës së paditur për dëmin ekonomik të shkaktuar nga energjia e pamatur. Pretendime të tilla mund të jenë objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor vetëm në gjykime të iniciuara nga enti shpërndarës i energjisë elektrike, me qëllim shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga konsumatori i energjisë elektrike”

-Vendimi nr. 00-2022-1794 (300), datë 20.7.2022, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: *“Pala e paditur, në faturën tatimore të energjisë elektrike, objekt gjykimi, të shndërruar në titull ekzekutiv, krabas konsumit të energjisë elektrike sipas matësit, ka vendosur edhe dëmin ekonomik, që sipas saj i është shkaktuar nga paditësi, nëpërmjet detyrimeve të akumuluar. Kolegji vlerëson se baza ligjore nuk ia njëh të gjitha të drejtat që gjeneron kontrata për llogari të entit shpërndarës të energjisë elektrike, në cilësinë ligjore të titullit ekzekutiv. Në mënyrë taksative, kufizuese dhe eksplicite ligji ia njëh këtë cilësi ekskluzivisht vetëm së drejtës/detyrimit që emeton fatura e energjisë elektrike, konkretisht çmimi i energjisë elektrike të konsumuar në periudhën respektive, që mbulon ajo faturë konkrete. ...Në të tilla raste, Legjislatori ka specifikuar dhe identifikuar një të drejtë të posaçme së cilës qëllimisht i ka veshur cilësinë ligjore të titullit ekzekutiv, ndaj ligji shpreh qartësisht, fillimisht në titull e më pas në nenin 1 të tij, respektivisht se “...trajtimi si titull ekzekutiv i faturës së konsumit të energjisë elektrike...” apo “Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike...është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbartimit për ekzekutimin e tyre....Ky konkluzion nuk pas sjell mohimin e mundësisë së gëzimit të kësaj të drejte subjektive të entit shpërndarës, përkundrazi kjo e drejtë mund të ekzistojë dhe mund të sanksionohet gjyqësisht, nëpërmjet kërkesëpadisë dhe nëpërmjet një gjykimi me palë kundërshtare (juridictio contentiosa)... Kolegji çmon të theksojë se vlerësimi i njëanshëm i dëmit nga njëra palë kontraktore, është abuziv dhe do të linte palën më të dobët në këtë marrëdhënie juridike, tërësisht të pambrojtur kundrejt interpretimeve dhe iniciativave të palës tjetër. Në rastin konkret, pjesa e faturave që tregojnë një gjë të tillë janë thjesht një paralajmërim që i bëhet palës tjetër kontraktore për të qenë korrekt dhe i kujdesshëm në ekzekutimin e detyrimit kontraktor dhe jo pjesë integrale e faturës që ligji i njëh cilësinë e titullit ekzekutiv. Nuk mund të njëjtësohet çdo e drejtë e parashikuar në kontratë, vetëm nga fakti i përfshirjes fizikisht në faturë apo jo, me qëllimin e Ligjvënësit që ka specifikuar qartësisht vetëm një të drejtë të aftë, që pa iu nënshtroar verifikimit kontradiktor gjyqësor, të konstitujë marrëdhënien juridike të ekzekutimit të detyrueshëm.”*

-Vendimi nr. 00-2015-779 (5), datë 14.1.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka të bëjë me pavlefshmërinë e faturave të periudhës tetor 2004 deri në maj 2006 ka arsyetuar se: *“I padituri, në qoftë se ka konstatuar se paditësi ka shkelur detyrimet kontraktore, duke marrë dhe konsumuar energji elektrike, e pa pasqyruar në aparatin matës, dubet t'i drejtohet gjykatës me një padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i këtij veprimi. Ai nuk ka të drejtë që të përcaktojë vetë se sa është vlera e dëmit të shkaktuar dhe më pas ta përfshijë atë në faturën e shitjes së energjisë elektrike duke e bërë drejtpërdrejt të ekzekutueshëm, meqenëse kjo e fundit është titull ekzekutiv sipas ligjit. Në rastin e dëmit kontraktor është gjykata që, mbi bazën e kërkesës së bërë nga pala që e pretendon atë, të përcaktojë nëse ekziston dëmi, vlerën e tij dhe se kujt dubet t'i ngarkohet.”*

-Vendimi nr. 00-2014-1319-147, datë 17.4.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, lidhur me pavlefshmërinë e faturës së Janarit 2010 ka arsyetuar se: *“Gjykata e apelit, në zgjidhjen e dhënë, referon: (i) në nenin 51/4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” në të cilin ka qenë parashikuar se “Çdo ndërhyrje tjetër në matësit e furnizuesit është e ndaluar dhe ndëshkohet, sipas akteve ligjore në fuqi” dhe (ii) në nenin 46/1 të ligjit nr. 9750, datë 4.6.2007, me të cilin janë bërë shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003..... Gjykata e apelit, duke mos evidentuar se këto rregullime ligjore nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur nga pala e paditur pretendohet se paditësi ka ndërhyrë në sistemin matës dhe i ka shkaktuar dëm ekonomik, ka zgjidhur çështjen në kundërshtim me nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit ka pasur detyrimin ligjor që të “...zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj”. 13 Evidentohet se fakti i pretenduar nga pala e paditur që, sipas saj i ka shkaktuar dëm ekonomik, ka ndodhur më datë 7.1.2010, kohë në të cilën rregullimet e mësipërme ligjore (pika 12.1. e këtij vendimi) kanë qenë të shfuqizuara. Respektivisht, me nenin 1 të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar” “Në nenin 46, në fund të shkronjës “c” fjalët “dhe vendos masat*

administrative për mospërbushjen e tyre, sipas nenit 46/1” shfuqizohen”, ndërsa me nenin 2 të këtij ligji është shfuqizuar neni 46/1 i sipërcituar në të cilin gjykata e apelit bazohet në zgjidhjen e dhënë mosmarrëveshjes në shqyrtim. 14. Në mbështetje të ndryshimeve legislative edhe Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin e tij nr. 90, datë 15.11.2010 ka vendosur: “2-Të gjitha faturimet e kryera nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a. ndaj klientëve familjarë dhe jofamiljarë, me emërtimin “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur”, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008, janë të paligjshme”. 15. Referuar situatës konkrete të faktit, që përbën objektin e këtij gjykimi, dhe legjislacionit në fuqi të kohës, pala e paditur, për pretendimet e saj duhet të zgjidhte mjetin e duhur juridik për t’i realizuar ato, sikundër mund të ishte padia për njohjen e shkaktimit të dëmit ekonomik dhe detyrimin e subjektit përkatës për shlyerjen e tij.

18. Në qëndrimin e dytë, mbështet arsyetimin se vlera e detyrimit të pasqyruar në faturën e energjisë elektrike, si dëm ekonomik, mund të vendoset në këtë faturë dhe të jetë pjesë e titullit ekzekutiv, për shkak së pari, të natyrës *sui generis* së këtyre faturimeve, që rrjedh si shkak i ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes ose në aparatet matëse, dhe së dyti, llogaritja e dëmit ekonomik duhet të jetë detyrim eksplisit i palës së dëmtuar, por kryer veçse në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE. Kjo rezulton e reflektuar nga amendimet ligjore, përkatësisht rrjedhojë e ndryshimit të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 nga ligji nr. 10362, datë 16.12.2010, në të cilin u parashikua se llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE dhe me ligjin nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ku në nenin 77/9 të tij parashikohet se, kur operatori i sistemit konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat është ndërhyrë, përlllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përlllogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.

18.1 Vendimet që reflektojnë këtë qëndrim, renditen si më poshtë:

- Me vendimin 00-2016-289 (23), datë 27.1.2016, Gjykata e Lartë, ka lënë në fuqi vendimin nr. 87(60-2013-118), datë 6.2.2013 i Gjykatës së Apelit Vlorë, ku është arsyetuar se “...nëpërmjet llogaritjes së dëmi ekonomik furnizuesi synon të rikuperojë pasaktësitë në matje për shkak të ndërhyrjes në matës. Në këto kushte me të drejtë edhe në rast të përlllogaritjes së dëmit ekonomik duhet të zbatohet i njëjti rregull për llogaritjen e dëmit ekonomik...” Nëpërmjet vendimit të më sipërm, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin nr. 149, datë 6.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka arsyetuar se: “Gjykata çmon se paditësi ka konsumuar energji elektrike pa u matur rregullisht nga matësi, duke i shkaktuar dëm palës së paditur... Për sa u përket mënyrave të llogaritjes së dëmit ekonomik gjykata çmon se sipas vendimi nr. 101, datë 26.8.2008 “Kodi i matjes” përcaktohet se rregullimet e pasaktësive të matjes do të kufizohen në periudhën e fundit 12 mujore. Këtë logjikë ndjek ERE dhe në vendimin nr. 42, datë 22.4.2011. - Sipas aktit të ekspertimit rezultoi se këta abonent përfsihben në kategorinë e parë të konsumatorëve të vegjël me matës njëfazor. 2- Në vendimin nr. 42, datë 22.4.2011, të ERE-s përcaktohet se dëmi ekonomik për kategorinë e parë të konsumatorëve është në masën 4000 kwh. ERE ka përcaktuar me vendimin e mësipërm një vlera fikse të dëmit. Diferencimi i tyre bëhet vetëm mbi bazën e kategorizimit të klientit sipas llojit të konsumatorit tip ku ai përfsihbet. Përdërisa abonentët objekt i faturimit përfsihben në klientët e vegjël sasia e konsumit të energjisë elektrike të tyre është 4000. Duke qenë se kjo vlerë është e përcaktuar paraprakisht nga ERE në bazë të llogaritjes së konsumit mesatar për tipin e klientit, ku bën pjesë dhe këta abonentë, gjykata nuk merr në konsideratë vlerat e konsumit vjetor të përlllogaritura nga eksperti në kushtet aktuale të pajisjeve elektrike të gjetura gjendje në këto qendra shëndetësore....”

- Vendimi nr. 00-2014-1319-147, datë 17.4.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, lidhur me pavlefshmërinë e faturës së janarit 2010 pranon se; Për saktësi duhet pasqyruar se e drejta e pretenduar nga ana e palës së paditur për të llogaritur dëmin ekonomik në përputhje me metodologjinë e miratuar nga ERE është

sanksionuar përsëri me nenin 3 të ligjit nr. 10362, datë 16.12.2010 që ka bërë ndryshime në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” (është ndryshuar neni 51).

- Vendimi nr. 00-2023-3179, datë 19.7.2023, dhe vendimi nr. 00-2023-838 (112), datë 8.3.2023, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kanë arsyetuar: “Sipas ligji nr. 8662, datë 18.9.2000 ‘Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike’, i ndryshuar, me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001 ‘Për një shtesë në ligjin nr. 8662, datë 18.9.2000 ‘Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike’, nëpërmjet nenit 1, shprehet se ‘Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’, është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përbarimit me ekzekutimin e tyre.’ Rrjedhimisht, është e qartë se mënyra e kundërshtimit në rrugë gjyqësore të këtyre faturave është ajo nëpërmjet padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, parashikuar nga neni 609 i Kodit të Procedurës Civile.

Në kohën e lëshimit të faturës objekt kundërshtimi dhe në kohën e gjykimit të çështjes ka qenë në fuqi ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.10.2010. Me ligjin nr. 10362, datë 16.10.2010, që është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 179 të vitit 2010 dhe që ka hyrë në fuqi në muajin janar 2011, ka ndryshuar ndër të tjera, edhe neni 51, dispozitë ku është shtuar edhe pika 14, që përcakton se: “Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”. Duke qenë e autorizuar nga ligji në kuptim të kësaj dispozite, për të nxjerrë akte nënligjore për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik të shkaktuar kompanisë CEZ Shpërndarje nga çdo ndërhyrje e paligjshme, Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar në vijimësi vendimin nr. 42, datë 21.4.2011, gjithashtu në fuqi në momentin e lëshimit të faturës objekt kundërshtimi, si dhe në kohën e gjykimit të çështjes....24.1. Në pikën 4 të këtij vendimi është sqaruar koncepti i dëmit ekonomik, sipas kësaj mënyre formulimi: “Dëmi ekonomik është vlera korresponduese në lekë e sasisë së energjisë elektrike (Kwh) të konsumuar mesatarisht gjatë një viti prej një konsumatori/ klienti tipik të secilës kategori. Sasia e energjisë së konsumuar është llogaritur si produkt i konsumit mesatar mujor të një konsumatori/ klienti tipik, të kategorisë ku shkaktari i dëmit bën pjesë, me numrin e muajve të një viti (12) dhe përcaktohet në tabelën e mëposhtme: i) Kategoria e parë-klientë të vegjël (matës monofazë elektro-metër)- 4.000 Kwh; ii) Kategoria e dytë-klientë të mesëm (matës trefazorë), deri në 30 Kw- 10.000 Kwh; iii) Kategoria e tretë-klientë të mëdhenj matës trefazorë, mbi 30 kë- 20.000 Kwh”....

Kështu, Kolegji vlerëson se nisur nga arsyetimet e mësipërme, arrihet në përfundimin se, hetimi gjyqësor nuk është i plotë, pasi nga ana e gjykatave nuk është analizuar titulli ekzekutiv dhe vlefshmëria e tij në raport me kriteret e përcaktuara në normat e zbatueshme, sipas vendimit nr. 42, datë 22.4.2011 të Entit Rregullator të Energjisë, të miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 51, pika 14 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.10.2010, si dhe sipas pikës IV.9 të Kodit të Matjes.”

-Vendimi nr. 00-2013-2149, datë 3.5.2023, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: “16. Kolegji e gjen të padrejtë arsyetimin e gjykatës së apelit, pasi kjo gjykatë në interpretim të gabuar të ligjit ka konstatuar se i padituri nuk ka të drejtë të faturojë dëmin ekonomik ose energjinë e pamatur duke iu referuar për këtë ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008, që ndryshoi atë nr. 9072/2003 dhe vendimit të ERE-s nr. 90/2010. Ky arsyetim bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi në kohën, kur është lëshuar fatura objekt gjykimi.. Në ndryshim nga sa arsyeton gjykata e apelit faturat objekt kërkimi nuk i përkasin periudhës 2008-dhjetor 2010, kohë kur vepronte ligji nr. 9997/2008 dhe vendimi i ERE-s nr. 90/2010. Fatura objekt gjykimi i përket muajin qershor 2011, kohë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 10362, datë 16.12.2010. Me ndryshimin e ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 nga ai nr. 10362, datë 16.12.2010 u parashikua se “Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE-ja”. Ky ligj ka hyrë në fuqi në muajin Janar të vitit 2011. Në zbatim të këtij ligji, ERE nxori vendimin nr. 42, datë 22.4.2011 për metodologjinë e llogaritjes së dëmeve. Janë pikërisht këto akte ligjore e nënligjore që i njohën të paditurit të drejtën e përlllogaritjes dhe faturimit të dëmeve ekonomik shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme nga momenti i hyrjes në fuqi në Janar 2011 e në vazhdim. Megjithatë një e drejtë e tillë mund të ushtrohet vetëm në ato raste kur i padituri konstaton cenime në aparatin matës ose në linjë të cilat krijojnë dyshime të bazuara për marrjen e padrejtë të energjisë elektrike tej asaj të regjistruar në matës,

ose që nuk regjistrohej në këtë të fundit. Për sa më sipër evidentohet se qëndrimi i gjykatës së apelit lidhur me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes është i gabuar.

Duke ju rikthyer çështjes objekt gjykimi Kolegji çmon se pala e paditur, OSHEE sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje) ka të drejtë ligjore të faturojë, palën paditëse në faturën mujore të energjisë elektrike, sasinë e energjisë elektrike të konsumuar realisht dhe të matur sipas matësit të energjisë ose për shkak të mungesës objektive dhe arsyeve të caktuara të faturojë sipas mënyrës afrofe, por në këtë rast të dytë, ka detyrimin ligjor që të faturojë midis marzheve të vendosura sipas entit rregullues, me vendimet përkatëse të ERE-s, për rrjedhojë ka të drejtë ligjore që bazuar në vendimin e ERE-s, me nr. 42, datë 22.4.2011, që është ndryshuar me vendimin me nr. 109, datë 31.7.2012 “Për metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjes paligjishme” të llogarisë dëmin ekonomik që i është shkaktuar asaj prej ndërhyrjeve të paligjishme prej palës paditëse.”

19. Duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme të Kolegjit Civil, interpretimet e kontradiktore të gjykatave më të ulëta, si edhe problemet ligjore që kanë dalë lidhur me interpretimin e ligjit në këtë natyrë çështjesh, numrin e lartë të çështjeve në pritje për gjykim para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe në Gjykatën e Apelit, Kolegji Civil, evidenton nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore në drejtim të faktit nëse dëmi ekonomik i shkaktuar shoqërisë shpërndarëse të energjisë elektrike a mund të faturohet si pjesë e faturës së energjisë elektrike dhe nëse fatura për këtë pjesë gëzon apo jo cilësinë e titullit ekzekutiv kur ajo është lëshuar sipas ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar me ligjin nr. 10362/2010 e ligjit aktual nr. 43/2015. Për këtë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), me vendimin datë 31.1.2014 ka vendosur: “*Kalimin për shqyrtim të kësaj çështjeje pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore*”.

20. Kolegji çmon me rëndësi të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GJEDNJ”) në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtësia e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (*shih çështjen “Chapman v United Kingdom” vendim i GJEDNJ-së, datë 18.1.2001*), duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

21. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (*Shih çështjen “Lupaș and Others v. Romania”, ap. nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006 XV*). Gjykata ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të të njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së.

22. GJEDNJ-ja konkludon se ato që përbëjnë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana:

- nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike;
- nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedural që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë;
- nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore.

23. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (*shih çështjen “Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë”, kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40*).

24. Në vijim të kësaj analize, në çështjet ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji, në ushtrim të së drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik,

- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime lidhur me faktin nëse përfshirja e dëmit ekonomik në faturën e energjisë elektrike iu jep këtyre të fundit cilësitë e titullit ekzekutiv apo jo (në kuptim të nenit 510, paragrafi i dytë, shkronja “e”, të KPC-së);

- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë dhe e unifikuar në interpretimin e ligjit material;

- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, ka konkluduar se duhet të vijojë me gjykimin njësuës duke vlerësuar të drejta edhe çështjet e ngritura nga Kolegji i mëparshëm, në funksion të njësimi të praktikës gjyqësore, ka vlerësuar të ngre për njësim të praktikës gjyqësore, çështjen si më poshtë vijon:

- Fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shoqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, dhe sipas ligjit aktual nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, a ka cilësinë e titullit ekzekutiv?

25. Në aspektin procedural të gjykimit të çështjes Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim më datë 7.3.2024 dhe vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 481 të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021. Në këto kushte, u formua trupa gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjyqësore, çështjes së shtruar për njësim, duke iu lënë palëve afatin minimum prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyrua çështja e shtruar për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

26. Pas zhvillimit të seancës gjyqësore në datën 7.3.2024, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 18.4.2024.

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil

Mbi çështjen e shtruar për njësim

27. Energjia elektrike është send i qarkullimit civil. Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e saj rregullohet në bazë të legjislacionit “Për sektorin e energjisë elektrike”, akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore në të cilat dispozita të veçanta rregullojnë marrëdhënien e prodhimit dhe furnizimit, shitjes së energjisë elektrike.

28. Për furnizimin me energji elektrike në bazë të legjislacionit të sipërpërmendur nr. 9072/2003 dhe aktualisht atij nr. 43/2015 lidhet kontratë midis furnizuesit dhe konsumatorit ose klientit, kontratë e cila ka një ndërthurje të elementëve të kontratës së furnizimit dhe kontratës së shitjes. Për shkak të veçorisë, që gëzon kjo kontratë nisur nga natyra e veçantë e sendit objekti i furnizimit dhe ligji i posaçëm, që rregullon veprimtarinë e prodhimit dhe shpërndarjes së këtij sendi, kontrata tip e energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike të abonentëve familjar ose jofamiljar është e miratuar me vendime nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike. Pra, kjo kontratë dhe klauzolat kontraktore të saj nuk janë pasojë e vullnetit të lirë të palëve, sikurse ndodh zakonisht në marrëdhëniet kontraktore. Legjislatori për shkak të rëndësisë së këtij sektori strategjik ka zgjedhur të kufizojë lirinë kontraktore në interes të së mirës së përgjithshme, kufizim që fillon që nga parashikimet specifike ligjore, miratimi i kontratave tip, parashikimit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike si një organ kompetent ligjor rregullator në këtë fushë për vendosjen e rregullave të deleguara nga ligji dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj.

29. Furnizimi me energji elektrike përbën shitje të produktit “energji” dhe si i tillë ai i nënshtrohet rregullave tatimore të parashikuara nga ligji nr. 7928/1995 i ndryshuar. Sasia e energjisë elektrike të konsumuar ose të shitur në një periudhë kohore përcaktohet në faturën tatimore të lëshuar nga furnizuesi, shitësi për këtë qëllim, sipas ligjit për procedurat tatimore.

30. Ligjvënësi i ka dhënë faturës tatimore të energjisë elektrike cilësinë e titullit ekzekutiv. Kështu, në nenin 1 të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” është parashikuar: *“Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’, është titull ekzekutiv.”*

30.1 Në vijim, ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001, “Për një shtesë në ligjin nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i shtuar me ligjin nr. 10486, datë 26.11.2011¹, i cili gjithashtu përbëhet nga tri nene. Në nenin 1, pa u ndryshuar thelbësisht dispozita, parashikohet: *“Fatura tatimore e konsumit, të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’, është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre”.*

30.2 Sipas nenit 1 të ligjit të mësipërm, përfshirë edhe amendimet ligjore ndër vite, është përcaktuar se fatura e konsumit të energjisë elektrike, e cila përmban elementet e faturës tatimore të përcaktuara nga Ministria e Financave, përbën titull ekzekutiv, dhe ekzekutohet forcërisht nga zyra e përmbarimit. Ky lloj faturimi i referohet konsumimit të energjisë elektrike pa evidentuar nëse ky konsum është si pasojë e matjes së energjisë nga aparati matës, e faturimit afrofe, e përlllogaritjes së dëmit ekonomik, apo e energjisë së pamatur për shkak të gabimeve teknike të matësit. Pavarësisht se faturimi i energjisë elektrike ka të bëjë me përmbushjen e një detyrimi kontraktual të lidhur midis palëve, për shkak të rëndësisë, që paraqet pagesa e këtyre faturave me qëllim vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik të këtij sektori me rëndësi jetike për shoqërinë, ligjvënësi ka parashikuar faturën e konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv.

31. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, ka theksuar rëndësinë e veçantë që ka mbledhja e detyrimeve të faturave të furnizimit me energji elektrike për mirëfunksionimin e gjithë shoqërisë në tërësi duke e vlerësuar cilësimin si titull ekzekutiv të saj, si një mjet proporcional për realizimin e interesit publik nga njëra anë në vazhdimësinë e aktiviteteve ekonomike, jetike e shtetërore të ndërvarura nga qëndrueshmëria e rrjetit elektroenergjetik dhe nga ana tjetër interesat e individit për t’u mbrojtur nga abuzimi me faturat e energjisë elektrike. Sipas qëndrimit të kësaj gjykate, metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi, sipas së cilës fatura e energjisë elektrike përbën titull ekzekutiv, ekuilibron interesat e vëna në diskutim, si dhe është diktuar nga domosdoshmëria dhe efektshmëria për të realizuar shlyerjen e detyrimeve financiare të energjisë elektrike nga konsumatorët, brenda një afati kohor të arsyeshëm.

32. E njëjta logjikë arsyetuese vlen edhe për faturimet e dëmeve ekonomike, të cilat janë faturime, që kryen në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes ose në aparatet matëse. Ato nuk janë penalitete me karakter sanksioni, por simbolizojnë “energji të konsumuar” të përlllogaritur sipas rregullave të normuara, që synojnë rikuperimin e energjisë elektrike të përfutur padrejtësisht nga abonentët si rezultat i ndërhyrjeve. Do të ishte e papranueshme, që nisur nga shpërndarje totale e rrjetit në mbarë vendin dhe nevojat primare të gjithë sektorëve të shoqërisë për energji elektrike, shoqëria OSHEE Group sh.a., t’i drejtohet për kërkimin e vlerës së dëmit rrugës gjyqësore nëpërmjet padive të veçanta sipas nenit 608 e vijues të KC-së (Kodit Civil), në çdo rast të konstatimit të ndërhyrjeve në rrjet. Përderisa fatura e energjisë elektrike është konsideruar titull ekzekutiv në tërësinë

¹ Ky ligj është bërë objekt kontrolli kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, ka vendosur të rrëzojë kërkesat e gjykatës investuese për antikushtetutshmëri të ligjit.

e saj, madje edhe në rastet e shitjes dhe blerjes së energjisë me operatorët e tjerë, sipas ligjit nr. 10486, datë 26.11.2011, është e papranueshme, që ajo të mos ketë këtë fuqi edhe në rastet e faturimit të dëmit ekonomik, që përbën energji të përfutur, pra të konsumuar, në mënyrë të paligjshme si rezultat i ndërhyrjes së paautorizuar në rrjetin e shpërndarjes ose aparatit matës.

33. Në rast se do të pranohej e kundërta atëherë do të vendosej në një pozitë të pabarabartë mbrojtjeje konsumatori i rregullt i energjisë ndaj të cilit fatura do të përbënte titull ekzekutiv, në raport me atë, që e ka përfutur këtë energji në mënyrë të paligjshme, ndaj të cilit shoqëria furnizuese për të vjelë energjinë e konsumuar do të duhet të ngrinte padi në gjykatë, proces i cili përveç shpenzimeve kërkon edhe kohë. Kjo situatë do të nxiste veprimet e paligjshme nga konsumatorët e energjisë elektrike, në kundërshtim me qëllimin ligjor të parashikimit si titull ekzekutiv të faturës së konsumimit të energjisë elektrike, që ishte vjelja e shpejtë e detyrimeve ndaj konsumatorëve, për të bërë të mundur vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë. Për të garantuar të drejtën e pronësisë mbi energjinë si produkt dhe mirëfunksionimin e sistemit të shpërndarjes së saj, ligjvënësi ka penalizuar vjedhjen e saj dhe ndërhyrjen e paligjshme e të paautorizuar në rrjetin elektrik dhe në sistemin e matjes në nenin 137 të Kodit Penal.

34. Sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në ligjin nr. 8662/2002 fuqinë e titullit e ka fatura e *“konsumit të energjisë elektrike”*. Sipas fjalorit shqip-shqip “konsum” do të thotë *“Përdorimi i sendeve ose i të mirave materiale për të plotësuar nevojat vetjake e shoqërore; plotësimi i kërkesave të përditshme me sendet e nevojshme. Mallra (artikuj) konsumi. Fondi i konsumit shoqëror. Sendet e konsumit të gjerë. Kooperativat e konsumit. vjet. Konsumi për frymë. 2. Përdorimi i diçkaje. Për konsum të brendshëm. 3. Harxhim, shpenzim. Konsumi i ujit (i energjisë elektrike). Konsumi i materialit (i karburantit)”*. Në përputhje me kuptimin gramatikor të termit “konsum” del se ai përfshin si veprimtari çdo lloj përdorimi të sendeve ose të të mirave materiale. Për rrjedhojë mjafton të vërtetohet fakti se një sasi energjie është konsumuar dhe përdoruesi i saj duhet të paguajë vlerën e energjisë së përfutur. Për rrjedhojë në interpretimin literal termi ‘konsum’ përfshin çdo lloj përdorimi energjie, pavarësisht nga mënyra se si është realizuar ky përfitim.

35. Në ligjin nr. 8662/2002 nuk pasqyrohet asnjë lloj përkufizimi për togfjalëshin “faturë e konsumit të energjisë” dhe as ndonjë referencë për modelin “konsum” që konsiderohet titull ekzekutiv. Duke mbajtur në konsideratë kuptimin gramatikor të fjalës “konsum” në përputhje me interpretimin gjuhësor të ligjit, logjikisht cilësinë e titullit ekzekutiv duke iu referuar ngushtësisht vetëm këtij ligji e ka çdo faturë tatimore e energjisë elektrike që në përmbajtjen e saj pasqyron energji të konsumuar, pavarësisht mënyrën se si është llogaritur ky konsum.

36. Për të kuptuar se cila është energjia, që faturohet si energji e “konsumuar”, duhet t’i referohemi ligjit të posaçëm “Për sektorin e energjisë elektrike” pasi është ky ligj, që parashikon rregullat e përcaktimit të saj në çdo rast, më konkretisht ligji nr. 9072/2003 e aktualisht atij me numër 43/2015. Duke mbajtur në konsideratë kohën, kur doli ligji nr. 8662/2000, që parashikoi faturën e konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv është e nevojshme të analizohet kuadri ligjor që rregullonte mënyrën e faturimit të energjisë elektrike në atë kohë dhe ndryshimet ndër vite të ligjit të posaçëm “Për sektorin e energjisë elektrike” në këtë drejtim. Në këtë mënyrë sipas parimit të interpretimit historik të ligjit do të kuptohet nëse energjia e konsumuar si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme dhe e llogaritur si dëm ekonomik nga shoqëria furnizuese sipas kritereve ligjore e ka apo jo cilësinë e energjisë së konsumuar, të faturueshme si titull ekzekutiv.

37. Kështu, në kohën, kur ka dalë ligji nr. 8662/2000, që e cilësoi faturën e energjisë elektrike si titull ekzekutiv ka qenë në fuqi ligji nr. 7962, datë 13.7.1995, “Për energjinë elektrike” dhe ligji nr. 7970, datë 20.7.1995, “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”. Në ligjin nr. 7962, datë 13.7.1995 janë të përcaktuara këto mënyra përlllogaritje të energjisë së konsumuar që janë: A - neni 12 për energjinë e matur -Sipas nenit 12/1 për energjinë e matur parashikohet se; *Energjia elektrike e përdorur matet e faturohet nga furnizuesi sipas të dhënave të pajisjes matëse të furnizuesit. Vendosija, lidhja, mirëmbajtja dhe*

verifikimi i saktësisë së matjes bëhen nga furnizuesi me shpenzimet e tij. B - për energjinë afrofe – Sipas nenit 12/6 parashikohet që furnizuesi është i detyruar të sigurojë matjen e duhur për të gjithë konsumatorët brenda një periudhe kohe, që do të përcaktohet nga Enti i Rregullimit. Gjatë kësaj periudhe kohe të ndërmjetme deri në sigurimin e matësve aplikohet sipas vendimit të ERE-s faturimi afrofe. C-për energjinë e marrë në mënyrë të parregullt – Neni 17 i ligjit nr. 7962/1996 përcakton; “Marrje e parregullt e energjisë elektrike është: a) marrja pa lidhje kontrate; b) marrja nga ajo pjesë e pajisjes, nëpër të cilën kalon energji e pamatur; c) marrja pa pajisje matëse ose me pajisje matëse, që si pasojë e ndërhyrjes së përdoruesit marrja ose nuk regjistrohet ose regjistrohet më e vogël se realiteti; ç) marrja me pajisje matëse, të cilën nuk e ka lidhur furnizuesi apo tek e cila është prishur sigurimi ndaj ndërhyrjeve të parregullta”. Për energjinë e marrë në mënyrë të parregullt parashikohet në nenin 17/(2) të ligjit se; *Mënyra e llogaritjes së dëmit të shkaktuar furnizuesit nga marrja e parregullt, si dhe sanksionet përkatëse caktohen nga Enti i Rregullimit sipas dispozitave në fuqi.* Pra edhe sipas ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” në fuqi, në kohën kur fatura e konsumimit të energjisë elektrike u njoh si titull ekzekutiv, del se llojet e faturimit të energjisë elektrike ishin si ato me matje sipas leximit të matësit, faturim afrofe në periudhën tranzitore dhe faturimi për marrjen e padrejtë të energjisë, e cila llogaritej sipas metodës së përcaktuar nga ERE. Duke qenë se përcaktimi i bërë në ligjin nr. 8662/2000 i referohej faturës së konsumit të energjisë elektrike pa veçuar posaçërisht ndonjë lloj konsumi kuptohet se fatura e kishte cilësinë e titullit ekzekutiv për të tria llojet e faturimeve të njohura nga ligji i posaçëm nr. 7962/1995 të sipërcituara, që tregonin konsum energjie nga subjekti pavarësisht metodës së përdorur për llogaritjen e konsumit, që mund të ishte konsum i llogaritur nga matja, konsum aforfe apo konsum i llogaritur sipas metodës së përcaktuar nga ERE për shkak të marrjes së padrejtë të energjisë.

38. Në vijim ligji nr. 9072/2003, që shfuqizoi atë nr. 7962, datë 13.7.1995, parashikoi disa mënyra të llogaritjes së energjisë së konsumuar që ishin; a-energji e matur sipas regjistrimit në matës e cila matej e faturuhej nga furnizuesi (neni 51), b-energji e llogaritur aforfe sipas kriterëve të miratuar nga ERE, e cila përdoret për faturimin e energjisë elektrike ndaj klientëve të cilët nuk ishin të pajisur me matës (neni 52). Kështu, në nenin 52 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” është parashikuar se: “1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë aparat matës për çdo klient të lidhur me rrjetin.* 2. *Për klientët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë të pajisur me aparat matës, për një periudhë transitorë, furnizuesi i propozon për miratim ERE-se një përdorim të përlllogaritur aforfe për këtë kategori klientësh, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga ERE-ja. Klienti, që nuk ka aparat matës, paguan në përputhje me këtë përlllogaritje.*” Afati i aplikimit të këtij lloj faturimi u shty disa herë deri në prill 2010 me qëllim për t’i krijuar mundësi furnizuesit të siguronte aparatet matës për të gjithë abonentët. Ndër vite, ERE ka miratuar me vendim “sasi fikse” të energjisë që duhet të faturuhej aforfe sipas llojit të klientëve dhe vendndodhjes së tyre. Pra, konstatohet se ky ligj fillimisht nuk parashikoi ndonjë mënyrë llogaritje për energjinë e konsumuar nga subjektet nga marrja e padrejtë të energjisë në cenim të aparateve matëse, të rrjetit ose pa kontratë etj. megjithëse në nenin 51 të tij ndëshkonte ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes.

39. Për shkak të problematikave të dala gjatë zbatimit të ligjit të mësipërm, ky ligj pësoi ndryshime, që kryesisht konsistonin në sanksione të vendosura për parandalimin e mënyrave të paligjshme të lidhjes dhe konsumit të energjisë elektrike, si dhe parashikimin e mënyrave për të bërë të mundur pagesat e energjisë të konsumuar në raste të tilla. Kështu me ligjin nr. 9750, datë 4.6.2007 u shtua në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 46/1 me këtë përmbajtje: “1. *Lidhja elektrike pa kontratë, lidhja elektrike para aparatit matës dhe cenimi i vulave ose dëmtimi i sistemit matës të energjisë elektrike nga përdoruesit familjarë, kur këto shkelje nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë si më poshtë: a) për lidhje abuzive para sistemit matës, nga 1 000 deri në 5 000 lekë; b) për cenim të sistemit matës dhe të vulave të tij, nga 1 000 deri në 10 000 lekë; c) për lidhje në rrjetin elektrik pa kontratë, nga 5 000 deri në 20 000 lekë. Në çdo rast, krabash gjobës, ka edhe detyrimin e shlyerjes së dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës.* 2. *Kur shkeljet e*

përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhen nga përdoruesit jofamiljarë, dënohen me gjobë si më poshtë:Në çdo rast, krahas gjobës, ka edhe detyrimin e shlyerjes së dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës. 3. Për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje, zbatohet tabela e penalteteve dhe e dëmeve, miratuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike. 4. Gjohat vendosen dhe vilen nga inspektorët e strukturës përgjegjëse për kontrollin e energjisë elektrike në KESH sh.a. Paga e gjobës bëhet brenda 10 ditëve nga data e vendosjes së saj. 5. Gjoha përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbartimit. 6. Kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet ankim me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij, tek titullari i strukturës përgjegjëse për kontrollin e energjisë elektrike, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 30 ditëve. 7. Me shpalljen e vendimit të mospranimit të ankimit bëhet menjëherë ndërprerja e furnizimit me energji elektrike...”

40. Me këtë dispozitë shtesë të ligjit, është parashikuar krahas sanksionit me gjobë edhe “detyrimi i konsumatorit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës.”. Për sa i përket metodologjisë së llogaritjes së dëmit, kjo dispozitë ngarkoi me këtë detyrim Entin Rregullator të Energjisë sipas pikës 3 të dispozitës, ku parashikohej shprehimisht se “3. Për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje, zbatohet tabela e penalteteve dhe e dëmeve, miratuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.” Pra në mënyrën e formulimit të saj kjo dispozitë rinjohu llogaritjen e dëmit ekonomik, që përfaqësonte energjinë e konsumuar nëpërmjet marrjes së padrejtë së saj, ashtu sikurse e kishte parashikuar edhe ligji nr. 7962/1995 në nenin 17 të tij, duke u përdorur rishtazi si kritere llogaritjeje metodat e miratuara nga ERE. Akti shkresor, që pasqyrore dëmin ekonomik është fatura e lëshuar nga shpërndarësi.

41. Sipas nenit 46/1 pika 5 të sipërcituar u parashikua se gjoha kishte cilësinë e titullit ekzekutiv, ndërkohë që nuk u bë ndonjë parashikim i tillë për dëmin ekonomik, kjo jo pa qëllim pasi ky i fundit si “energji e konsumuar” pa autorizim nga subjekti e kishte një cilësi të tillë sipas ligjit nr. 8662/2000, që konsideronte titull ekzekutiv faturën tatimore të konsumit të energjisë elektrike. Këtu mbahet parasysh edhe fakti se sipas parimit historik të interpretimit të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe atij evolutiv ndër vite faturimi i dëmit ekonomik si energji e konsumuar, por e llogaritur sipas metodologjisë së ERE-s ishte njohur që nga ligji nr. 7962/1995.

42. Me parashikimet e mësipërme, ligji “Për sektorin e energjisë” nuk referoi rrugën gjyqësore për kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar sipas nenit 608 të KC-së as për sa i përket vërtetimit të fajit, të ndërhyrjes së paligjshme, lidhjes shkakësore dhe as për llogaritjen e vlerës së dëmit, por përcaktoi për llogaritjen e dëmit të metodologjia e ERE-s duke qenë kjo e fundit institucioni, që vendoste rregulla, madje edhe tabela të vlerave për dëmin ekonomik. Ky i fundit përbënte energjinë e konsumuar, por të pamatur, njëloj sikurse njëherë ai edhe nga ligji nr. 7962/1995. Vlera e kësaj energjie, që konsiderohej “Dëm”, pasi përfitohej në mënyrë të paligjshme nga konsumatori, llogaritej sipas tabelave të ERE-s, e cila përcaktonte vlerat përkatëse sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje. Duke qenë se dëmi ekonomik përbënte një energji të konsumuar, por të matur jo me aparate matëse, por sipas metodologjisë së ERE-s në bazë të delegimit që vetë ligji i jepte ERE-s, atëherë mënyra e vjeljes së tij ndaj abonentit ishte e njëjtë me atë të energjisë së konsumuar, që ishte ajo nëpërmjet faturës së energjisë elektrike.

43. Ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i mënyrës së kërkimit dhe i përcaktimit të dëmeve ekonomike në përgjithësi ka pasur si qëllim të krijojë një mbrojtje të veçantë për sektorin e energjisë elektrike nga abuzimet dhe konsumi i papaguar i energjisë elektrike, duke shmangur rrugën gjyqësore për kërkimin e dëmit, e cila në krahasim me vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, është më pak efektive. Nuk ka dyshim që në referim të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, edhe fatura tatimore e lëshuar për faturimin e dëmit

ekonomik përbën titull ekzekutiv, për shkak se është faturë e konsumit të një sasie të energjisë elektrike (dëm ekonomik i përllogaritur sipas metodës së ERE-s).

44. Një gjë e tillë u bë më e qartë me ndryshimet ligjore, që pasuan në vijim ligjin nr. 9072/2003 dhe vendimet e ERE-s të dhëna pas këtyre ndryshimeve. Kështu me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 10.10.2008, hyrë në fuqi në tetor 2008, u shfuqizua shkronja “c” e nenit 46, si dhe neni 46/1 i sipërcituar. Me këto shfuqizime ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” nr. 9072/2003 nuk parashikoi më mënyrën e llogaritjes së dëmit nga konsumi i paautorizuar i energjisë elektrike dhe për pasojë as mënyrën e kërimit të dëmit si energji “e konsumuar” me anë të faturës tatimore si titull ekzekutiv. Për të ndaluar faturimet e dëmit ekonomik nga shoqëria furnizuese pas shfuqizimit të nenit 46/c dhe 46/1 të ligjit, Enti Rregullator i Energjisë nxori vendimin nr. 90, datë 15.11.2010, i cili në pikën 2 parashikoi: *“Të gjitha faturimet e kryera nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a. ndaj abonentëve familjarë dhe jofamiljarë me emërtimin “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur”, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008, janë të paligjshme”*. Në përputhje me këtë vendim kuptohet se ERE konstatonte të paligjshme faturimin e dëmit ekonomik të kryer për periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997/2008, gjë që do të thotë se në interpretim “ad contrario” ky institucion i pavarur rregullator në fushën e energjisë elektrike njihte si të vlefshme e të ligjshme të gjitha faturimet e bëra për këtë institut për periudhën para hyrjes në fuqi të këtij ligji duke pranuar në këtë mënyrë se faturimi i dëmit ekonomik sipas metodologjisë së miratuar prej saj ishte pjesë e faturës së energjisë elektrike e për rrjedhojë titull ekzekutiv, para se të bëheshin ndryshimet ligjore me ligjin nr. 9997/2008.

45. Me vendimin nr. 94, datë 1.12.2010, ERE plotësoi vendimin nr. 90 të sipërcituar me parashikimin se; *Në pikën 2, të vendimit nr. 90, datë 15.11.2010, bëhet një ndryshim duke shtuar pas fjalëve “energji e pamatur” shprehjen si më poshtë: “Për ato raste kur nuk aplikohet në zbatim të pikës IV.9 të Kodit të Matjes”*. Në përputhje me këtë klauzolë shtesë ERE përjashtoi nga fusha e zbatimit të vendimit nr. 90/2010 ato fatura të energjisë elektrike me emërtimin “energji e pamatur” kur kjo e fundit ishte vendosur në zbatim të pikës IV.9 të Kodit të Matjes, pra jo si dëm ekonomik. Ndërkohë vendimi i ERE-s nr. 90/2010 vazhdonte të ishte në fuqi për deklarimin e pavlefshme të faturave të lëshuara në zërin energjia e pamatur kur kjo e fundit ishte vendosur si pasojë e llogaritjes së dëmit ekonomik. Përjashtimi i pasqyruar në vendimin nr. 94/2010 të ERE-s ka të bëjë me faturimin e energjisë së pamatur si pasojë e regjistrimit gabim të matësit. Sipas nenit IV.9 të Kodit të Matjes së miratuar me vendimin nr. 101, datë 26.8.2008 parashikohet: *Sa herë që konstatohet nga OSSH-ja ose subjekte të tjera të autorizuar nga legjislacioni në fuqi, që matësi i kalon kufijtë e tij të saktësisë të përcaktuara në këtë Kod Matje (minus ose plus) atëherë do të aplikohet procedura e mëposhtme: [...] kur kemi rezultate të pasakta dhe gabim i kalon kufijtë e saktësisë së përcaktuar në kodin e matjes (minus ose plus) dhe klienti ka paguar më pak atëherë konsumatori është i detyruar të paguajë vlerën e mbetur për të paktën për 12 muaj. Pagesat do të bëhen duke korrigjuar faturat e tjera deri në kryerjen e plotë të pagesës ose kjo pagesë mund të paguhet e plotë brenda 45 ditëve nga evidentimi i saktësisë së matjes (faturimit)*. Pra, nëpërmjet vendimit nr. 94/2010, ERE konsideroi të ligjshme faturimet e bëra nga kompania furnizuese në zërin “energji e pamatur” në rastet e gabimeve në matje për shkak të defekteve teknike të matësit, megjithëse edhe në këto raste llogaritja e energjisë nuk bëhej nga matja e saktë e aparatit matës, por sipas metodës së përcaktuar nga ERE në Kodin e Matjes duke marrë për bazë marxhin e gabimit, energjinë e regjistruar në matës dhe periudhën e korrigtimit sipas Kodit të Matjes. Kjo tregon se faturat e lëshuara për gabimet në matje vazhduan të konsiderohen në përputhje me ligjin nr. 8662/2000 si fatura të konsumit të energjisë, megjithëse nuk ishin rezultat drejtpërdrejt i matjes së energjisë nga aparati matës, duke gëzuar cilësinë e titullit ekzekutiv sipas këtij ligji.

46. Më tej, për t’u plotësuar boshllëku ligjor i krijuar nga ligji nr. 9997/2008 për llogaritjen e faturimit të dëmit ekonomik, ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” pësoi sërish ndryshime me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010. Konkretisht në pikën 14 të nenit 51 të këtij ligji u parashikua se *“Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në*

përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”, dispozitë që është në fuqi aktualisht. Ky ligj është botuar në fletoren zyrtare nr. 179, datë 31.12.2010 dhe ka hyrë në fuqi në muajin 15 Janar të vitit 2011. Ky formulim i përllogaritjes së dëmit ekonomik është i njëjtë me atë të ligjit nr. 7962/1995, që ishte në fuqi në kohën, kur u parashikua për herë të parë fatura e energjisë elektrike si titull ekzekutiv dhe me atë me nr. 9072/2003 para shfuqizimeve të ligjit nr. 9997/2007. Duke qenë se ligji nr. 9072/2003 me ndryshimin e pësuar nga ligji nr. 10362/2010 risolli të njëjtin model përllogaritje të dëmit ekonomik siç ka qenë në ligjin nr. 7962/1995 atëherë ky institut si në drejtim të kuptimit të tij, zbatimit dhe mënyrës së kërkimit të tij do të gëzonte të njëjtat cilësi si edhe me ligjin e mëparshëm, në përputhje kjo me parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe të interpretimit historik e evolutiv të ligjit.

47. Këtë qëndrim ka mbajtur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe në vendimin njësoes nr. 00-2023-4411, datë 2.3.2023, ku ka theksuar se; *është në diskrecionin e ligjvënësit që të zgjedhë nëse norma që kanë qenë parashikuar në legjislacionin e mëparshëm, do të rikthehen në fuqi apo jo. Po sipas arsyetimit të mësipërm, nëse ligjvënësi vendos t'i riktheje këto norma në fuqi, duke i parashikuar në mënyrë identike në ligjin e ri që miraton, konsiderohet se norma e re ruan të njëjtin kuptim, siç i ishte dhënë nga jurisprudenca dhe doktrina juridike e kohës. Kolegji vlerëson se do të përbënte non sens juridik që e njëjta normë me përmbajtje identike të kishte kuptime të ndryshme në kohë të ndryshme.*

48. Veç interpretimit historik, kuptimi i dëmit ekonomik si energji e konsumuar e përllogaritur nga shoqëria furnizuese e për rrjedhojë pjesë e faturës së konsumit të energjisë elektrike del edhe nga interpretimi sistematik i gjithë paragrafëve të nenit 51 të ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar nga ligji nr. 10362/2010. Kështu, kjo dispozitë titullohet ‘Matja e energjisë elektrike’ dhe në të janë parashikuar si forma të matjes së energjisë si ajo e nxjerrë nëpërmjet leximit të matësit e deri tek ajo e llogaritur për dëmin ekonomik të shkaktuar si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme, që bëhet sipas metodologjisë së miratuar nga ERE. Po në nenin 52 të ligjit parashikohet përllogaritja e faturimeve afrofe për një periudhë tranzitore pa matës sipas metodologjisë së ERE-s. Në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar, furnizuesi ka të drejtën e lëshimit të faturës së konsumimit të energjisë elektrike dhe përmbushin të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi. Janë pikërisht këto detyrime, që normojnë mënyrën se si dhe kur furnizuesi kishte të drejtë të faturonte energjinë e konsumuar nga ndërhyrja e paligjshme, e cila konsiderohej dëm ekonomik sipas metodologjisë së ERE-s.

49. Bazuar në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar, me nenin 8, pika “d” dhe nenin 51, pika 14, është miratuar vendimi nr. 42, datë 21.4.2011 i Entit Rregullator të Energjisë ‘Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së faturimit të dëmit ekonomik’, i ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.7.2012, ku janë përcaktuar vlerat fikse të dëmit ekonomik sipas konsumatorëve tipik të energjisë. Janë pikërisht këto vlera, që i faturohen subjekteve, që përfitojnë energji pa u matur në cenim të matësit apo të rrjetit të shpërndarjes energjisë elektrike. Në pikën 4 të këtij vendimi, është sqaruar koncepti i dëmit ekonomik duke përcaktuar: *“Dëmi ekonomik është vlera korresponduese në lekë e sasisë së energjisë elektrike (KWH) të konsumuar mesatarisht gjatë një viti prej një konsumatori/klienti tipik të secilës kategori. Sasia e energjisë së konsumuar është llogaritur si produkt i konsumit mesatar mujor të një konsumatori/klienti tipik, të kategorisë ku shkaktari i dëmit bën pjesë, me numrin e muajve të një viti”*. Pra, në përputhje me këtë metodologji kuptohet se dëmi ekonomik nuk është penalitet, por është vlera korresponduese e sasisë së energjisë e llogaritur si produkt konsumi, duke pasur për rrjedhojë të njëjtin kuptim si terminologjia “konsum i energjisë” që përdoret për të identifikuar faturën e energjisë elektrike titull ekzekutiv. Fakti se përllogaritja e këtij konsumi bëhet për një periudhë 12 ose 19 muajore nuk cenon cilësinë e dëmit ekonomik si energji konsumi, pasi e njëjta logjikë përdoret për llogaritjen e energjisë së pamatur si rezultat i gabimeve në matje sipas pikës IV të Kodit të Matjes, faturë kjo që gjithmonë e ka pasur cilësinë e titullit ekzekutiv.

50. Metodologjia e miratuar nga ERE me vendimin nr. 42/2011 e ndryshuar ka vendosur vlera fikse faturimi për dëmin ekonomik sipas kategorisë së abonentëve, gjë që kufizon veprimet e njëanshme të palës furnizuese në përlogaritjen e dëmit ekonomik. Për aq kohë sa kjo metodë ishte e miratuar nga një organ i deleguar nga ligji për një gjë të tillë, përlogaritja e vlerës së energjisë së konsumuar si dëm ekonomik nga shoqëria furnizuese në faturë nuk përbënte cenim të parimit të barazisë kontraktore të palëve. ERE përbën një ent ligjor kompetent që qëndron mbi palët dhe i është deleguar një e drejtë e tillë në përcaktimin e metodologjisë së dëmit ekonomik nga ligji.

51. Janë pikërisht këto akte ligjore e nënligjore që i njohën të paditurit (OSHEE sh.a.) të drejtën e përlogaritjes dhe faturimit të dëmeve ekonomik shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme, nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10360/2010 në janar 2011 e në vazhdim. Megjithatë, një e drejtë e tillë mund të ushtrohet vetëm në ato raste kur shoqëria shpërndarëse konstaton cenime në aparatin matës ose në linjën elektrike, të cilat krijojnë dyshime të bazuara për marrjen e padrejtë të energjisë elektrike, tej asaj të regjistruar në matës, ose që nuk regjistrohej në këtë të fundit.

52. Ligji special nr. 9072/2003 ka prioritet në zbatim, në përputhje me parimin *lex specialis derogat generalis*, duke shmangur aplikimin e rregullave të përgjithshme të llogaritjes së dëmit sipas KC-së nga gjykata, nisur kjo dhe nga rëndësia jetike që ka furnizimi me energji elektrike për shoqërinë. Pikërisht për këtë shkak, ERE nxori vendimin nr. 42, datë 22.4.2011, që përcaktoi mënyrën e llogaritjes së dëmit ekonomik duke vendosur kufi standard të vlerës së dëmit të faturuar sipas kategorisë së konsumatorit, ku bën pjesë subjekti që ka cenuar. Në këtë mënyrë dihet vlera e dëmit ekonomik për çdo subjekt, gjë që bën të panevojshme llogaritjen e dëmshpërblimeve në rrugë gjyqësore. Nga ana tjetër, rruga gjyqësore do të rriste koston ekonomike e vonesat kohore të vjeljes së vlerave të dëmshpërblimeve, ndërkohë që sektori i energjisë elektrike ka një rëndësi jetike për shoqërisë dhe vonesat në shlyerjen e detyrimeve dëmtojnë ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji për të ardhmen për gjithë konsumatorët. Nisur nga kjo prevalencë ligjvënësi ka parashikuar, që faturat e energjisë elektrike të kenë fuqinë e titullit ekzekutiv në tërësinë e tyre si për pjesën e energjisë së matur dhe për atë të pamatur qoftë kjo e fundit rezultat i faturimit afrofe ose për shkak të gabimit në matje apo dëmit ekonomik, pasi në të gjitha rastet kemi të bëjmë me energji të konsumuar.

53. Edhe pse për periudhën 2008 deri në janar 2011 fatura e energjisë elektrike për pjesën e llogaritjes së dëmit ekonomik nuk gëzonte cilësinë e titullit ekzekutiv, pasi kompanisë furnizuese ju hoq e drejta e faturimit të këtij dëmi, ndryshimi që solli ligji nr. 10362, datë 16.12.2010 në ligjin nr. 9072, në nenin 51/14, i riktheu shoqërisë furnizuese të drejtën e faturimit të kësaj energjie të konsumuar nga klientët, si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme në matës ose në rrjetin e shpërndarjes, duke e kontrolluar këtë faturim nëpërmjet vendosjes së kriterëve nga ERE. Është furnizuesi ai, që kontrollon gjendjen e matësit dhe faturon energjinë e konsumuar. Në këto kushte duke qenë se dëmi ekonomik nuk është gjë tjetër veçse energji, që është konsumuar nga klienti, por që nuk i është paguar rregullisht furnizuesit, përlogaritja e tij bëhet po nga kompania shpërndarëse, por duke iu përmbajtur kriterëve të ERE-s, që është një entitet ligjor i pavarur nga palët. Kështu që edhe në kontekstin historik parashikimi i nenit 51/14 në ligjin nr. 9072 nuk solli asnjë cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi e drejta e furnizuesit që të faturonte dëmin ekonomik ishte e njohur edhe më parë, përkundrazi aktualisht ajo është normuar në mënyrë më të detajuar sipas rregullave të ERE-s.

54. Në delegimin, që ligji i ka bërë ERE, në nenin 51/14 të ligjit nr. 9072, të ndryshuar, për përcaktimin e kriterëve të llogaritjes së dëmit ekonomik, nuk ka asnjë cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nenit 17 të saj, dhe as të barazisë së palëve para ligjit sipas nenit 18 të Kushtetutës. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 5.12.2012, ERE është cilësuar si institucion i pavarur mbikëqyrës për ruajtjen e ekuilibrave ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike. Po ashtu edhe në ligjin e ri 43/2015, “Për energjinë elektrike” në nenin 10 të tij, ERE përkufizohet si një

person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat. Pra si në drejtim të funksionimit dhe të kompetencave ky institucion plotëson kushtet e një institucioni të pavarur *quasi* gjyqësor, pasi qëndron mbi palët, si atë furnizuese dhe të furnizuar, dhe përbën garanci për ekuilibrin e interesit publik me atë të individit në rregullimin e kuadrit nënligjor në marrëdhëniet juridike midis palëve. Në këto kushte, me të drejtë ligjvënësi i ka deleguar këtij institucioni përcaktimin e kriterëve për përllogaritjen e vlerave të dëmeve ekonomike nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjet ose në matës.

55. Në legjislacionin mbi sektorin e energjisë elektrike ka parashikime të hollësishme mbi trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve, duke i dhënë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike kompetencën e trajtimit administrativ të ankesave të konsumatorëve, në rast të mosmarrëveshjeve mes furnizuesit dhe konsumatorëve. Po në këtë drejtim mund të theksohet dhe detyrimi i aprovimit të Kontratës Tip të furnizimit me energji elektrike ndërmjet konsumatorëve tarimore dhe furnizuesit, nga ERE, institucion i pavarur mbikëqyrës për ruajtjen e ekuilibrave ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike. Në këtë kontratë është parashikuar një procedurë e detajuar e verifikimit të ankesave nga furnizuesi, e pezullimit të ekzekutimit të faturës për faturime dukshëm të larta, si dhe anulimit tërësisht ose pjesërisht të faturës së energjisë elektrike, në rast se ankimi qëndron, duke garantuar mbrojtje të interesave të konsumatorëve nëpërmjet një procesi administrativ.

56. Mbi këtë bazë, ERE ka nxjerrë vendimin nr. 42, datë 22.4.2011 ku ka përcaktuar vlerat e dëmit ekonomik për çdo kategori të konsumatorëve. Në nenin 2 të kësaj rregullore parashikohet; *Kjo metodologji do të jetë e zbatueshme në rastet kur një entiteti të caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëm ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të kompanisë së shpërndarjes.* Referimi i bërë në nenin 2 të sipërcituar të një “entiteti të caktuar me ligj”, nuk do të thotë se llogaritja e dëmit ekonomik bëhet nga një subjekt tjetër ligjor i ndryshëm nga shoqëria shpërndarëse. Në kushtet, kur ligji specifik nr. 9072/2003 nuk ka përcaktuar asnjë entitet ligjor të ndryshëm nga kompania shpërndarëse, për të bërë llogaritjen e dëmit ekonomik, madje as e ka përmendur termin entitet ligjor, atëherë akti nënligjor për këtë pjesë nuk ka asnjë fuqi detyruese pasi nuk mund të tejkalohet kufijtë e ligjit. Gjykata ka për detyrë të interpretojë përmbajtjen e aktit nënligjor në përputhje me ligjin në zbatim, të të cilit ai ka dalë dhe jo në kundërshtim me të.

57. Duke interpretuar vendimin e ERE-s nr. 42/2011 në përputhje me nenin 51/14 të ligjit nr. 9072/2003 kuptohet se togfjalëshi “enti ligjor” i përdorur në këtë vendim nënkupton subjektin, i cili ka të drejtë të verifikojë cenimin e matësit, të rrjetit të shpërndarjes dhe marrjen pa të drejtë të energjisë, pasi faturimi i dëmit ekonomik është pikërisht pasojë e këtyre fakteve të paligjshme. Përderisa një të drejtë të tillë e ka kompania furnizuese ose shpërndarëse, atëherë është po kjo shoqëri, që ka të drejtë të faturojë dëmin ekonomik sipas ligjit nr. 9072/2003. Një konkluzion i tillë del edhe nga fakti se ka qenë ish-shoqëria CEZ shpërndarje sh.a., pra ajo furnizuese që dëmtohej nga marrja e padrejtë e energjisë, që ka vënë në lëvizje Entin Rregullator të Energjisë Elektrike për të nxjerrë vendimin nr. 42/2011. Të njëjtën logjikë ndjek ligji nr. 9072/2003 në nenin 52 të tij lidhur me tarifat e vendosura nga ERE për energjinë afrofe, ku parashikon; *Për klientët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë të pajisur me aparat matës, për një periudhë tranzitore, furnizuesi i propozon për miratim ERE-së një përdorim të përllogaritur aforfe për këtë kategori klientësh, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga ERE. Klienti, që nuk ka aparat matës, paguan në përputhje me këtë përllogaritje.* Pra nën interpretimin logjik të kësaj dispozite edhe në rastin e përcaktimit të metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik, sikurse për faturimin afrofe, shoqëria furnizuese jo vetëm ka iniciuar procedurën e miratimit nga ERE të kësaj metodologjie, por ka siguruar njëkohësisht edhe të drejtën për të zbatuar këtë metodologji në përllogaritjen e vlerave korresponduese të energjisë së konsumuar si dëm ekonomik.

58. Fakti se parashikimi i nenit 51/14 i shtruar në ligjin nr. 9072/2003 i riktheu të drejtën shoqërisë furnizuese për faturimin e dëmit ekonomik si pjesë të faturës së energjisë elektrike del jo vetëm nga

mënyra se si ka gjetur zbatim kjo dispozitë nga ERE me miratimin e metodologjisë përkatëse, emetimi ndër vite nga shoqëria furnizuese i faturave në përlllogaritje të dëmit ekonomik, por edhe nga mosekzistenca e asnjë vendimi të dhënë nga ERE në penalizim të shoqërisë furnizuese për lëshimin e faturave të energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik, në ndryshim nga qëndrimi i mëparshëm, që ky institucion ka mbajtur kur nxori vendimin nr. 90/2010 pas shfuqizimit të nenit 46/1 I ligjit nr. 9072/2003 nga ligji nr. 9997/2007. Një gjë e tillë mbështetet edhe nga praktika e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese e cila për disa herë me radhë nuk ka pranuar kërkesa e paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për shfuqizimin e nenit 51/14 të ligjit nr. 9072/2003, madje edhe të nenit 77 të ligjit nr. 43/2015 që ka bërë të njëjtin parashikim, dispozitë që sipas gjykatave ka cenuar parimet e barazisë ekonomike të palëve dhe të ligjshmërisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga gjykata.

59. Kështu Kolegji seleksionues i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 231 datë 12.12.2016 ka vendosur moskalimin në seancë plenare të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë për shfuqizimin e nenit 51/14 të ligjit nr. 9072/2003, për llogaritjen e dëmit ekonomik nga shoqëria OSHEE sh.a. duke sjellë në vëmendje jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese mbi legjitimitetin kushtetues të trajtimit të faturave të energjisë elektrike si tituj ekzekutive, duke arsyetuar ndër të tjera se: *Gjykata referuese ka ngritur dyshime mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 14 të nenit 51 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Kolegji konstaton se në çështjen që është paraqitur prej gjykatës referuese është para rastit kur operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike, pasi konstaton ndërhyrje të paligjshme në rrjet e për pasojë përfitim të padrejtë ekonomik të konsumatorit, llogarit dëmin ekonomik të shkaktuar.... Gjykata Kushtetuese pretendimet e parashtruara prej gjykatës referuese i ka arsyetuar në vendimin nr. 52, datë 5.12.2012 me objekt konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", të ndryshuar. Gjykata ka arritur në përfundimin se ligjvënësi ka respektuar ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik, nga njëra anë, që synon qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, garantimin për vjeljen e detyrimeve brenda një afati të arsyeshëm e për rrjedhojë përmirësimin e cilësisë dhe të aksesit të këtij shërbimi, si dhe, nga ana tjetër, ka garantuar mbrojtjen ligjore të individit, në rastet e abuzimit me faturat e energjisë elektrike. Fatura e energjisë elektrike përbën titull ekzekutiv, ekuilibrin interesat e vëna në diskutim, si dhe është diktuar nga domosdoshmëria dhe efektshmëria për të realizuar shlyerjen e detyrimeve financiare të energjisë elektrike nga konsumatorët brenda një afati kohor të arsyeshëm. Gjykata thekson se neni 609 i KPC-së i njehtë drejtën e debitorit të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas². Për rrjedhojë, procedura e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, bazuar në ligjin për atribuimin e faturave të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, nuk është procedurë e pakthyeshme,...Për këtë arsye, ligji përmbush standardet e kërkuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për parimin e sigurisë juridike, të barazisë së palëve dhe të kufizimit të të drejtave³.* Pra me këtë vendim gjykata kushtetuese i ka dhënë fund diskutimit ligjor nëse fatura e energjisë elektrike për pjesën e faturimit të institutit të dëmit ekonomik kishte apo jo cilësinë e titullit ekzekutiv duke e gjetur në përputhje me Kushtetutën parashikimin ligjor të nenit 51/14 të ligjit nr. 9073/2003 të ndryshuar, që i njohu ERE të drejtën e përcaktimit të metodologjisë së përlllogaritjes së tij, të zbatueshme nga kompania e shpërndarjes.

60. Rishtazi Gjykata e Apelit Durrës ka dërguar për shfuqizim nenin 51/14 të ligjit nr. 9072/2003 duke e shtrirë kontrollin kushtetues edhe te neni 77 pika 9 e ligjit të ri që bënte të njëjtin parashikim me arsyetimin se; *Mënyra e formësimit të titullit ekzekutiv dhe se baza ligjore për të zgjidhur çështjen është pika 14 e nenit 51 të ligjit nr. 9072/2003, si norma në fuqi në momentin e emetimit të faturës së energjisë elektrike, për rrjedhojë e zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete. Sipas kësaj dispozite ligjvënësi i ka deleguar ERE-s kompetencën legjislative për të normuar me akt nënligjor normativ dhe në ushtrim të kësaj kompetence kjo e fundit ka miratuar metodologjinë e përcaktimit të vlerës së dëmit ekonomik me vendimin nr. 42/2011. Gjykata referuese, duke konstatuar*

² Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 16.10.2007.

³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 231, datë 12.12.2016.

se ERE nuk është organ që bën pjesë në strukturën e organeve kushtetuese dhe as organ që parashikohet nga Kushtetuta, ka vlerësuar se pika 14 e nenit 51, që i ka dhënë ERE-s të drejtën të hartojë legjislacion të deleguar, ka krijuar një situatë antikushtetutshmërie. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 27, datë 13.2.2023 ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare me arsyetimin se; gjykata referuese nuk ka arritur të argumentojë në vendimin e saj për pezullimin e gjykimit se përse pika 14, e nenit 51, të ligjit 9072/2003, sikundër edhe vendimi i ERE-s, për të cilat ka ngritur probleme të pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe ka vënë në lëvizje kontrollin e kushtetutshmërisë së normës ligjore, janë pikërisht “ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete gjyqësore”. Për rrjedhojë, gjykata referuese nuk ka arritur të argumentojë as se mbi çfarë baze ka krijuar bindjen se gjykimi i çështjes nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese, duke mos arritur të identifikojë kështu lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese. Po ashtu, në linjë me sa më sipër, në lidhje me thelbin e mosmarrëveshjes së parashtruar, ajo nuk ka bërë mjaftueshëm përpjekje për të identifikuar nëse ka norma të tjera të zbatueshme, me qëllim që të arrinte në përfundimin se ishte në pamundësi të zgjidhjes së çështjes konkrete në shqyrtim. Kolegji vëren se vetëm argumentet e gjykatës referuese se ligjvënësi nuk mund t’i delegonte pushtetin normativ një organi që nuk ka zotësi kushtetuese për të prodhuar akte nënligjore normative, nuk janë të mjaftueshme në nivel kushtetues për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë mes përmbajtjes së dispozitës së kundërshtuar si të papajtueshme me Kushtetutën dhe mosmarrëveshjes që po shqyrton gjykata referuese.

61. Nga sa më sipër duke mbajtur në konsideratë këtë praktikë të qëndrueshme të Gjykatës Kushtetuese rezulton se përcaktimi i kriterëve të përlllogaritjes së dëmit ekonomik nga ERE, që është një institucion publik i pavarur, garanton një balancë të arsyeshme midis interesit publik të qëndrueshmërisë së sistemit elektrik dhe interesit të ligjshëm të qytetarëve, për t’u mbrojtur nga abuzimet e shoqërive furnizuese, që faturojnë dhe vjelin pagesat e energjisë.

62. Në kuadër të parimit të sigurisë juridike konstatohet se edhe ligji nr. 43, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon të njëjtin qëndrim për mënyrën e llogaritjes së dëmit ekonomik si ligji i mëparshëm nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pas ndryshimeve me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010. Në pikën 9, të nenit 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, është parashikuar: “9. Operatori i sistemit nëse konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat është ndërhyrë, përlllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përlllogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.” Nisur nga ky përcaktim pothuajse i njëjtë Kolegji Civil vlerësoi të zgjerojë fushën e interpretimit njësoj të ligjit me qëllim për të ruajtur njëtrajtshmërinë e praktikës gjyqësore sigurisht duke mbajtur në konsideratë veçantitë, që ka ligji nr. 9072/2003 në raport me atë aktual nr. 43/2015 për procedurat dhe subjektin, që ka të drejtë të faturojë dëmin ekonomik.

63. Në përputhje me këtë dispozitë del e qartë se pas shfuqizimit të ligjit nr. 9702, datë 22.5.2003, me ligjin e ri nr. 43/2015 të drejtën për përlllogaritjen e të faturimit të dëmit ekonomik e ka në mënyrë të shprehur operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë. Në bazë të ligjit nr. 43/2015 *Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili ushtron këtë funksion përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush detyrimin e ndarjes, jo më vonë se data 31.12.2017.* Po sipas ligjit nr. 43/2015 parashikohet se *Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, kanë këto të drejta :a) të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, Kodeve të Rrjetit dhe kontratave përkatëse.*

64. Bazë për llogaritjen e dëmit ekonomik edhe sipas ligjit të ri është përsëri rregullorja e miratuar nga ERE. Pra edhe ligji i ri, i cili ka bërë një parashikim më të qartë të subjektit, që bën përlllogaritjen e dëmit ekonomik duke ia lënë atë operatorit të sistemit shpërndarës ose në marrëveshje me këtë

furnizuesit, ruan të njëjtin standard të sigurisë juridike për kriteret e përlllogaritjes së dëmit ekonomik sipas ERE.

65. Në zbatim të dispozitës së mësipërme ERE miratoi fillimisht me vendimin nr. 94/2016 metodologjinë që ka pasur për qëllim të rregullojë procedurën e rimbursimit të Operatorit të sistemit, në rastet kur konstaton ndërhyrje të paligjshme, përmes ndjekjes së procedurës ligjore lidhur me përlllogaritjen e rimbursimit përkatës. Objekti i rregullores së mësipërme, është përlllogaritja e dëmit ekonomik të shkaktuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes në boks individual, të cilat shmangin evidentimin e sasisë reale të energjisë elektrike të konsumuar prej tyre, nga klientët e energjisë elektrike, lidhja me një linjë të dytë furnizimi nga rrjeti, të paaautorizuar nga Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) të bërë nga një përdorues që ka një kontratë lidhje me rrjetin e OSSH-së, rilidhja e paaautorizuar e çdo përdoruesi të rrjetit, furnizimi i të cilit është ndërprerë nga OSSH-ja me kërkesë të përdoruesit/furnizuesit apo me iniciativë të OSSH-së. Kjo metodologji është hartuar në kushtet kur si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i shkaktohen humbje në sistemin e shpërndarjes dhe furnizuesi nuk mund të realizojë matjen e saktë të konsumit të energjisë elektrike në sistemin matës, gjë që mund të sjellë si pasojë moslëshimin e faturës së saktë të energjisë elektrike.

65.1. Në pjesën e tretë “Metodologjia për përlllogaritjen e dëmit ekonomik” është përcaktuar përlllogaritja e dëmit ekonomik, faturimi dhe pagesa e tij. Në këto dispozita është përcaktuar se: dëmi ekonomik do të jetë kundërvlefë në lekë e sasisë së energjisë elektrike e shprehur në kwh energji aktive, e kërkueshme prej OSSH ndaj përdoruesit të rrjetit, e cila përfaqëson energjinë elektrike të konsumuar pa autorizim nga ky i fundit; Llogaritja e sasisë së energjisë elektrike, e kërkueshme prej OSSH-së ndaj përdoruesit të rrjetit, do të bëhet bazuar në tabelën e Aneksit 1 të kësaj Rregullore; Çmimi i energjisë elektrike, i cili do të shërbejë për përlllogaritjen e kundërvlefës të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, do të përcaktohet si shuma e (I) çmimit mesatar të ponderuar të energjisë elektrike për njësi kwh, të blerë për mbulimin e humbjeve në periudhën që do të faturohet dëmi ekonomik me (II) kostot e transmetimit dhe (II) kostot e rrjetit në të cilin është kyçur përdoruesi për secilën kategori të tij. -Në faturën e lëshuar nga OSSH-ja për përdoruesin e rrjetit lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar, duhet të evidentohet çdo komponent që përben kundërvlefën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

66. Metodologjia për llogaritjen e dëmit ekonomik që i shkaktohet OSSH-së nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga përdoruesit e rrjetit të lidhur në sistemin e shpërndarjes është miratuar me vendimin nr. 232, datë 20.12.2019 të ERE-s “Rregullore dhe metodologjia për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”. Në nenin 2 të rregullores së sipërcituar përcaktohet qëllimi i kësaj rregulloreje, ndërsa në pikën 3 përcaktohet se: “Objekt i kësaj rregulloreje është përlllogaritja e dëmit ekonomik të shkaktuar Operatorit të sistemit të shpërndarjes nga; ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes në boks individual, të cilat shmangin evidentimin e sasisë reale të energjisë elektrike të konsumuar prej tyre, nga përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; lidhja me një linjë të dytë furnizimi nga rrjeti, të paaautorizuar nga OSSH-ja të bërë nga një përdorues që ka një kontratë lidhjeje me OSSH-në. rilidhja e paaautorizuar e çdo përdoruesi të rrjetit, furnizimi i të cilit është ndërprerë nga OSSH-ja me kërkesë të përdoruesit/furnizuesit apo me iniciativë të OSSH-së.”

66.1 Në rast se operatori konstaton, qoftë edhe njërin nga rastet e sipërcituara, përlllogarit dëmin, sipas metodologjisë së miratuar nga ERE, dhe e faturon atë. Fatura lëshohet në përputhje me udhëzimin e ministrit të Financave nr. 6/2015, (i ndryshuar) “Për tatimin e vlerës së shtuar në RSH”, lidhur me elementët që duhet të përmbajë një faturë tatimore shitejeje.

66.2 Në nenin 9 të rregullores përcaktohet se: “Dëmi ekonomik do të jetë kundërvlefë në lekë e sasisë së energjisë elektrike e shprehur në Kwh energji aktive, e kërkueshme prej OSSH ndaj përdoruesit të rrjetit, e cila përfaqëson energjinë elektrike të konsumuar pa autorizim nga ky i fundit. 2. Llogaritja e sasisë së energjisë elektrike, e kërkueshme prej OSSH-së ndaj përdoruesit të rrjetit, do të bëhet bazuar në tabelën e Aneksit 1 të kësaj

Rregullore. ...4. Në faturën e lëshuar nga OSSH-ja për Përdoruesin e rrjetit lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar, duhet të evidentohet çdo komponent që përben kundërvleftën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”. Në nenin 10 të rregullores, përcaktohet procedura e kontrollit dhe e faturimit të energjisë së faturuar ku ndër të tjera përcaktohet se 2. OSSH-ja lëshon faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përllogaritur për përdoruesin të rrjetit, jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi, e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj... 4. Në mungesë të pagesës të faturës nga Përdoruesi i Rrjetit, brenda afatit të caktuar për pagesë sipas pikës 3 të këtij neni, OSSH-së i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Përdoruesit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit dhe Furnizuesin, 48 orë përpara.”

66.2 Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61 datë 25.2.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në nenin 10 të “Rregullores dhe Metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, për afatet e lëshimit të faturës për përdoruesin e Rrjetit dhe njoftimin e furnizuesit. Në nenin 9 të kësaj rregulloreje është parashikuar: “1. Dëmi ekonomik do të jetë kundërvlefta në lekë e sasisë së energjisë elektrike e shprehur në kwh energji aktive, e kërkueshme prej OSSH-së ndaj Përdoruesit të rrjetit, e cila përfaqëson energjinë elektrike të konsumuar pa autorizim nga ky i fundit. 2. Llogaritja e sasisë së energjisë elektrike, e kërkueshme prej OSSH ndaj përdoruesit të rrjetit, do të bëhet bazuar në tabelën e aneksit 1 të kësaj rregullore. ...4. Në faturën e lëshuar nga OSSH për përdoruesin e rrjetit lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar, duhet të evidentohet çdo komponent, që përben kundërvleftën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.” Ndërsa në nenin 10 të po kësaj rregulloreje është parashikuar: “2. OSSH lëshon një faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përllogaritur për Përdoruesin e rrjetit, brenda ciklit të leximit/faturimit (30 ditë), e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me Përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj. 1. Përdoruesi i rrjetit do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën e dëmit ekonomik, jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës. 2. Në mungesë të pagesës të faturës nga Përdoruesi i Rrjetit, brenda afatit të caktuar për pagesë sipas pikës 3 të këtij neni, OSSH-ja i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Përdoruesit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit dhe Furnizuesin, 48 orë përpara.”

67. Sa më sipër, dëmi ekonomik llogaritet në bazë të konsumit mesatar të konsumatorëve të grupit, ku bën pjesë. Në këtë kontekst, dëmi ekonomik duhet të përfshihet në bilancin e energjisë, duke qenë se përfaqëson energjinë e konsumuar nga klienti/joklienti. Për të përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik, vendimi i ERE-s në mënyrë eksplicite konsideron konsumin mesatar të energjisë sipas grupit të konsumatorëve, mbi të cilin aplikohet çmimi i rregulluar dhe jo çmimi i tregut, sipas një modeli që bazohet mbi konsumin dhe jo mbi sanksionin. Koncepti i dëmit ekonomik ka të bëjë me rikuperimin e vlerës monetare për çdo periudhë kohe, gjatë së cilës është kryer një lidhje e paligjshme.

68. Duke iu referuar gjithë këtij kuadri ligjor të ri të sipërcituar rezulton se legjislatori ka ruajtur të njëjtin kuptim ligjor të dëmit ekonomik si kundërvlefta në lekë e sasisë së energjisë së konsumuar në mënyrë të paautorizuar nga përdoruesi dhe e kërkueshme ndaj tij sikurse parashikohej kuptimi i tij në vendimin e ERE-s nr. 42/2011 të dalë në zbatim të ligjit nr. 9072/2003. Po ashtu metodologjia e llogaritjes dhe e faturimit është bërë po me akte të nxjerrë nga ERE, pavarësisht se faturimi i është dhënë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Përsëri në këtë ligj nuk është bërë ndonjë parashikim i shprehur mbi cilësinë ose jo si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike të lëshuar për dëmin ekonomik, madje nuk rezulton të jetë bërë ndonjë cilësim i tillë as për faturat e tjera, që mund të lëshohen nga matja ose ato provizore, kur matësi ka qenë jashtë kushteve teknike etj. Megjithatë në nenet 91 e 92 të ligjit nr. 43/2015 parashikohet mënyrat se si vilen detyrimet e papaguara duke u parashikuar si forma të arritjes së këtij qëllimi a-ndërprerja e energjisë elektrike, b-kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas përcaktimeve të KPC-së dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe c-vendosja e barrës hipotekore mbi pasurinë furnizuar kur detyrimi kalon vlerën mbi 1500 000 lekë. Në asnjë prej dispozitave të ligjit nuk parashikohet që vlera e

dëmit ekonomik të faturuar ose jo të kërkohet nëpërmjet ngritjes së padisë në gjykatë sipas nenit 608 e vijues të KC-së ose të përcaktohej me vendim gjykate. Përkundrazi e vetmja mënyrë për të realizuar vjeljen e vlerës korresponuese të energjisë së konsumuar, ku përfshihet edhe dëmi ekonomik si energji e konsumuar në mënyrë të paligjshme, është nëpërmjet faturimit të energjisë elektrike.

69. Pra, në unitet të parashikimeve si nga ligji nr. 9072/2003 dhe ai nr. 43/2015 e akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre del e qartë se e vetmja mënyrë si mund të realizohet vjelja e vlerës së energjisë së konsumuar në ngarkim të përdoruesve të energjisë elektrike, qoftë e llogaritur me matje, afrofe apo si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme si dëm ekonomik, apo për gabime teknike, është nëpërmjet faturës së energjisë elektrike të cilësuar nga ligji nr. 8662/2000 si titull ekzekutiv. Përderisa ky është ligji, që në mënyrë universale e të pandryshueshme rregullon mënyrën e kërkimit të detyrimeve, që rëndojnë mbi konsumatorët e energjisë elektrike pavarësisht nëse ata e kanë konsumuar energjinë në mënyrë të ligjshme apo jo, Kolegji vlerëson se përjashtohen mënyra të tjera të kërkimit të këtyre detyrimeve nëpërmjet rregullave të përgjithshme të ngritjes së padive sipas dispozitave të KC-së.

70. Mjeti procedurale për realizimin e mbrojtjen e një të drejte subjektive si rregull është padia ose përjashtimisht kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, kur ligji i ka dhënë një akti fuqinë e titullit ekzekutiv, akt ky që mundëson ekzekutimin e një të drejte subjektive pa qenë e nevojshme që ekzistenca e saj në ngarkim të subjektit debitor të vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Parimi kushtetues bazë i mënyrës së rregullimit të një marrëdhënie është se rregulli i posaçëm ka prioritet në raport me rregullin e përgjithshëm, parim ky që vjen nga e drejta romake se *lex specialis derogate generalis*. Nëse ligjet e veçanta nuk përmbajnë parashikime të posaçme, gjejnë zbatim parashikimet e përgjithshme të ligjit.⁴

70.1 Në rastin konkret legjislatori ka zgjedhur në mënyrë të qëndrueshme ndër vite dhe së fundmi me ligjin nr. 9072/2003 e atë nr. 43/2015 e aktet nënligjore përkatëse të rregullojnë mënyrën e përlllogaritjes e të vjeljes së detyrimeve, që rrjedhin nga konsumi i energjisë elektrike ndaj përdoruesve të energjisë nëpërmjet lëshimit të faturave të konsumit të energjisë elektrike. Fakti që këto ligje janë miratuar me një shumicë të thjeshtë nuk i bën ato më pak të zbatueshme në krahasim me rregullat e përgjithshme të parashikuara në KC e në KPC. Asnjë prej këtyre kodeve në mënyrë të posaçme nuk vendos rregulla për mënyrën e vjeljes së dëmeve nga marrja e padrejtë e energjisë elektrike dhe për rrjedhojë mënyra se si do të rregullohet kërkimi i vlerës korresponduese të tij është ajo e parashikuara nga ligji i posaçëm nëpërmjet faturimit.

71. Pra, në interpretim të këtyre dispozitave të posaçme dhe parimit *lex specialis derogate generalis* del se rregulli bazë është se dispozita e posaçme është direkt e zbatueshme, ndërsa rregullat e përgjithshme procedurale mund të zbatohen në çështjet me natyrë të posaçme përjashtimisht vetëm nëse dispozitat e posaçme referojnë te dispozitat e përgjithshme ose kur dispozitat e posaçme nuk parashikojnë zgjidhje për situatën juridike dhe rregulli i përgjithshëm gjendet i përshtatshëm për aplikim. Në kushtet, kur të dy ligjet e posaçme për sektorin e energjisë elektrike të sipërcituara parashikojnë rregulla për mënyrën e llogaritjes e të faturimit të dëmeve të shkaktuara nga ndërhyrja e paligjshme duke referuar te metodologjia e ERE-s, atëherë ky lloj dëmi nuk përcaktohet nga gjykata me vendim gjyqësor, por sipas procedurave të parashikuara në ligjin e posaçëm e aktet nënligjore të deleguara nga ligji.

72. Një gjë e tillë është e kuptueshme nga interpretimi i secilit prej ligjeve të sipërcituara. Kështu në ligjin nr. 43/2015 mënyra e përmbushjes së detyrimeve ndaj konsumatorëve është ajo nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për faturat dhe në asnjë dispozitë nuk parashikohet kërkimi i shpërblimit të dëmit. Ndërsa në ligjin nr. 9072/2003 konkretisht në nenin 51/14 është parashikuar përlllogaritja e dëmit sipas dispozitave të KC-së vetëm në pikën 10 të kësaj dispozite, dispozitë që bën fjalë për rastet *kur konsumatori dyshon në saktësinë e një matësi, ose kur ka vënë re pasaktësi në matës. Në përputhje me këtë pikë janë parashikuar mënyrat se si procedohet, konkretisht bën kërkesë me shkrim te DPM-ja dhe/ose çdo*

⁴ Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 16.2.2015.

organ tjetër për mbrojtjen e konsumatorit. DPM-ja është përgjegjëse për verifikimin e saktësisë së aparatit matës të energjisë elektrike, i cili kontrollohet nga DPM-ja ose një subjekt/organ i autorizuar, me kushtin që ky i fundit nuk është përfshirë më parë në verifikimin e saktësisë së këtij matësi. Kur pas kontrollit vërehen pasaktësi në matës, shpenzime për riparimin apo zëvendësimin e tij, si dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar për këtë shkak janë në ngarkim të subjektit që ka shkaktuar dëmin. Shpërblimi i këtij dëmi bëhet sipas Kodit të Matjes dhe dispozitave të KC-së. Ndërkohë, që për llogaritjen e dëmit ekonomik të shkaktuar kompanisë si rezultat ndërhyrjeve të paligjshme po e njëjta dispozitë në pikën 14 parashikon se llogaritja bëhet sipas metodologjisë së ERE-s. Pra, ligjvënësi e ka rregulluar në mënyra të ndryshme të drejtën e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmin në varësi të faktit se kush është subjekti i dëmtuar mbajtës i së drejtës. Kështu, në rastin kur i dëmtuari është konsumatori atij i njihet e drejta të kërkojë shpërblimet e dëmeve dhe mënyra se si bëhet shpërblimi i dëmeve është sipas Kodit të Matjes dhe KC-së, gjë që tregon se ky shpërblim kërkohej sipas rregullave të përgjithshme në gjykatë nëpërmjet ngritjes së padisë sipas neneve 608 e vijues të KC-së. Ndërsa kur i dëmtuari është shoqëria furnizuese për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme atëherë dispozita nuk referon te Kodi Civil dhe as përmend institutin e shpërblimit të dëmit, si forma klasike e rivendosjes së të drejtës së cenuar nëpërmjet padisë. Përkundrazi ligji ka zgjedhur të parashikojë shprehimisht mënyrën si bëhet llogaritja kur e dëmtuar është kompania shpërndarëse, gjë që do të thotë se në këtë rast nuk ka procedurë gjyqësore për realizimin e së drejtës së shpërblimit të dëmit. Kjo mënyrë formulimi e ligjit e iniciuar me togfjalëshin “llogaritja e dëmit” nënkupton se ky i fundit llogaritet nga vetë kompania në të njëjtën mënyrë sikurse ajo realizon vjeljen e detyrimit të matur, pra me faturën e energjisë, por me veçantinë që llogaritja të bëhet sipas rregullave të vendosura nga ERE.

73. Ligjvënësi i ka dhënë faturës tatimore të energjisë elektrike cilësinë e titullit ekzekutiv. Në interpretim sistematik dhe literal të nenit 1 të ligjit nr. 8662., datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht: “Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbartimit me ekzekutimin e saj.”, vihet re që ligjvënësi nuk ka pasur qëllim të bëjë një ndarje specifike të vlerës në të holla që përkthehet si detyrim i konsumimit mujor të energjisë elektrike të faturuar rregullisht, dhe vlerës në të holla që përkthehet si detyrim që vjen për shkak të ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjetin e shpërndarjes, që sjellin dëme ekonomike ose asaj të njohur si vlerë në të holla e faturimit afrofe për shkak të mungesës së matësit etj.

74. Ky ligj i posaçëm i ka dhënë faturës së konsumit të energjisë elektrike vlerën e titullit ekzekutiv, e cila në zbatim të nenit 510/e të KPC-së i jep mundësi kreditorit të realizojë të drejtën e tij të kredisë nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit në gjykatë, duke shmangur proces gjyqësor në realizimin e së drejtës së pretenduar prej tij. Titulli ekzekutiv, si koncept juridik është krijuar për të treguar ekzistencën e një të drejte subjektive materiale të cenuar ose të papërmbytur. Për këtë arsye titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimitet që buron nga fakti që, ai që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën përfshirë në të¹. Të gjitha ato akte për të cilat ligji parashikon shprehimisht se përmbajtja e tyre vihet në zbatim nëpërmjet forcës shtrënguese të ligjit përbëjnë titull ekzekutiv. Sipas doktrinės dhe praktikës gjyqësore, *titulli ekzekutiv është përkufizuar si akti zyrtar përfundimtar, që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar dhe të pakushtëzuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit.* Ekzekutimi i detyrueshëm i posaçëm është ai që nuk realizohet në bazë të një vendimi gjyqësor, por në bazë të një akti tjetër të sanksionuar nga ligji si titull ekzekutiv⁵.

⁵ E Drejta Procedurale Shqiptare, Vahid Lama, pjesa I, dispensa II, Tiranë, 1974.

75. Ligjit nr. 8662/2000 i mungon përcaktimi i elementëve përbërës të faturës së energjisë elektrike, si dhe momenti se kur fatura bëhet titull ekzekutiv⁶. Lidhur me këtë të fundit kupton se ajo gëzon një cilësinë të tillë *ipso lege*, por në aspektin ekzekutiv ajo e fiton një cilësi të tillë pasi ka përfunduar periudha e ekzekutimit vullnetar të saj sipas afateve të vendosura me aktet nënligjore të ERE-s. Ndërkohë lidhur me elementët përbërës të faturës rezultojnë se ato nuk përcaktohen as nga ligji nr. 9072/2003, as nga ai nr. 43/2015 dhe as nga neni 36 i ligjit nr. 7928/1995, që referohet si model i faturës. Ligji nr. 7928/1995 rregullon procedurat e faturimit dhe të vjeljes së detyrimit tatimor të TVSH-së dhe referenca e modelit të faturës së konsumimit të energjisë elektrike të ky ligj është bërë pikërisht për efekt të pasqyrimin e vjeljes së këtij detyrimi tatimor dhe jo për të evidentuar elementët e llojit të konsumit që përmban fatura e cilësuar si titull ekzekutiv.

76. Kështu, neni 36 i ligjit nr. 7928/1995 parashikon; *Për qëllimet e këtij ligji fatura përpilohet në formën e caktuar nga ministri i Financave dhe përmban: a) emrin, adresën. NIPT-in dhe kodin fiskal të personit që bën furnizimin; b) emrin, adresën dhe NIPT-in, së bashku me kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm për TVSH-në, emrin, adresën dhe kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm i biznesit të vogël dhe vetëm emrin e adresën për blerësit persona të tjerë; b/1) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit; c) datën në të cilën lëshohet fatura; d) numrin e serisë së vendosur nga shtypshkronja që e ka shtypur; e) numrin rendor; f) **përsëkrimin e çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; g) sasinë e mallrave apo madhësinë e shërbimeve të furnizuara; h) çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; i) shumën e pagueshme pa TVSH-në; j) përqindjen e TVSH-së së pagueshme ndaj çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar; k) shumën e TVSH-së së pagueshme; l) shumën e pagueshme me TVSH; m) çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga ministri i Financave.** Pra, duke iu referuar këtyre elementëve konstatohet se ligji ka vendosur rregulla të përgjithshme, që duhet të përmbajnë faturat tatimore me qëllim pasqyrimin e TVSH së pagueshme për çdo lloj sasi malli të furnizuar sipas çmimit të tij. E rëndësishme është që fatura të evidentojë sasinë e mallit të furnizuar e çmimin e tij.*

76.1 Në rastin e energjisë së konsumuar nga përdoruesit si rezultat e ndërhyrjes së paligjshme, metodologjia e ERE-s ka njohur për çdo rast sasinë e mallit “energji të prezumuar” si të konsumuar nga përdoruesi e për rrjedhojë vlerën korresponduese të tij mbi të cilën bëhet edhe llogaritja e TVSH sipas ligjit nr. 7928/1995. Pra rezulton se fatura e lëshuar për llogaritjen e dëmit ekonomik gëzon elementët e kërkuar nga ky ligj sikurse edhe fatura e energjisë e lëshuar nga leximi i matësit ose aforfe ose për shkak të gabimeve teknike të matësit dhe për rrjedhojë ajo plotëson kriteret e nenit 36 të ligjit nr. 7928/1995.

77. Aktualisht me ligjin nr. 48/2014 është parashikuar cilësia e titullit ekzekutiv edhe për faturat e tjera të lëshuara për marrëdhënien juridike midis tregtare, pavarësisht nga lloji i furnizimit të mallrave ose të shërbimeve. Neni 16 i këtij ligji parashikon se; *Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbarnesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lërvuar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.* Në përputhje me këtë përcaktim rezulton se ligjvënësi ka zgjeruar llojshmërinë e marrëdhënieve juridike për të cilën e njëj faturën e furnizimit të mallrave ose të shërbimeve si titull ekzekutiv, pa evidentuar në mënyrë të posaçme ndonjë element përbërës të faturës ose model të saj. Nisur nga kjo tendencë legjislative për të shmangur procedurat gjyqësore të formësimit të titujve ekzekutiv me vendime gjyqësore dhe nxitur vjeljen e shpejtë të detyrimeve në rastin e marrëdhënieve të tjera tregtare, kolegji thekson se referimi i ligjit nr. 8662/2000 te modeli i faturës sipas nenit 36 të ligjit nr. 7928/1995 nuk ka për qëllim të kufizojë llojin e faturimeve të energjisë që gëzojnë cilësinë e titullit ekzekutiv, por të rregullojë mënyrën e faturimeve, që për çdo rast të kuptohet detyrimi i pagueshëm nga abonenti dhe të vilet tatimi mbi vlerën e shtuar.

⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52 datë, më 5.12.2012.

78. Elementet e faturës së energjisë elektrike në mënyrë më specifike janë të parashikuara nga vendime të ERE-s, por në asnjë rast ato nuk kushtëzojnë cilësinë ose jo të faturës së konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, përderisa ligji nr. 8662/2000 ose neni 36 i ligjit nr. 7928/1995 nuk i konsideron ato pjesë të qenësishme të ekzistencës së titullit ekzekutiv në këtë fushë. Modeli i faturës tip të energjisë elektrike miratohet si rregull me vendime të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, megjithatë ky miratim nuk identifikon në çdo rast faturën, që ka cilësinë e titullit ekzekutiv. Ligji nr. 8662/2000 ka zgjedhur të konsiderojë titull çdo faturë të konsumit të energjisë elektrike, që plotëson kriteret e përgjithshme të faturave për furnizimet e tatueshme me TVSH-në të kërkuara në nenin 36 të ligjit nr. 7928/1995 pa u marrë në detaje me përmbajtjen e faturës për shkak të veçantisë së marrëdhënies juridike të furnizimit me energji elektrike.

79. Duke mbajtur në konsideratë shkakun e mënyrat e faturimit të energjisë, aktualisht në faturën tip të energjisë elektrike përfshihet si formë faturimi; matje e energjisë nga leximi, përlllogaritja e saj në rast të gabimeve të matësit, faturimi i saj në rastet e mungesës së matësit duke u vendosur në zërin e energjisë pa matje ose atë jashtë kushteve teknike, ose në energjinë e llogaritur si pasojë e dëmit ekonomik nga ndërhyrja në rrjet e cila faturohet ose në zërin dëm ekonomik ose në atë energji e pamatur ose në atë matje jashtë kushteve teknike. Zëri ose rubrika, ku është pasqyruar në faturë përlllogaritja e dëmit ekonomik nuk përcakton dhe as afekton vlefshmërinë e faturimit dhe as cilësinë e faturës si titull ekzekutiv për këtë pjesë. I rëndësishëm në këtë rast është pasqyrimi i saktë i përlllogaritjes së energjisë së faturuar si pasojë e dëmit ekonomik pavarësisht emërimit formal të zërit specifik të faturës, ku ajo është përfshirë. Në të gjitha këto raste fatura e gëzon cilësinë e titullit ekzekutiv nisur nga shkakun që ka sjellë përfshirjen e llogaritjes të institutit të dëmit ekonomik në faturë dhe gjykata duhet të analizojë vlefshmërinë e faturës duke shqyrtuar në themel ekzistencën apo jo të kushteve të përlllogaritjes së dëmit ekonomik dhe për rrjedhojë të shprehet për vlefshmërinë apo jo të faturës sipas nenit 609 të KPC-së.

80. Nëse ligjbërësi, do të synonte të bënte një veçim në trajtim për sa i përket terminologjisë së zërit (rubrikës) të veçantë të faturës së energjisë, natyrës së këtij detyrimi dhe mjetit procedural me të cilin do të kërkohet disponimi i tij nga gjykata, atëherë këtë ndryshim do e materializonte në një parashikim ligjor/nënligjor, të pjesës së faturës së energjisë elektrike që do të konsiderohet titull ekzekutiv ose së paku në zëra të veçantë të faturës së energjisë elektrike. Në interpretim *ad contrario*, në kushtet kur fatura e energjisë elektrike, referuar dispozitës së mësipërme të ligjit nr. 8662/2000 është titull ekzekutiv, në të gjithë tërësinë e saj pa u ndarë në bazë të zërave, atëherë të gjithë zërat (rubrikat) e përfshirë në faturën e energjisë elektrike, për efekt të ligjit, do të kenë të njëjtin vlerë ligjore në ekzekutueshmërinë e tyre si titull ekzekutiv. Nga ana tjetër, në kushtet kur referuar legjislacionit të mësipërm, i atribuohet OSHEE sh.a. e drejta të llogarisë dëmin dhe mënyra e vetme e kërkimit të tij, është nëpërmjet faturës së energjisë elektrike, kjo nënkupton se edhe detyrimi që buron nga ndërhyrja e paautorizuar në rrjetin e shpërndarjes është pjesë përbërëse e faturës së energjisë elektrike, e cila do të bëhet e kërkueshme dhe e ekzekutueshme në të gjithë elementet e saj përbërës, në të njëjtën mënyrë.

81. Fatura e konsumit të energjisë elektrike, e cilësuar si titull ekzekutiv nuk përfshin vetëm faturën e lëshuar sipas regjistrimit të matësit, por çdo lloj fature konsumi pavarësisht se ky konsum energjie është kryer në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme nga abonenti. Interpretimi se fatura e konsumi të energjisë përbën vetëm atë të lëshuar sipas leximit të matësit do të linte jashtë cilësimit si titull ekzekutiv përveç faturimit të energjisë së konsumuar si dëm ekonomik edhe faturimet aforfe apo ato të energjisë së pamatur për shkak të gabimeve të matësit, për të cilat në asnjë rast nuk është diskutuar fuqia e tyre si titull ekzekutiv. Gjukata duhet të interpretojë ligjin për të garantuar zbatimin njësoj të tij për të gjitha llojet e faturimeve të energjisë elektrike, jo të krijojë diferenca në kundërshtim me qëllimin e ligjit, madje edhe me vetë përmbajtjen e tij tekstuale.

82. Fatura e konsumit ka të bëjë me faturimin e energjisë së harxhuar nga abonenti, pavarësisht se është konsum i matur apo i prezumuar dhe i përlogaritur sipas vendimeve përkatëse të ERE-s. Për aq kohë sa abonenti ka konsumuar energji elektrike, me ose pa matës, shoqëria furnizuese ka të drejtë të faturojë këtë energji sipas kuadrit ligjor e nënligjor, që rregullon specifikisht mënyrën e faturimit. Në rast se ligjvënësi do kishte si qëllim të konsideronte titull ekzekutiv vetëm faturën e energjisë elektrike të lëshuar me matje të energjisë nga matësi do e kishte parashikuar shprehimisht një gjë të tillë, ndërkohë që ka zgjedhur të cilësojë titull ekzekutiv faturën e konsumit, që ka të bëjë me gjendjen e faktit të përfitimit ose të konsumimit të energjisë elektrike nga përdoruesi, ku përfshihen edhe faturimet aforfe, me energji të pamatur si rrjedhojë e gabimeve të matësit, ato për dëmin ekonomik (të cilat mund të shënohet edhe si energji e pamatur ose jashtë kushteve teknike) që janë rezultat i vlerave të prezumuara të konsumit të përcaktuara me vendim të ERE-s në bazë të ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar ose të atij nr. 43/2015 aktualisht.

83. Për referencë, në jurisprudencën gjyqësore italiane, është njohur ndër vite fakti, se detyrimi i dëmit ekonomik është pjesë përbërëse e faturës së energjisë elektrike, dhe gëzojnë të njëjtin rregullim ligjor për kërkimin e tyre në gjykatë, dhe ekzekutueshmërinë e tyre të menjëhershme. Pavarësisht se në legjislacionin italian nuk rezulton që fatura e energjisë elektrike të ketë cilësinë e titullit ekzekutiv sikurse e ka në legjislacionin tonë, legjislacioni italian e konsideron dëmin ekonomik pjesë së faturës së energjisë elektrike dhe kërkon përmbushjen e menjëhershme të detyrimeve që rrjedhin nga këto fatura për shkak të rëndësisë së shërbimit ku ato aplikohen dhe natyrës së shërbimit publik që ka kontrata e furnizimit me energji elektrike. Jurisprudenca italiane ka theksuar fuqinë provuese të detyrimit të përmbajtur në faturën e energjisë elektrike duke e transferuar barrën e provës te përdoruesi.

83.1 Për këto çështje, Gjykata italiane, me një vendim të fundit (Cass. 21.5.2019, nr. 13605), ka ndërhyrë duke iu referuar një rasti në të cilin faturat në lidhje me furnizimin me energji elektrike ishin lëshuar në bazë të të një përlogaritje (kontabiliteti) të konsumit të kryer nga distributori, “Enel Distribuzione S.p.A.”, me supozimin e mosbesueshmërisë së të dhënave të regjistruara nga matësi, për shkak të pretendimit të ndërhyrjes në të. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e cila u përqendrua edhe në shpërndarjen e diskutueshme të barrës së provës në lidhje me vlefshmërinë e shumave të ngarkuara në faturë, Gjykata e Lartë vendosi disa parime, dhe kontestoi efektivitetin e konsumit të ngarkuar, duke hipotezuar kështu ose një mosfunksionim të matësit ose aktivitete të paligjshme të palëve të treta në lidhje me konsumin e energjisë.

83.2 Për këtë hipotezë, Gjykata e Lartë ka vendosur kritere të dallueshme për ndarjen e barrës së provës sipas disa rasteve, duke arsyetuar si më poshtë: “*Matësi, si instrument për matjen e konsumit, është pranuar me konsensus nga palët kontraktuese si mekanizëm kontabël, përballë pretendimit të një krediti është përdoruesi ai që duhet të tregojë se mospërmbushja nuk i atribuohet atij, sipas nenit 1218 të Kodit Civil. ... Megjithatë, duke marrë parasysh se keqfunksionimet e instrumentit varen kryesisht nga defekte të fshehura dhe që në çdo rast përfshijnë kontrole teknike që nuk mund të kryhen nga debitori për paafësitë e tij të nevojshme teknike, duke zbatuar parimin e afërsisë së provës, duhet të mbahet në konsideratë disa disiplina të shpërndarjes së barrës së provës... Në fakt, duke qenë e përfshirë në një mosmarrëveshje në të cilën kundërshtohet efektiviteti i mbikonsumit që qëndron në bazë të tarifave të rritura kontraktuale (pa pasur asnjë dyshim për ndonjë ndërhyrje të mundshme të matësit), përdoruesi, për kundërshtimin në fjalë, duhet të kishte: a) së pari të bashkëngjiste, duke kërkuar verifikimin, mosfunksionimin e instrumentit (matësit); b) të tregojë se çfarë konsumi energjie kishte bërë në periudhën (duke pasur parasysh të dhënat statistikore të konsumit të regjistruara normalisht në faturat e mëparshme dhe që korrespondojnë me përdorime të caktuara të energjisë që rrjedhin nga aktivitetet specifike të biznesit të kryera, ku është demonstruar ngjashmëria edhe në periudhën e kundërshtuar); c) në alternative, të tregojë jo vetëm se mbikonsumimi i atribuohet palëve të treta (duke provuar për shembull mungesën e zgjatur të dikuajt nga vendi ku ndodhet shërbimi) dhe se ka ndodhur kundër vullnetit të pronarit, por edhe se përdorimi abuziv i energjisë nga palët e treta nuk ka ndodhur nga sjellja e pakujdesshme, që i*

atribuohet përdoruesit, në miratimin e masave të përshtatshme të kontrollit që synojnë parandalimin, nëpërmjet përdorimit të kujdesit të përbashkët, sjelljen e paligjshme të palëve të treta. Konsideratat e mësipërme vlenë në vetvete për të hedhur poshtë ankesën, për shkeljen e rregullave të provës supozuese, duke qenë se vlerësimi i pamjaftueshmërisë dëshmuar të faturave në lidhje me muajt që i paraprijnë periudhës në fjalë duhet të konsiderohet i saktë⁷.

84. Gjithashtu jurisprudenca italiane pranon se sipas rindërtimit unanimit të doktrinë si për çdo kontratë tjetër të përdoruesit publik, marrëdhënia e përdoruesit të ujit/energjisë, e cila krijohet ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit, nuk e gjen burimin në një akt të autoritetit, por në kontratën e përdoruesit⁸, e parashikuar në regjimin e shërbimit publik... Marrëdhëniet kontraktore rregullohen në mënyrë uniforme nga rregullorja dhe statuti i shërbimit të integruar të ujit/energjisë, pjesë përbërëse e kontratës, të cilat përgatiten nga drejtuesi, miratuar nga autoriteti kompetent administrativ dhe të pranuar nga përdoruesit, me kushte efektive të përgjithshme të kontratës, në zbatim të nenit. 1341 KCI, dhe për sa i përket kontratës së lidhur me nënshkrimin e formularit të kërkesës për lidhje të ujit/energjisë, në zbatim të nenit. 1342 KC⁹.

84.1 Sipas kushteve të përgjithshme të zbatueshme për marrëdhënien në fjalë, përcaktimi i tarifës, që i nënshtrohet sistemit tarifor dhe normalisht presupozon matjen e konsumit, bëhet i mundur edhe në rast mosfunksionimi të matësit, (në zbatim të nenit. B.35), i cili përshkruan rindërtimin e konsumit mbi bazën e atij të regjistruar në vitet e mëparshme në periudha dhe kushte të ngjashme ose, në mungesë të të dhënave historike, mbi bazën e vlerave mesatare statistikore të marra sipas llojit të përdoruesit. Gjatë verifikimit të konsumit, i cili shërben si bazë për llogaritjen, është e nevojshme të përcaktohet shkaku i tepricës së dyshuar, nëse varet nga një defekt në matës, ose nga një gabim leximi ose transkriptimi (në analogji me rastin e parashikuar), ose në një humbje të fshehur në sistemin e ujit/energjisë, në anën e brendshme, me përjashtim, pra, mosfunksionimin e pajisjes matëse, dhe për rrjedhojë nëse shkaku i sasisë së lartë të konsumit në mosmarrëveshje i atribuohet menaxhuesit ose përdoruesit. ... Përdoruesi, nëse ankesa e tij për konsum jonormal është e bazuar, e shënuar siç duhet në regjistrat kontabël të mbajtur në mënyrë të njëanshme nga ofruesi, në një periudhë të caktuar kohore, nuk lirohet nga detyrimi për të paguar shumën e detyrueshme, por kërkohet të paguajë shumën që mund të përcaktohet sipas kriterëve të supozuara, që synojnë konstatimin e konsumit të supozuar, me fjalë të tjera, ajo që ndryshon është vetëm mënyra e përcaktimit të tarifës për furnizimin, dhe jo detyrimi për ta paguar atë¹⁰, sipas afateve të rëna dakord.

84.2 Për qëllime të zgjidhjes së mosmarrëveshjes që ka lindur ndërmjet menaxhuesit, i cili kërkon pagesën e tarifës (vlerë e përcaktuar e energjisë për shkak të mosfunksionimit të matësit) dhe përdoruesit, i cili ankohet për tarifën për konsum anormal që tejkalon nevojat e tij normale, duhet të zbatohet kriteri për ndarjen e barrës së provës që vendos barrën mbi menaxhuesin për të demonstruar funksionimin e rregullt të matësit dhe korrespondencën midis matjes së lexuar dhe asaj të transkriptuar në faturë¹¹. ... Sipas asaj që është afirmuar së fundi, në rast mosmarrëveshjeje, barra e të provuarit se matësi është plotësisht funksional i bie furnizuesit, ndërkohë që përdoruesi duhet të demonstrtojë se konsumi i tepërt është për shkak të faktorëve jashtë kontrollit të tij, të cilët ai do të nuk mund të ishte shmangur me mbikëqyrje të kujdesshme të sistemit, gjithashtu duke siguruar, me kujdes, shmangien e çdo ndërhyrjeje të palëve të treta, të aftë për të ndryshuar funksionimin normal të matësit ose për të shkaktuar një rritje të konsumit¹².

85. Si referencë, në legjislacionin italian parashikohet gjithashtu se fatura e energjisë elektrike paguhet me të gjithë humbjet e rrjetit, pasi është parashikim kontraktual. Humbjet e rrjetit¹³ janë të

⁷ Cassazione civile sez. VI, 9.1.2020, (ud. 3.10.2019, dep. 9.1.2020), n. 297.

⁸ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese italiane nr. 335 e vitit 2008.

⁹ Shih vendimin e Gjykatës së Lartë italiane nr. 19154, 2018.

¹⁰ Sipas nenit. 1562, paragrafi 2, i Kodit Civil (italian)

¹¹ Shih vendimin e Gjykatës së Lartë Italiane nr. 13193 i 2011, i cili deklaron, për analogji, zbatueshmërinë e parimeve në lidhje me kontratën e përdoruesit të telefonit, të shprehur tashmë nga Gjykata e Lartë italiane nr. 1236 i 2004 2003; nr. 17041 i 2002-shit.

¹² Shih vendimin e Gjykatës së Lartë Italiane nr. 23699 e 2016

¹³ Shpjegim. Humbjet e rrjetit janë humbje të energjisë elektrike që ndodhin gjatë procesit të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo do të thotë se, që nga momenti kur energjia prodhohet në termocentrale deri në mbërritjen e saj në shtëpi dhe biznese, një pjesë e saj nuk arrin në destinacionin e saj përfundimtar. Kjo sasi e rrymës “e humbur” përgjatë

integruara në faturën e energjisë elektrike dhe nuk kërkojnë pagesë të veçantë. Kostoja përfshihet automatikisht në llogaritjen e konsumit total të energjisë. Klientët thjesht të paguajnë faturën e tyre siç bëjnë zakonisht. Humbjet në rrjet janë një zë i faturave të energjisë elektrike që kanë të bëjnë me prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë dhe bien mbi konsumatorin fundor.

86. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër konstatohet se edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese shqiptare furnizimi me energji dhe me ujë të pijshëm janë konsideruar shërbime me interes të përgjithshëm, gjë që përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private, për të mbrojtur interesat e përgjithshme¹⁴. Mbi këtë bazë Gjykata Kushtetuese e ka identifikuar si interes publik parashikimin në ligjin për atribuimin e faturës së energjisë elektrike si titull ekzekutiv me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të këtij shërbimi, si shërbim tepër jetik për të gjithë konsumatorët dhe shoqërinë në tërësi. Të njëjtin qëndrim Gjykata Kushtetuese e ka rikonfirmuar dhe në vendimin nr. 7, datë 16.2.2015 me objekt konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, të ndryshuar.

87. Referuar parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, ligjvënësi ka zgjedhur të normojë me akte ligjore dhe nënligjore fushën e furnizimit me energji elektrike mënyrën e faturimit të energjisë si atë të matur, aforfe, me gabime në matje ose dëmin ekonomik nga shoqëria furnizuese. Të gjitha këto akte ligjore dhe nënligjore konsiderohen të detyrueshme për zbatim dhe plotësojnë të drejtat e detyrimit kontraktore të palëve, të cilat gjithashtu rezultojnë të jenë të përfshira në kontrata tip që përcaktojnë të njëjtat rregulla për të gjithë abonentët e një lloji kategorie. Aktet ligjore e nënligjore në fushën e faturimit të energjisë elektrike udhëhiqen nga i njëjti parim i sigurimit të efikasitetit në vjeljen e shpejtë të detyrimit, që përkon me energjinë e konsumuar nga përdoruesi, qoftë ky detyrim i përcaktuar me lexim matësi apo i përcaktuar mbi bazën e një sistemi tarifar ose modeli tip llogaritje që prezumon matjen e konsumit, në kushtet kur kjo matje është e pamundur të bëhet për shkak të mosfunksionit të matësit ose të ndërhyrjes së paligjshme në të ose në rrjetin e shpërndarjes.

88. Referimi i ligjeve nr. 9072/2003 dhe atij nr. 43/2015 për llogaritjen e dëmit ekonomik i shkaktuar shoqërisë furnizuese nga ndërhyrjet e paligjshme në matës sipas metodologjisë së ERE-s dhe përcaktimi nga ky ent publik rregullator i vlerave fikse të energjisë dëm ekonomik, që i korrespondon energjisë së konsumuar nga një konsumator tipik i kategorisë, ku bën pjesë subjekti që ka bërë ndërhyrjes provon se dëmi ekonomik i përfshirë në faturën e energjisë elektrike nuk përbën sanksion dhe as ka natyrën e shpërblimit të dëmit sipas të gjithë elementëve të tij të parashikuar nga KC. Ai presupozon një energji të konsumuar, matja e së cilës është bërë mbi kriteret tabelare të cilat ligjërisht bëjnë të përcaktueshme energjinë e konsumuar, kur matja e saj nuk është e mundur të kryhet sipas leximit të matësit. Ky rregull ndiqet jo vetëm në rastin e dëmit ekonomik por edhe për rastet e faturimeve afrofe kur matësi është jashtë shërbimit ose mungon. Përderisa njihet e pranohet faturimi afrofe si një lloj energjie e konsumuar e prezumuar dhe si e tillë titull ekzekutiv, atëherë të njëjtën vlerë ka dhe faturimi i kryer për dëmin ekonomik për të cilin zbatohet i njëjti parim faturimi për energji të konsumuar të prezumuar, sipas kriterëve tabelare ligjore.

89. Vendosja e tabelave fikse të llogaritjes së dëmit ekonomik nga ERE përbën një konsum energjie të njohur për secilën kategori abonentësh në rast se vërtetohen rastet e ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin e shpërndarjes. Si të tilla këto vlera janë automatikisht të aplikueshme në rastet e dëmeve ekonomik nga entiteti, që i është njohur një e drejtë e tillë si shoqëria furnizuese ose shpërndarëse dhe nuk mund të jetë objekt aplikimi nga gjykata në rastet e shpërblimit të dëmit. Gjykata në kuadër të padive të shpërblimit të dëmit sipas neneve 608 e vijues të KC-së përcakton vlerën reale të dëmit duke marrë për bazë veçoritë e çdo rasti konkret. Masa e shpërblimit të dëmit në gjykatë nuk mund të

rrugës brenda rrjetit të shpërndarjes së energjisë përbën atë që klasifikohet si humbje në rrjet.

¹⁴ Vendimi nr. 52, datë 5.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

kufizohet mbi vlera fikse. Për rrjedhojë, përcaktimi i këtyre vlerave sipas vendimeve përkatëse të ERE-s duket se ka të bëjë me plotësimin e kuadrit ligjor e nënligjor rregullator për matjen e faturimit e energjisë së konsumuar nga shoqëria furnizuese ose OSSH-ja në kushtet e mungesës së matësit, të marrjes së energjisë pa kontratë, ndërhyrjes në rrjetin e shpërndarjes ose në matës në mënyrë të paautorizuar.

90. Në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme që krijojnë përfitime të padrejta të energjisë për përdoruesit e energjisë, këta të fundit mbartin detyrimin e pagesës së saj sipas rregullave ligjore. Pikërisht për këtë shkak ligji nr. 8662/2000 i njohur faturës së energjisë elektrike cilësinë e titullit ekzekutiv. Titujt ekzekutivë parashikohen në mënyrë të listuar në nenin 510 të KPC-së, i cili ndër të tjera parashikon se: janë tituj ekzekutivë:... e) *aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quben tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.*

91. Nisur nga rëndësia jetike që ka furnizimi me energji elektrike për shoqërinë dhe natyra e shërbimit me interes të përgjithshëm që karakterizon këtë fushë të marrëdhënies juridike private, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 52/2012 ka cilësuar në përputhje me Kushtetutën parashikimin si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike duke arsyetuar se: *“Gjithashtu, Gjykata vëren se metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi nëpërmjet cilësimit si titull ekzekutiv të akteve të ndryshme, nuk është zbatuar vetëm në sektorin e energjisë elektrike, por ndeshet dhe në fusha të tjera... ligjvënësi këtë formë të atribuimit si titull ekzekutiv të një akti e ka konceptuar si të domosdoshme dhe efektive, në disa sektorë me problematika sociale, ekonomike apo dhe fushat me interes të përgjithshëm, të cilat e justifikojnë deri në një farë mase ndërhyrjen nga ana e tij. Në rast se procedura e mbledhjes së të ardhurave nga konsumi i energjisë elektrike nuk do të ishte efektive, sistemi energjetik do të kishte pasoja negative jo vetëm mbi konsumatorët debitorë, por edhe konsumatorë të tjerë tepër të rëndësishëm, si spitalet, shkollat, burgjet, etj.*

92. Në respektim të interesit të përgjithshëm publik dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergetik, ligjvënësi ka parashikuar që faturat e energjisë elektrike të kenë fuqinë e titullit ekzekutiv në tërësinë e tyre si për pjesën e energjisë së konsumuar edhe për atë dëm ekonomik ose energji e pamatur. Ky lloj parashikimi i shërben parandalimit të shkeljeve të ligjit dhe siguron përmbushjen e detyrimit financiar të konsumatorëve për energjinë elektrike në një mënyrë të efektshme dhe të drejtë.

93. Teorikisht titulli ekzekutiv është akti që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar dhe përfundimtar të një personi kundrejt një tjetri sipas parashikimeve ligjore. Ekzistenca e titullit ekzekutiv është *conditio sine qua non* (kusht i domosdoshëm), pa të cilin nuk mund të iniciohet faza e ekzekutimit në mënyrë të detyrueshme të së drejtës materiale të kreditorit, së cilës i korrespondon një detyrim të debitorit. Nisur nga specifikat e kësaj marrëdhënie juridike procedurale që krijohet, ligjvënësi i ka dhënë mbrojtje shtetërore juridiksionale vetëm një grupi të caktuar aktesh, duke i njohur pasoja ligjore ekzekutive. Një ndër to përfshihen edhe *“akte të tjera që sipas ligjeve të veçanta quben tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.”*, shkronja “e” e nenit 510 të KPC-së. Ky nen përcakton si kriter për identifikimin si titull ekzekutiv të aktit, parashikimin në mënyrë eksplicite nga ligjvënësi i këtij akti si titull ekzekutiv.

94. Në rastin objekt gjykimi, ndodhemi para një titulli ekzekutiv që nuk është një vendim gjyqësor i formës së prerë, pra jemi përpara rastit kur titulli ekzekutiv është një akt jashtëgjyqësor. Siç është arsyetuar më sipër, fatura tatimore e konsumit të Energjisë Elektrike, është përcaktuar si titull ekzekutiv përmes parashikimesh ligjore të posaçme.

95. Titulli ekzekutiv, si koncept juridik është krijuar për të treguar ekzistencën e një të drejte subjektive materiale, të cenuar ose të papërmbushur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimiteti i cili buron nga fakti se subjekti që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të. Në interpretimin *“ad contrario”*

ekzistenca e një titulli ekzekutiv për të cilin ka arsye për ta goditur me pavlefshmëri sipas njërës nga situatat alternative që rendit neni 609 i KPC-së është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit aktiv (*locus standi*) të “debitorit”, të identifikuar qoftë edhe formalisht nga titulli si i tillë, për të paraqitur padi sipas nenit 609 të K.P.Civile. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv qëndron pikërisht në mospërputhjen ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv me realitetin që ekziston efektivisht. Në përputhje me këtë dispozitë pala ndaj së cilës faturohet dëmi ekonomik ka të drejtë të mbrohet nëpërmjet padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv. Në vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: “Në vazhdimin e argumenteve të mësipërme, Gjykata rithekson se neni 609 i KPC-së i njeht të drejtën debitorit “të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarojë se titulli ekzekutiv është pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas”(vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 16.10.2007). Për rrjedhojë, procedura e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit, bazuar në ligjin për atributimin e faturave të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, nuk është procedurë e pakthyeshme, sepse debitorit i aksesohet e drejta e ngritjes së kërkesë-padisë në gjykatë, bazuar në nenin 609 të KPC-së, duke iu garantuar një proces gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm, njësoj si me çdo padi themeli.”

96. Duke qenë se subjekti mbajtës i së drejtës për vjeljen e energjisë së konsumuar në mënyrë të paligjshme është shoqëria furnizuese sipas ligjit nr. 9072/2003 ose OSSH-ja sipas ligjit nr. 43/2015, atëherë ky subjekt ka barrën e provës të vërtetimit gjatë procesit të iniciuar nga konsumatori sipas nenit 609 të KPC-së ekzistencën e ndërhyrjes në rrjet ose në matës ose marrjen e energjisë pa kontratë dhe kategorinë e subjektit që i përket ky përdorues, ndërkohë që ky i fundit ka barrën e provës të vërtetimit të kundërtën si për sa i përket ekzistencën apo jo të faktit të paligjshëm shkak të faturimit të konsumit të pezumuar dhe jo me matje, ashtu edhe të komponentëve të tjerë që kanë lidhje me ekzistencën e kushteve të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

97. Kushtet e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv janë siguria, përcaktueshmëria dhe kërkueshmëria. Edhe në komponentët e dëmit ekonomik, të shkaktuar nga konsumatori, i cili si institut mund të jetë pasqyruar në faturën e energjisë elektrike qoftë në zërin dëm ekonomik ose energji e pamatur ose matje jashtë kushteve teknike përmbushen të tre këto elemente. Kushti i sigurisë nënkupton që e drejta duhet të rezultojë në ekstremet e saj objektive dhe subjektive nga titulli ekzekutiv. Nga analiza e mësipërme ligjore, u identifikua fakti se dëmi ekonomik, përlllogaritjet nga një institucion i ligjësuar (shoqëria furnizuese ose OSSH) dhe mbi bazën e një metodologjie rigoroze dhe të rregulluar me akt nënligjor, në përputhje me parimin e sigurisë juridike. Kushti i përcaktueshmërisë që është vlerësimi në para (në të holla), i sendit ose i së drejtës objekt ekzekutimi, gjithashtu përmbushet pasi përlllogaritja e dëmit bëhet sipas metodologjisë ligjore e cila e përkthen në vlerë “në para” dëmin e pretenduar, që në fakt përbën një energji të konsumuar të prezumuar përderisa nuk mund të bëhet matje e energjisë si rezultat i përfitimit të saj nga ndërhyrje të paligjshme, të kryera në interes të përdoruesit. Kushti i kërkueshmërisë që ka të bëjë me faktin se kërkimi i ekzekutimit të detyrueshëm mund të kërkohet menjëherë, pa u lidhur me një afat të papërfunduar, apo me një kusht pezullues, gjithashtu përmbushet, pasi përlllogaritja e dëmit të mësipërm ekziston i identifikuar mbi akte nënligjore, dhe është i kërkueshëm në çdo moment. Ky dëm ka një natyrë të veçantë *sui generis* pasi një thelb prezupozon tarifë konsumi të prezumuar të përlllogaritur mbi baza ligjore, të marra nga i njëjti akt metodologjik, i kryer nga i njëjti organ ERE i ngarkuar me ligj, që përjashton mundësinë e çdo interpretimi/përlllogaritje subjektive të kryer nga bindja e brendshme e subjektit mbajtës së të drejtës.

98. Nisur nga sa më lart, në referim të nenit 485, paragrafi i dytë i KPC-së, disponimin njësoj, për çështjen e shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është si në vijim:

Fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shoqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, dhe ajo e lëshuar sipas ligjit nr. 43/2015 “Për

sektorin e energjisë elektrike”, si dhe akteve nënligjore të ERE-s, të dala në zbatim të secilit ligj në këtë fushë, ka cilësinë e titullit ekzekutiv.

IV. Zgjidhja e çështjes objekt shqyrtimi

99. Si u referua në pjesën hyrëse të këtij vendimi, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padinë me objekt: *“Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike me nr. F-138694, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, për sasinë prej 10.000 KWH, në vlerë totale 146,400 lekë e faturuar si energji e pamatur pasi detyrimi nuk ekziston”*, bazuar në nenet 154, 155, 609 të Kodit të Procedurës Civile etj.

100. Sipas rrethanave të faktit të pranuar nga të dyja gjykatat ka rezultuar se në datën 20.10.2011, pala e paditur ka ushtruar kontroll në lokalën e paditësit Haxhi Nezha në fshatin Jeta e Re. Për këtë kontroll është mbajtur procesverbali me numër serie 0066095, i cili nuk ka nënshkrimin e palës paditëse. Sipas këtij procesverbali rezulton se tek abonenti Haxhi Nezha, gjatë kontrollit është konstatuar një linjë e dytë, në momentin, që limitatori ishte i stakuar ekspresi i kafesë në ambient rezultonte me energji elektrike. Në procesverbal është konstatuar se dëmi ekonomik është 20.000 kwh. Mbi bazën e këtij procesverbali të mbajtur në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur, pa prezencën e palës paditëse, shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., në datën 8.11.2011 i ka faturuar si energji të pamatur dëmin ekonomik 10,000 kwh për periudhën 13.10.2011–30.10.2011 në shumën 146.400 lekë, paditësit Haxhi Nezha.

101. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”) vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur në këtë gjykim, nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.), kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “KPC”), të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit.

102. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje, ka rezultuar i provuar fakti se, në rastin konkret jemi para rastit të shqyrtimit të padisë për kundërshtimin e titullit ekzekutiv, fatura të energjisë elektrike, mosmarrëveshje e cila rregullohet sipas përcaktimeve të nenit 609 të KPC-së, si dhe ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar), në fuqi në kohën e lëshimit të faturës objekt gjykimi.

103. Gjatë shqyrtimit të çështjes në të dy shkallët më të ulëta të gjykimit, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke vlerësuar pranimin e padisë me arsyetimin se; *lëshimi i faturës së energjisë elektrike objekt shqyrtimi, është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht ligjin nr. 9072/2003. Me ndryshimet që i janë bërë ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008 është shfuqizuar neni 46/c i cili i jepte kompetencë të paditurit që të vendoste masa administrative në rast konstatimi të shkeljeve të ndryshme nga abonentët, po kështu është shfuqizuar dhe neni 46/1, i cili përcaktonte masën e gjobës për llojin e shkeljes, mënyrën e vjeljes së gjobës, si dhe dëmin ekonomik. Në këto kushte gjykata konstaton se pala e paditur nuk mund të përcaktojë në faturë tatimore shitje dëmin ekonomik si titull ekzekutiv, por në rast se kjo palë ka pretendime lidhur me shkaktimin e ndonjë dëmi për parregullsi të vulave të matësve apo furnizimin me një linjë të dytë nga paditësi, duhet t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi me objekt shpërblimi dëmi ekonomik dhe jo ta përfshijë këtë dëm ekonomik të pretenduar prej saj në një faturë tatimore shitje të energjisë elektrike e cila është titull ekzekutiv.... Fakti që i padituri nuk duhet të faturojë në faturën e energjisë elektrike dëmin ekonomik rezulton dhe nga vendimi nr. 90, datë 15.11.2010 i Entit Rregullator i Energjisë Elektrike ku janë konsideruar të paligjshme faturimet e kryera nga i padituri shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. ndaj klientëve familjarë dhe jofamiljarë, me emërtim “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur” pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008... Gjykata vlerëson se neni 51/14 i ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar nga ai nr. 10362/2010 përcakton mënyrën e llogaritjes së dëmit në rast se shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. i shkaktohet ndonjë dëm dhe nuk përcakton se dëmi ekonomik është titull ekzekutiv. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin objekt gjykimi.*

104. Këtë qëndrim të mbajtur nga të dyja gjykatat më të ulëta, Kolegji e gjen të padrejtë, pasi është rrjedhojë e mungesës së hetimit të plotë gjyqësor të çështjes, si dhe të interpretimit të gabuar të ligjit material. Gjykatat e faktit në interpretim të gabuar të ligjit kanë konstatuar se i padituri nuk ka të drejtë të faturojë dëmin ekonomik duke interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 51/14 të ligjit nr. 9072/2003 e vendimin e ERE-s nr. 42/2011 të ndryshuar. Ky arsyetim bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi në kohën, kur është lëshuar fatura objekt gjykimi, sikurse ka arsyetuar më sipër Kolegji.

105. Në interpretim të drejtë historik, evolutiv, gramatikor, sistematik dhe logjik të ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar me ligjin nr. 10362/2010, ligjit nr. 8662/2000, vendimit të ERE-s nr. 42/2011 në fuqi në kohën e lëshimit të faturës objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se për çështjen gjen zbatim sentenca njëse e konkluduar në këtë vendim se; ***Fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shoqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, dhe ajo e lëshuar sipas ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe akteve nënligjore të ERE-s, të dala në zbatim të secilit ligj në këtë fushë, ka cilësinë e titullit ekzekutiv.***

106. Në rastin konkret në faturën objekt gjykimi, i padituri ka faturuar nën zërin energji e pamatur të faturës, dëmin ekonomik të llogaritur sipas vendimit të ERE-s nr. 42/2011 për shkak të ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin elektrik nëpërmjet një linje dytësore në shmangie të regjistrimit të saj në matës. Pra shkak i faturimit vjen si pasojë e dëmit ekonomik të shkaktuar shoqërisë furnizuese. Sikurse u konkludua më sipër kjo e fundit ka të drejtë të bëjë faturimin e këtij dëmi në faturë, qoftë në zërin “energji e pamatur”, ose ‘dëm ekonomik’ ose “jashtë kushteve teknike” të faturës pasi dëmi ekonomik përbën në vetvete një energji të pamatur nga matësi, por të llogaritur sipas metodologjisë së miratuar nga ERE nr. 42/2011. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se qëndrimi i Gjykatës së Apelit Vlorë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, pasi i padituri nuk ka të drejtë të faturojë dëmin ekonomik, është i pabazuar.

107. Duke qenë se Gjykata e Apelit, ashtu si gjykata e shkallës së parë e ka fokusuar zgjidhjen e çështjes vetëm tek interpretimi i gabuar i ligjit, pa analizuar në themel pretendimet e prapësimet e palëve sipas nenit 12 të KPC-së mbi ekzistencën dhe provueshmërinë e kushteve të ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin elektrik, Kolegji është në pamundësi të jap një vendim përfundimtar për çështjen, pasi si gjykatë ligji nuk ka të drejtë të bëjë vlerësim të provave për herë të parë ose në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e faktit. Faturimi i energjisë së konsideruar të konsumuar si pasojë e dëmit ekonomik bëhet kur vërtetohet ligjërisht gjendja e faktit të ndërhyrjes së paligjshme, që i jep të drejtë shoqërisë furnizuese për të bërë përlllogaritjen e dëmit ekonomik. Pikërisht për të plotësuar hetimin e çështjes dhe vlerësimin e provave lidhur me ndërhyrjen e paligjshme, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të priset duke u kthyer çështja për rigjykim në këtë shkallë gjykimi.

108. Gjykata e Apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve e prapësimeve të palëve sipas shkakut ligjor të padisë dhe as ka bërë vlerësimin e provave të paraqitura nga secili prej tyre për të konkluduar nëse është vërtetuar cenimi i rrjetit elektrik për përfitimin e energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme, si shkak i faturimit të dëmit ekonomik duke shkelur në këtë mënyrë përcaktimet e nenit 6, 14 dhe 16 të KPC-së.

109. Në vijim sa më sipër, Kolegji vlerëson se, Gjykata e Apelit Vlorë duhet të kishte mbajtur në vëmendje faktin se ajo është gjykatë ligji dhe prove, që nënkupton se mangësitë në hetim dhe të vlerësimit të provave të lejuara nga gjykatat e shkallës së parë duhet dhe mund të ishin plotësuar nga Gjykata e Apelit, në përputhje me përcaktimet e nenit 461, pika 6 dhe nenit 465 pika 3 dhe 4 të KPC-së, duke identifikuar çështjet, të cilat nuk ishin hetuar nga gjykata e shkallës së parë, si dhe në varësi të tyre, përcaktimin e faktit nëse hetimi gjyqësor duhet të çelet tërësisht apo pjesërisht. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit në vlerësim të provave duhet t’i jap përgjigje pretendimeve të paditësit dhe të të paditurit duke evidentuar përgjegjësinë e abonentin në ruajtjen e sistemit të matjes e të rrjetit të

shpërndarjes brenda territorit të objektit në administrim të tij, veprimet e paligjshme që ai mund të ketë kryer për përfitimin e paligjshëm të energjisë elektrike, çfarë tipi konsumatori ishte pala paditëse dhe nëse faturimi i energjisë në ngarkim të paditësit ishte kryer apo jo në përputhje me vendimin nr. 42/2011 sipas kategorisë së konsumatorëve, që i përkiste paditësi si abonent jofamiljar. Në përputhje me rezultatet e hetimit në këtë drejtim dhe provat e tjera, kushtet e kontratës së furnizimit të energjisë, të disponojë për vlefshmërinë apo jo të faturës. Po ashtu t'i jepet mundësi palëve të paraqesin prova shtesë në rast se i vlerësojnë të nevojshme.

110. Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim që të hetohen qartësisht faktet e çështjes, sipas detyrave të caktuara nga Kolegji me qëllim që të arrihen në konkluzione të qarta dhe të mbështetura në prova dhe në ligj për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Kolegji mban në vëmendje faktin se, me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, është vendosur se nga data 31.1.2023, gjykatat e apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë ndërpresin veprimtarinë e tyre dhe Gjykata e Apelit Tiranë, nga data 1.2.2023, emërtohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe operon si gjykata e vetme në nivel apeli për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

111. Mungesa e vlerësimit të fakteve dhe provave nga ana e Gjykatës së Apelit, si dhe moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, e vë Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji, në pamundësi për ta zgjidhur këtë çështje në themel të saj, brenda kufijve të saj të gjykimit, duke u fokusuar në një interpretim përfundimtar të mënyrës sesi duhet të aplikohet dhe të zbatohet ligji në këtë rast, si dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e nenit 485, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të KPC-së.

112. Gjatë fazës së rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duhet të mbajë në vëmendje faktin se, si gjykatë ligji dhe prove, ka mundësi që sipas përcaktimeve të nenit 461, pika 6 dhe nenit 465 pika 3 dhe 4 të KPC-së, të riçeli shqyrtimin gjyqësor, duke marrë provat e nevojshme e zbatuar detyrat e caktuara në këtë vendim nga kolegji civil dhe duke ruajtur kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë, të cilat varen nga kufijtë dhe shkaqet e ankimit që kanë investuar gjykatën.

113. Për sa më sipër, ky Kolegji, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në kundërshtim me ligjin material, si i tillë duhet të prishet dhe të dërgohet çështja për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.

114. Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 485, të Kodit të Procedurës Civile, ky vendim që njëson praktikën gjyqësore botohet në Fletoren Zyrtare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 481 e vijues, 485, pika 1/c, 485, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 117, datë 9.2.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.
- Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

U shpall sot në Tiranë, më 18.4.2024.

Kryesuese: Margarita Buhali
Anëtarë: Sokol Ngresi, Enton Dhimitri
Anëtarë kundër: Vojsava Kola, Valbon Çekrezi

MENDIM PAKICE
Për çështjen civile nr. 11243-01311-00-2016 regjistri

Ne gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Vojsava Kola kemi votuar për mospranimin e rekursit të bërë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, me arsyetim që është zbatuar drejt ligji material në fuqi, në çështjen që i përket:

PADITËS: Haxhi Nezha.

I PADITUR: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.).

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

OBJEKTI: Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv, fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike me nr. F-138694, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, për sasinë prej 10.000 Kw, në vlerë totale 146,400 lekë e faturuar si energji e pamatur pasi detyrimi nuk ekziston.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 50, 154, 510/e, 609 të Kodit të Procedurës Civile; ligji nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001; nenet 45, 46, 51, 52, të ligjit nr. 9072, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008; vendimi nr. 49, datë 21.10.2004 i Entit Rregullator të Energjisë “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik.

Duke pasur parasysh shkaqet e ankimit dhe rrethanat e provat e paraqitura në gjykim, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se Kolegji i Gjykatës së lartë **duhet të kishte vendosur: Mospranimin e rekursit të bërë nga OSHEE sh.a. kundër vendimit nr. 117, datë 9.2.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë i cili çmohet se është si një vendim i bazuar në prova dhe në ligj.**

Konkretisht Kolegji Civil i gjykatës së lartë me vendimin e datës 18.4.2024 vendosi prishjen vendimit të apelit dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për rigjykim për realizimin e hetimeve shtesë në drejtëm të pretendimeve të ngritura në rekurs, ndërkohë vlerësoi përfundimisht se në rastin objekt gjykimi dy gjykatat e faktit kanë interpretuar dhe zbatuar keq ligjin material. Gjithashtu në lidhje me sentencën e ngritur për njehsim ky kolegji konkludoi si më poshtë vijon:

Fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shoqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, dhe ajo e lëshuar sipas ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe akteve nënligjore të ERE-s, të dala në zbatim të secilit ligj në këtë fushë, ka cilësinë e titullit ekzekutiv.

Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit dhe referuar fakteve të pranuar nga gjykatat rezulton se paditësi Haxhi Nezha, si abonent jofamiljar, ka lidhur një kontratë furnizimi nr. 138694, me palën e paditur shoqëria CEZ shpërndarje sh.a., sot Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group (këtu e në vijim OSHEE Group sh.a.) për furnizimin me energji elektrike të lokalit që ka në fshatin Jeta e Re, Lushnjë. Sipas kontratës rezulton se furnizuesi (i padituri) ka marrë përsipër që të furnizojë paditësin me energji elektrike dhe ky i fundit të paguajë detyrimin e shprehur në faturën mujore sipas energjisë

elektrike të harxhuar efektivisht. Për të matur energjinë elektrike pala e paditur ka vendosur aparate matëse të energjisë elektrike. Palët kontraktuese kanë qenë korrekte me njëra tjetrën në përmbushjen e detyrimeve kontraktore të ndërsjella.

2. Në datën 20.10.2011, pala e paditur ka ushtruar kontroll në lokalin e paditësit Haxhi Nezha në fshatin Jeta e Re. Për këtë kontroll është mbajtur procesverbali me numër serie 0066095, i cili nuk ka nënshkrimin e palës paditëse. Sipas këtij procesverbali rezulton se tek abonenti Haxhi Nezha, gjatë kontrollit është konstatuar një linjë e dytë, në momentin që limitatori ishte i stakuar ekspresi i kafesë në ambient rezultonte me energji elektrike. Në procesverbal është konstatuar se dëmi ekonomik është 20.000 kwh.

3. Mbi bazën e këtij procesverbali të mbajtur në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur, pa prezencën e palës paditëse, shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., në datën 8.11.2011 i ka faturuar si energji të pamatur dëmin ekonomik 10,000 kwh për periudhën 13.10.2011–30.10.2011 në shumën 146.400 lekë, paditësit Haxhi Nezha.

4. Pala paditëse Haxhi Nezha, duke mos qenë dakord me këtë faturim, ka investuar me padi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv që është fatura e energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011.

5. Në përfundim të këtij gjykimi, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 458(64-2014-1105), datë 7.7.2014, ka vendosur:**

“Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësi Haxhi Nezha.

Heqjen e detyrimit të parashikuar në faturën tatimore të shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, si energji e pamatur në shumën 146,400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë, që i ka faturuar pala e paditur Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a., palës paditëse Haxhi Nezha, adresa fshati Jeta e Re.(...)”

6. **Në vendimin e mësipërm, kjo gjykatë ka arsyetuar,** në formë të përmbledhur ndër të tjera se; Me ndryshimet që i janë bërë ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008 është shfuqizuar neni 46/c i cili i jepte kompetencë të paditurit që të vendoste masa administrative në rast konstatimi të shkeljeve të ndryshme nga abonentët, po kështu është shfuqizuar dhe neni 46/1, i cili përcaktonte masën e gjobës për llojin e shkeljes, mënyrën e vjeljes së gjobës, si dhe dëmin ekonomik. Në këto kushte gjykata konstaton se pala e paditur nuk mund të përcaktojë në faturë tatimore shitje dëmin ekonomik si titull ekzekutiv, por në rast se kjo palë ka pretendime lidhur me shkaktimin e ndonjë dëmi për parregullsi të vulave të matësve apo furnizimin me një linjë të dytë nga paditësi, duhet t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi me objekt shpërblimi dëmi ekonomik dhe jo ta përfshijë këtë dëm ekonomik të pretenduar prej saj në një faturë tatimore shitje të energjisë elektrike e cila është titull ekzekutiv.

6.1 Legjislatori ka përcaktuar se fatura tatimore që lëshon i padituri shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. është një faturë tatimore shitje e energjisë elektrike, ku përcaktohet vetëm sasia e energjisë elektrike e shprehur në kV/h dhe në lekë që ka konsumuar abonenti. Fakti që i padituri nuk duhet të faturojë në faturën e energjisë elektrike dëmin ekonomik rezulton dhe nga vendimi nr. 90, datë 15.11.2010 i Entit Rregullator i Energjisë Elektrike ku janë konsideruar të paligjshme faturimet e kryera nga i padituri shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. ndaj klientëve familjarë dhe jofamiljarë, me emërtim “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur” pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008. Në këto rrethana vlerësohet nga gjykata se fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, ku përcaktohet dëmi ekonomik në shumën 10,000 kV/h, e faturuar nga i padituri për paditësin Haxhi Nezha në shumën totale 146,400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë është e pavlefshme, pasi dëmi ekonomik nuk mund të faturohet me faturë tatimore shitje të energjisë elektrike e cila është titull ekzekutiv.

6.2 Titull ekzekutiv është fatura e energjisë elektrike që përcakton vetëm energjinë e konsumuar dhe jo dëmin ekonomik siç ka pretenduar dhe në gjykim pala e paditur.

6.3 Pala e paditur ka pretenduar se në bazë të nenit 51 pika 14 të ligjit nr. 10362, datë 16.12.2010 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” shprehimisht parashikohet: “Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”. Dhe ERE në zbatim të këtij ligji ka miratuar metodologjinë e përcaktimit të dëmit. Gjykata vlerëson se ky nen përcakton mënyrën e llogaritjes së dëmit në rast se shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. i shkaktohet ndonjë dëm dhe nuk përcakton se dëmi ekonomik është titull ekzekutiv.

6.4 Nga sa më sipër gjykata konkludon se titulli ekzekutiv që është fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike nr. 111725999, datë lëshimi 8.11.2011, për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, që i padituri i ka faturuar paditësit Haxhi Nezha, në rubrikën energji e pamatur 10,000 këh në vlerën 146,400 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind) lekë është i pavlefshëm, pasi titull ekzekutiv është faturimi i energjisë elektrike i konsumuar dhe jo dëmi ekonomik.”

7. Gjykata e Apelit Vlorë, që ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e palës së paditur OSHEE sh.a., me vendimin nr. 117 datë 9.2.2016, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 458(64-2014-1105), datë 7.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.”

7.1 Në vendimin e mësipërm kjo gjykatë ka arsyetuar, në formë të përmbledhur ndër të tjera se: Është e vërtetë se para ndryshimit të legjislacionit në fushën e energjisë elektrike përcaktohej se në rast të konstatimit të disa parregullsive, furnizuesi vendoste masa administrative, që përfshinte caktimin e një gjobe dhe të një dëmi të caktuar, që mendohej se i ishte shkaktuar entit shpërndarës, porse kjo dispozite ligjore është shfuqizuar që në muajin shtator të vitit 2008, me ligjin nr. 9997 datë 22.9.2008. Pra me ndryshimin e ligjit nuk ekziston me hapësira ligjore për të mundësuar detyrimin e abonentit për ngarkim me një dëm, dhe me të drejtë gjykata ka konkluduar që as në kontratë nuk mund të përcaktohet një e drejtë e tillë, dhe në vijim të kësaj as në faturën përkatëse të energjisë nuk mund të parashikohet një element i tillë.

7.2 Po kështu drejt ka vepruar gjykata edhe kur ka rrëzuar pretendimin e palës së paditur se paditësi i ka shkaktuar dëm, dhe se në bazë të nenit 608 të KC-së atyre ju lind e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Përfundimi i Gjykatës se pala e paditur, ka përllogaritur një dëm ekonomik, që ia ka faturuar paditësit, pa e pasur këtë të drejtë më në bazë të ligjit, është i drejtë. Në këtë rast pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke i ngarkuar paditësit, një detyrim që nuk ekziston, pasi një detyrim i tillë jo vetëm që nuk provohet se duhet ngarkohet abonentit për shkak të ndonjë veprimi të padrejtë të kryer prej tij, por as nuk mund të vendoset me nga vetë pala e paditur CEZ sh.a.

7.3 Duke iu referuar mosmarrëveshjes në këtë gjykim nuk kemi të bëjmë me rastin e parashikuar nga pika IV.9 e Kodit të Matjes, pasi ajo aplikohet vetëm kur konstatohen pasaktësi në sistemin e matjes dhe jo ndërhyrje të kundërligjshme në sistem, sikurse është rasti konkret. Po kështu, ndryshe nga sa pretendohet në ankim, pala e paditur nuk ka të drejtë që me cilësinë e furnizuesit të legjitimohet të vendoste detyrime ekonomike në mënyrë të njëanshme qoftë në procesverbalin e konstatimit të dëmit apo edhe në faturën e energjisë elektrike për abonentin familjar dhe jofamiljar.

7.4 Në qoftë se pala e paditur ka konstatuar dëm ekonomik në veprimet e paditësit mund t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen ligjore të mosmarrëveshjes në lidhje me dëmin e pretenduar si të shkaktuar prej saj. Si përfundim, Gjykata e Apelit, çmon se dëmi ekonomik, që në rastin konkret është vendosur si masë administrative për shkak të furnizimit jashtë kushteve teknike, nuk ka bazë ligjore dhe për pasojë vendosja e të ashtuquajturit “Dëm ekonomik”, i vendosur në faturën e energjisë e muajit tetor 2011 për abonentin jofamiljar Haxhi Nezha, është i paligjshëm, duke sjellë si pasojë që edhe fatura konkrete si titull ekzekutiv për këtë pjesë të jetë e paligjshme.

9. Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. (sot Shoqëria OSHEE Group sh.a.), e cili kërkon: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë”, dhe parashtruar shkaqet si vijon:

- Paditësi Haxhi Nezha është abonent i shoqërisë tonë me kontratën nr. 138694. Paditësi kërkoj deklarinimin e pavlefshëm të titullit ekzekutivë (fatura tatimore e shitjes se energjisë elektrike) nr. F-138694, datë lëshimi 8.11.2011 për periudhën e faturimit 13.10.2011–30.10.2011, për sasinë prej 10.000 KËH, në vlerën totale 146.400 lekë, e faturuar si energji e pamatur pasi detyrimi nuk ekziston në bazë të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

- Neni 609 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohej se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.

- Në këto raste, gjykata shqyrton shpejt çështjen dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci.

- Nga interpretimi i dispozitës se mësipërme rezulton se kjo padi që të pranohet nga gjykata, kërkon plotësimin e njëkohshëm të disa kushteve të domosdoshme: 1) Akti që goditet duhet të jetë titull ekzekutiv pra të përfshihet në një nga kategoritë e parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile; 2) Padia mund të ngrihet vetëm nga debitori i titullit ekzekutiv, pra nga pala e ngarkuar me përmbushjen e detyrimit; 3) Titulli ekzekutiv duhet të jete prekur nga “vese të tilla” që e bëjnë atë të pavlefshëm, vese që lidhen me formën apo me përmbajtjen e titullit.

- Neni 510 i KPC-së, ka të përcaktuar qartë se cilët janë tituj ekzekutive. Midis të tjerave janë tituj ekzekutiv 510/e “... aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë”. Në bazë të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” të ndryshuar, fatura tatimore e konsumit të energjisë, është titull ekzekutiv. (Kushti i parë përmbushet)

- Pala paditëse, në emër të së cilës është lëshuar kjo faturë tatimore shitje energjie elektrike duke u ngarkuar me detyrimin e pagimit të vlerës së parashikuar në faturë, merr cilësinë e debitorit të këtij titulli edhe si e tillë gëzon legjitimitimin aktiv për të ngritur këtë padi. (Kushti i dytë përmbushet)

- Sa i përket kushtit të tretë titulli ekzekutiv mund të jetë i pavlefshëm në dy raste: i. Për shkak të mungesës së formës; ii. Për shkak të elementeve që lidhen me përmbajtjen, themelin e tij.

- Rasti i dytë do të thotë që detyrimi të mos ekzistojë, të jetë në një masë më të vogël apo të jetë shuar më pas. Në këndvështrim të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, me pavlefshmëri të titullit ekzekutiv për shkak të mosekzistencës se detyrimit kuptohet ajo situatë kur dikush detyrohet të kryejë një veprim të caktuar pa pasur shkak ligjor që ta kryejë atë, sepse detyrimet e përcaktuara në titullin ekzekutiv janë në vetvete të paligjshme.

- Lidhur me formën e titullit ekzekutiv, fatura tatimore e konsumit të energjisë është tërësisht në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe nenin nr. 51/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” që përcakton se; “Energjia elektrike e përdorur nga klienti lexohet dhe faturohet nga furnizuesi sipas regjistrimeve të aparatit matës” ndërsa në pikën 6.1.1 të Kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin familjar, përcaktohet se; “Klienti do të paguajë detyrimin e shkruar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), nga data 2 deri në fund të muajit pasardhës.”

- Nga rrethanat e faktit rezulton e provuar se klienti Haxhi Nezha për shkak të faturimit më pak se konsumi faktik i energjisë elektrike i është shmangur dispozitave të sipërcituara, pra pagesës së konsumit faktik të energjisë elektrike të realizuar prej tij.

- Në nenin 51 pika 14 të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se “Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”. Me vendimin nr. 42, datë 22.4.2011, ERE miratoi metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik. Në këtë vendim përcaktohet shprehimisht se dëmi ekonomik i korrespondon vlerës në lekë të energjisë së konsumuar mesatarisht nga një konsumator tipik. Për më tepër, edhe llogaritja e dëmit ekonomik (në vlera monetare) bazohet në çmimet e blerjes së energjisë për kategoritë e konsumatorëve. Kjo do të thotë se dëmi ekonomik llogaritet në bazë të konsumit mesatar të konsumatorëve të grupit ku bën pjesë. Në këtë kuptim, dëmi ekonomik duhet të përfshihet në bilancin e energjisë, duke qenë se përfaqëson energjinë e konsumuar nga klienti/jo klienti.

- Për të përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik, vendimi i ERE-s në mënyrë eksplicite konsideron konsumin mesatar të energjisë sipas grupit të konsumatorëve, mbi të cilin aplikohet çmimi i rregulluar dhe jo çmimi i tregut. Rrjedhimisht edhe ERE në metodologjinë e saj të aplikimit të dëmit ekonomik ka adoptuar një model që “bazohet mbi konsumin” dhe jo një model që bazohet mbi sanksionin. Koncepti i dëmit ekonomik ka të bëjë me rikuperimin e vlerës monetare të energjisë së vjedhur (përveç dëmit që i shkaktohet rrjetit) dhe ky koncept aplikohet për çdo periudhë kohe gjatë së cilës është kryer një lidhje e paligjshme. Sa më sipër i padituri ka të drejtë që të konstatojë lidhjet e paligjshme, si dhe të aplikojë dëmin ekonomik për konsumatorët përkatës sipas niveleve të përcaktuara në vendimin nr. 42 të Entit Rregullator të Energjisë të ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.7.2012 “Për miratimin e disa ndryshimeve në metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik”.

- Aplikimi i dëmit ekonomik nga ana e paditur është kryer edhe në përputhje me Kodin Civil. Kështu, neni 608 i Kodit Civil përcakton “*Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.*”. Siç del e provuar, paditësi me veprimet e tij ka realizuar shmangien e një faturimi të drejtë të energjisë elektrike të konsumuar, për qëllim përfitimin pa të drejtë, duke na shkaktuar dëm ekonomik.

- Neni 609 i Kodit Civil, përcakton se “*Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.*”. Rezulton e provuar se dëmi që na është shkaktuar për shkak të ndërhyrjes në matës është pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të paditësit. Në kuptim të 608 dhe 609 të Kodit Civil që të ekzistojë “përgjegjësia për shkaktimin e dëmit” duhet të ekzistojnë: veprimi i paligjshëm e me faj, dëmi real i shkaktuar dhe lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (dëmit të shkaktuar). Rezultojnë plotësisht të provuar se ekzistojnë këto “elemente”, pasi; ndërhyrja në aparatin matës referuar dispozitave të sipërcituara është veprim i kundërligjshëm, veprimi është plotësisht me faj pasi paditësi është person madhor me zotësi të plotë për të kuptuar veprimet dhe mosveprimet e tij, dëmi është veprim i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes në aparatin matës të energjisë, pra ekziston lidhja shkakësore midis veprimit të paditësit dhe pasojës së ardhur.

- Pra, aplikimi i sasisë së energjisë elektrike në faturën objekt gjykimi në rubrikën “energji e pamatur” është bërë bazuar në: 1) Kodin Civil, nenet 608 e vijues; 2) ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar (neni 51); 3) vendimin nr. 42, datë 22.4.2011, të ERE-s “Metodologjia e llogaritjes së dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme” i ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.7.2012, “Për miratimin e disa ndryshimeve në metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik”.

- Paditësi (i furnizuari) është furnizuar rregullisht me energji elektrike nga ana e paditur. Pra, kontrata ka prodhuar plotësisht efektet e saj të dëshiruara nga pala paditëse, por jo efektet e dëshiruara nga pala e paditur, pra nuk jemi shpërblyer me çmimin për energjinë e konsumuar realisht. Pra, duke qenë se aplikimi i dëmit ekonomik është kryer në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë, titulli ekzekutiv edhe në përmbajtje të tij është plotësisht i ligjshëm.

II. Vlerësimi i gjyqtarëve në pakicë

Si gjyqtarë në pakicë kemi votuar kundër këtij konkluzioni mbi njehsimin e praktikës gjyqësore, si dhe disponimit për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, pasi për mendimin tonë të dy vendimet e gjykatave të faktit kanë analizuar dhe zbatuar drejt ligjin duke dhënë dhe zgjidhje të drejta mbi çështjen konkrete. Vendimi i Kolegjit Civil për kthimin e çështjes për rigjykim jo vetëm që nuk ka baza ligjore pasi interpretimi i ligjit të zbatueshëm është i drejtë dhe i saktë, por as edhe mundësi aktuale për t'u realizuar duke pasur parasysh që fatura objekt kundërshtimi dhe matësi konkret i përkasin viti 2011 (rreth 13 vjet para).

Së pari, lidhur me themelin e çështjes, çmon të ritheksojë se padia me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, e rregulluar nga neni 609 të KPC-së, është një gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv. Titujt Ekzekutiv parashikohen në mënyrë të listuar dhe referuese në nenin 510 të KPC-së. Ndër të tjera, kjo dispozitë parashikon se *“Janë tituj ekzekutivë: ... e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quben tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre.”*

Në përputhje me këtë parashikim ligjor, ligji nr. 8662, datë 18.9.2000 *“Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”*, i ndryshuar me ligjin nr. 8735, datë 1.2.2001, *“Për një shtesë në ligjin nr. 8662, datë 18.9.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike”*, nëpërmjet nenit 1 shprehet se *“Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbartimit me ekzekutimin e tyre.”*

Sa më lart, është e qartë se titull ekzekutiv është fatura nominale e konsumimit mujor të energjisë elektrike dhe si e tillë, apo e grupuar për të njëjtin shkak, kundërshtimi duhet të hetohet edhe nga gjykatat në çështjet me objekt pavlefshmërinë e këtyre titujve ekzekutivë. Edhe në rast se shohim modelin tip të miratuar nga Ministria e Financave, kontratën tip të furnizimit të energjisë elektrike të abonentëve familjar dhe elementët e specifikuar të faturës, në nenin 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar”*, i ndryshuar, në asnjë zë të saj nuk pasqyrohet termi *“dëm ekonomik”* apo *“energji jashtë kushtit teknik”*, por vetëm energjia e konsumuar e cila si rregull matet dhe pasqyrohet në mënyrë periodike çdo muaj në faturën e energjisë elektrike, titull ekzekutiv sipas ligjit.

Ndryshe nga ky rregullim ligjor, në çështjen konkrete, pala e paditur, në faturën tatimore të energjisë elektrike, objekt gjykimi, të shndërruar në titull ekzekutiv, krahas konsumit të energjisë elektrike sipas matësit, ka vendosur edhe një shumë *“energji e pamatur”*, dëm që sipas saj i është shkaktuar nga paditësi, si pasojë e marrjes së energjisë elektrike nëpërmjet një linje të dytë në ambienti për të cilin ishte lidhur kontratë e furnizimit me energji elektrike, kategoria jofamiljar. Në si gjyqtarë në pakicë, vlerësojmë se baza ligjore e përmendur më sipër nuk i njeh të gjitha të drejtat që gjeneron kontrata për llogari të entit shpërndarës të energjisë elektrike, në cilësinë ligjore të titullit ekzekutiv.

Në mënyrë taksative, kufizuese dhe eksplicite ligji ia njeh këtë cilësi ekskluzivisht vetëm së drejtës/detyrimit që emeton fatura e energjisë elektrike, konkretisht çmimit të energjisë elektrike të konsumuar në periudhën respektive, që mbulon ajo faturë konkrete.

Në të tilla raste, legjislatori ka specifikuar dhe identifikuar një të drejtë të posaçme së cilës qëllimisht i ka veshur cilësinë ligjore të titullit ekzekutiv, ndaj ligji shprehet qartësisht, fillimisht në titull e më pas në nenin 1 të tij, respektivisht se *“...trajtimi si titull ekzekutiv i faturës së konsumit të energjisë elektrike...”* apo *“Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike...është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbartimit për ekzekutimin e tyre.”*

Ky konkluzion nuk pas sjell mohimin e mundësisë së gëzimit të së drejtës së entit shpërndarës për t'u shpërblyer për dëmet e shkaktuara atij nga veprimet e konsumatorëve të energjisë elektrike, përkundrazi kjo e drejtë mund dhe duhet të sanksionohet gjyqësisht, nëpërmjet kërkesëpadisë në një gjykim me palë kundërshtare (*juridictio contenciosa*).

Vlerësimi i njëanshëm i dëmit nga njëra palë kontraktore dhe cilësimi i tij si titull ekzekutiv direkt i ekzekutueshëm, është abuziv dhe do të linte palën më të dobët në këtë marrëdhënie juridike, në kushte pabarazie, tërësisht të pambrojtur kundrejt interpretimeve dhe iniciativave të palës tjetër. Në rastin konkret, pjesa e faturave që tregojnë një gjë të tillë janë thjesht një paralajmërim që i bëhet palës tjetër kontraktore për të qenë korrekt dhe i kujdesshëm në ekzekutimin e detyrimit kontraktor dhe jo pjesë integrale e faturës që ligji i njeh cilësinë e titullit ekzekutiv, pra direkt i ekzekutueshëm. Nuk mund të njëjtësohet çdo e drejtë e parashikuar në kontratë vetëm nga fakti i përfshirjes fizikisht në faturë apo jo, me qëllimin e Ligjvënësit që ka specifikuar qartësisht vetëm një të drejtë të aftë, që pa iu nënshtruar verifikimit kontradiktor gjyqësor, të konstitujë marrëdhënien juridike të ekzekutimit të detyrueshëm.

Vlerësojmë se në gjykime të tilla, të iniciuara me padi sipas nenit 609 të KPC-së, para gjykatave të faktit, objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor, sipas një vlerësimi *apriori*, është vetëm nëse detyrimi i pasqyruar në faturën tatimore të energjisë elektrike, nga pala e paditur, është apo jo pjesë e titullit ekzekutiv. Kjo do të thotë se gjykatat nuk kanë detyrimin t'ia nënshtrorjnë hetimit dhe debatit gjyqësor bazueshmërinë në ligj dhe në prova të pretendimeve të palës së paditur për dëmin ekonomik të shkaktuar nga energjia e pamatur. Pretendime të tilla mund të jenë objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor vetëm në gjykime të iniciuara nga enti shpërndarës me qëllim shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga konsumatori i energjisë elektrike.

Ky konkluzion arrihet nga një interpretim i drejtë, literal, i saktë dhe në përputhje me parimet kryesore të ligjshmërisë që i bëhet legjislacionit në fushën e energjisë elektrike të cilat po i citojmë më poshtë, por edhe parimeve të përcaktuara nga Kodi Civil me marrëdhënie kontraktore të kësaj kategorie.

Përkatësisht fatura e energjisë elektrike, e konsideruar si titull ekzekutiv i vlefshëm nga pala e paditur, është emetuar në muajin nëntor të vitit 2011. Në këtë kohë ka qenë në fuqi ligji nr. 9072/2003 i ndryshuar. Dëmi ekonomik dhe metodologjia e përlllogaritjes së tij parashikohej si e drejtë dhe kompetencë e ERE-s për ta normuar përmes një akti nënligjor normativ. Pika 14 e nenit 51 të ligjit nr. 9072/2003, i ndryshuar, parashikon se: “14. *Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE-ja.*”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 118 të Kushtetutës dhe në bazë dhe për zbatim të pikës 14 të nenit 51 të ligjit nr. 9072/2003 të ndryshuar, ERE ka miratuar vendimin nr. 42/2011 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes dhe faturimit të dëmit ekonomik”.

Në këtë vendim ERE, saktësisht pika 2 e Metodologjisë së Llogaritjes së Dëmit Ekonomik Shkaktuar Kompanisë së Shpërndarjes nga Ndërhyrjet e Paligjshme ka parashikuar se: “*Kjo Metodologji do të jetë e zbatueshme në rastet kur një entiteti të caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëm ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme të rrjetin elektrik në kompanisë së shpërndarjes.*”

Pikërisht ky togfjalësh “**entiteti i caktuar me ligj**” të cilin vetë ligji dhe vendimi i ERE-s nuk e ka përcaktuar saktësisht se kush është, por ka përdorur një shprehje të përgjithshme, të papërcaktuar dhe abstrakte e cila duhej të plotësohej me parashikime të tjera ligjore apo nënligjore, është interpretuar, saktësuar apo plotësuar nga vendimi i shumicës në këtë vendim njehsues, duke e theksuar se ky entitet është pikërisht Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, apo thënë ndryshe pala furnizuese e kësaj energjie. Pra pavarësisht se kjo e drejtë e OSHEE-së nuk është parashikuar as në ligjin për sektorin e energjisë elektrike, as në ligjin për parashikimin e faturës së energjisë elektrike si titull ekzekutiv, madje as në vendimin e ERE-s si akt i një enti juridik i rregulluar me ligj të posaçëm, me një interpretim të përgjithshëm të dispozitave të këtij fundit, shumica ka plotësuar ligjin në rastin konkret.

Gjithashtu, çmojmë se referuar parashikimit të vendimit të ERE-s nr. 42, datë 22.4.2011, në mungesë të një parashikimi konkret në ligjin e posaçëm, nuk mund të jetë vetë shoqëria Furnizuese për të bërë llogaritjen e dëmit ekonomik sipas kësaj metodologjie, por do të jetë pikërisht një entitet i

caktuar me ligj. Duke ju referuar ligjit të posaçëm, nuk parashikohet në asnjë dispozitë se furnizuesi mund të përllogarisë dëmin ekonomik që mund t'i shkaktohet nga ndërhyrjet në matës, dhe kështu OSHEE sh.a. “nuk është entiteti i caktuar me ligj” të cilit i duhet të bëjë llogaritjen e dëmit ekonomik dhe që të zbatojë në këtë rast metodologjinë e parashikuar në këtë vendim. Kjo vjen në përputhje edhe me ndryshimet që kanë ndodhur në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”. Konkretisht, para daljes së ligjit nr. 9997, datë 22.9.2008 “Për ndryshimin e ligjit ‘Për sektorin e energjisë elektrike’”, vendosja e masave administrative ku përfshihej si gjoba ashtu edhe përllogaritja e dëmit ekonomik ishin prerogative e furnizuesit, sipas nenit 46 dhe 46/1 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”. Neni 46/1 parashikonte llojet e masave administrative që mund të vendoseshin nga struktura pjesë e shoqërisë furnizuese në rast të cenimit të aparateve matëse, ku përfshihen si gjობat ashtu edhe llogaritja e dëmit ekonomik. Këto dispozita u shfuqizuan me ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008. Me hyrjen në fuqi të këtij të fundit, llogaritja e dëmit ekonomik të shkaktuar furnizuesit për shkak të cenimeve të aparatit matës nuk mund të bëhej më nga furnizuesi. Si rrjedhojë, është vetë ligjvënësi i cili ka vendosur që të mos jetë shoqëria furnizuese ajo që do të mund të llogarisë dëmin ekonomik, dhe si rrjedhojë në mungesë të një parashikimi konkret në ligj, nuk mund të jetë shoqëria OSHEE ajo që legjitimohet të llogarisë dëmin ekonomik dhe t’ia faturojë paditësit në faturën objekt gjykimi dhe për më tepër t’i japë asaj fuqinë e titullit ekzekutiv, sikurse dhe është konkluduar në këtë vendim njëhjesues.

Referuar situatës konkrete të faktit, që përbën objektin e këtij gjykimi, dhe legjislacionit në fuqi të kohës, pala e paditur, për pretendimet e saj duhej të zgjidhte mjetin e duhur juridik për t’i realizuar ato, sikundër mund të ishte padia për njohjen e shkaktimit të dëmit ekonomik dhe detyrimin e subjektit përkatës për shlyerjen e tij, për sa kohë që nuk parashikohet ende nga ligji i posaçëm apo nga ndonjë ligj tjetër si “një entitet i caktuar me ligj” pikërisht për të bërë llogaritjen e dëmit dhe që për llogaritjen e këtij dëmi të mund të zbatojë metodologjinë e parashikuar në vendimin nr. 42, datë 22.4.2011 të ERE-s, dhe ajo që është më e rëndësishmja ta përfshijë atë si pjesë të titullit.

Rezulton se ligji nr. 9072/2003 nuk është më në fuqi që nga viti 2015. Me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (në vijim “ligji nr. 43/2015”) është shfuqizuar ligji nr. 9072/2003. Megjithatë konstatohet se edhe ky ligj e ka trashëguar në rregullimet e tij ligjore parashikimin e pikës 14 të nenit 51 të ligjit nr. 9072/2003. Në pikën 9 të nenit 77 të ligjit nr. 43/2015 parashikohet se: “*ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përllogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.*” Ndërkohë që sërish edhe ligji i ri në asnjë dispozitë të saj nuk parashikon shprehimisht të drejtën e OSHEE-së për të përfshirë në faturën e konsumit të energjisë elektrike (rrjedhimisht për t’i konsideruar si titull ekzekutiv) dëmin ekonomik apo energjinë e pamatur jashtë kushtit teknik.

Konstatojmë gjithashtu se, pavarësisht se ligji i ri nr. 43/2015 nuk ka qenë ligji në fuqi mbi të cilin është nxjerrë fatura objekt gjykimi, dhe nuk ka qenë bazë ligjore e vendimit gjyqësor mbi të cilin u konkludua dhe sentenca njëhjesuese, sërish shumica ka marrë përsëri për të interpretojë edhe këtë ligj të ri, duke tejkaluar në këtë mënyrë edhe kompetencat e veta njëhjesuese lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe të interpretueshëm.

Përveç legjislacionit të posaçëm në fushën e energjisë elektrike të cituar më lart, mbahen në vëmendje edhe **dispozitat e Kodit Civil të RSH** që rregullojnë marrëdhënien e detyrimit në përgjithësi dhe kontratën e furnizimit në veçanti.

Në nenin 772 të Kodit Civil thuhet se: “*Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve. Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti*”, ligjvënësi ka përcaktuar kuptimin e marrëdhënies së furnizimit.

Ligjvënësi ka përcaktuar se që kjo kontratë të quhet e vlefshme dhe të prodhojë pasoja duhet të ekzistojnë katër elementë të domosdoshëm të kontratës si: e para, të ekzistojë pëlqimi (vullneti)

kontraktor i palëve; e dyta, të jetë e mbështetur mbi një shkak të ligjshëm; e treta, të jetë përcaktuar objekti që formon lëndën e kontratës dhe e katërta të ketë formën e caktuar nga ligji.

Në interpretim të këtyre dispozitave palët kanë rënë dakord edhe për mënyrën e shlyerjes së faturës së energjisë elektrike.

Neni 420 i Kodit Civil parashikon se: “*Detyrimet lindin nga kontrata ose nga ligji.*”. Padiësi dhe i padituri kanë lidhur ndërmjet tyre një kontratë për furnizimin me energji elektrike, në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet e palëve. Kur njëra nga palët kontraktore nuk përmbush detyrimet e saj, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe në rast të lindjes së një konflikti për këtë fakt, është gjykata, i vetmi organ i ngarkuar nga ligji për zgjidhjen e tij. I padituri, në qoftë se ka konstatuar se padiësi ka shkelur detyrimet kontraktore, duke marrë dhe konsumuar energji elektrike, e pa pasqyruar në aparatin matës, duhet t’i drejtohet gjykatës me një padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i këtij veprimi.

Vlerësojmë se faturimi nga ana e paditur në zërin “Jashtë kushtit teknik apo dëm ekonomik” përfaqëson në thelb një faturim për të dëmshpërblyer një humbje, me një faturim i cili nuk është faturim i bërë sipas leximit mujor që urdhëron ligji. Palët janë në një marrëdhënie juridike të tillë që rregullohet si nga Kodi Civil ashtu edhe nga ligji specifik, nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008, ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008 dhe ligjin nr. 10362, datë 12.12.2010, dhe nga një kontratë tip e miratuar nga një ent rregullator i krijuar për të garantuar edhe të drejtat e konsumatorit, në kushtet një operatori të vetëm në tregun e furnizimit me energji elektrike.

Veprimet e anës së paditur OSHEE sh.a. për të marrë masa administrative, duke lëshuar fatura për “jashtë kushtit teknik” të vlerësuar prej saj, nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Kodit Civil për rregullimin e marrëdhënieve kontraktore mes palëve apo në ndonjë ligj tjetër.

Sa më sipër del e qartë se nga ana e palës së paditur është vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, për sa i përket procedurës së ndjekur për kontrollin, përlllogaritjen e dëmit ekonomik dhe nxjerrjen e faturës tatimore të shitjes së energjisë elektrike.

Pala e paditur OSHEE sh.a. ka pretenduar se; Sipas parimeve bazë të Kodit Civil, cildo që pëson një dëm për shkak të veprimeve të jashtëligjshme ka interes ligjor dhe është i legjitimuar të kërkojë shpërblimin e dëmit. Zbatimi i këtyre parimeve, nuk i jep të drejtë palës kontraktore të përcaktojë në mënyrë të njëanshme përgjegjësinë e palës tjetër kontraktore për shkaktimin e dëmit. I padituri OSHEE sh.a. (palë kontraktore) në qoftë se pretendon se ka pësuar një dëm ekonomik (pasuror) për shkak të veprimeve të jashtëligjshme të abonentit padiës (pala tjetër kontraktore) mund t’i drejtohet gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit sipas dispozitave të Kodit Civil dhe jo të përcaktojë përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit të pretenduar dhe ta llogarisë dhe ta vendosë vetë atë në mënyrë të njëanshme. Në këtë rast pala që pretendon se i është shkaktuar një dëm nga pala kontraktuese ka detyrimin ligjor të provojë faktin se dëmi është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet e palës kontraktuale, si dhe të përcaktojë masën e dëmit.

Ligjvënësi ka pasur parasysh faturimin e energjisë elektrike sipas kontratës së miratuar, me kushtet e saj të përgjithshme dhe të veçanta, faturimin në çdo muaj të saj, mbi bazën e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar. Si gjyqtarë në pakicë vlerësojmë se rubrika e vendosur në faturën e shitjes së energjisë elektrike në emërtimin “Jashtë kushtit teknik”, në thelb është një llogaritje dëmi ekonomik, që është në kundërshtim me ligjin, ndaj është i pavlefshëm. Ndaj këto lloj faturimesh megjithëse vendosen në faturën e shitjes së energjisë elektrike, nuk mund të jenë titull ekzekutiv. Pasi llogaritja e njëanshme e dëmit ekonomik (në rastin konkret në formën e faturimit jashtë kushtit teknik), nga një palë në kontratë, nuk mund të jetë titull ekzekutiv.

Së dyti, si nevojë për këtë njehsim të praktikës gjyqësore, kjo shumicë ka cituar qëndrimet e ndryshme të jurisprudencave të gjykatave të faktit, duke hasur problematika në interpretimin e njëjtë

dhe të barabartë të ligjit nga secila prej tyre. Në fakt pas një studimi paraprak nuk rezulton ajo çka shumica citon si nevojë për njehsim, pra qëndrime të ndryshme të gjykatave në interpretimin e ligjit material në rastin konkret, të cilat janë unison të qëndrueshme dhe të qarta në qëndrimet e tyre për interpretimin e ligjit material në rastin objekt gjykimi, pra lidhur me cilësinë si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik. Përkundrazi e gjithë praktika gjyqësore për vite më radhë në të dyja shkallët, shkallë të parë dhe në apel (dhe më pas në Gjykatën e Lartë me mospranim) ka përvijuar në mënyrë të qartë qëndrimin e saj në përputhje me parashikimet ligjore se përfshirja në faturën e konsumit të energjisë elektrike, e cila përbën titull ekzekutiv, të një zëri të veçantë si “dëmi” apo “energja e pamatur” llogaritur në mënyrë të njëanshme nga ana e OSHEE sh.a., nuk përbën titull ekzekutiv, dhe palët duhet të realizojnë interesat e tyre bazuar në mjetet e parashikuara në legjislacionin shqiptar. Vendimet me qëndrime të ndryshme mbi këtë “të drejtë të gjallë” “tashmë të vendosur nga kjo praktike gjyqësore, janë sporadike dhe të tilla që nuk justifikojnë këtë njehsim në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Pra kjo vendimmarrje në rastin konkret edhe ligjërisht nuk paraqitet si një njehsim praktike, por si ndryshim i praktikës gjyqësore konform nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, e cila duhet të ishte shqyrtuar me Kolegje të Bashkuara të Gjykatë së Lartë. Edhe paragrafi i dytë i të njëjtit nen e rritet faktin se nuk mundet një kolegji me 5 gjyqtarë, në eventualitet edhe të ekzistencës së pakicave si në rastin konkret, të ndryshojë një praktikë të mirëformuar, të konsoliduar dhe konsistente për vite me radhë duke parashikuar konkretisht: “2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi.”

Është e vërtetë që vendi ynë nuk i përket sistemit *common law*, pra nuk jemi të detyruar të ndjekim precedentin gjyqësor si në shtetet e traditës së *common law*, por në ditët e sotme, veprimtaria e gjykatave për interpretimin e normave është e pashmangshme. Gjykatat përmes interpretimit të ligjit në rastet konkrete synojnë të plotësojnë dhe të ndërtojnë kuptimin e tekstit të ligjit, i cili nuk mund të merret më i mirëqenë, por duhet të ndërtohet. Gjykata tashmë luan një rol kryesor në koordinimin e ligjeve dhe akteve me fuqinë e ligjit, saktësimin e përmbajtjes dhe vlerës së normës, e cila në dinamikën e saj vepruese, “jeton” nëpërmjet interpretimit që i jep gjykata, duke bërë që struktura abstrakte dhe e përgjithshme e normës të integrohet e plotësohet nga aktiviteti konkretizues i jurisprudencës. Në këtë mënyrë krijohet ajo që është quajtur nga doktrina ‘e drejta e gjallë’ ku norma ligjore konsiderohet si një pikënisje statike ndërsa, interpretimi si një fluks i vazhdueshëm që përshtat normën abstrakte me rrethanat konkrete dhe sociale të shoqërisë.

Koncepti i së “drejtës së gjallë”, është elaboruar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Kështu në vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 citohet: Gjykata vlerëson t’i referohet konceptit të së “drejtës së gjallë”, e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një “jurisprudence konstante”, “të konsoliduar” mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo “jeton” në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (*self restraint*) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse. Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legjislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte, por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t’i bëjë konkrete dhe efikase.

Pikërisht duke marrë në konsideratë këtë praktikë të konsoliduar, konsistente dhe të qëndrueshme të gjykatave të faktit mbi çështjen objekt njehsimi dhe gjykimi, çmojmë në konceptin tonë se kjo

vendimmarrje është e gabuar edhe nga pikëpamja procedurale pasi përbën në thelb një ndryshim të praktikës gjyqësore, i cili marrë parasysh edhe impaktin që ka duhej të realizohej nëpërmjet Kolegjeve të Bashkuara. Qëndrimi i mirëformuar dhe konsistent i gjykatave ka qenë dhe është që “vlera e detyrimit e pasqyruar si pasojë e dëmit ekonomik në faturën e energjisë elektrike”, nuk mund të jetë pjesë e faturës dhe rrjedhimisht as titull ekzekutiv, dhe për këtë arsye OSHEE sh.a. nuk ka të drejtë që të përcaktojë vetë se sa është vlera e dëmit të shkaktuar dhe më pas ta përfshijë atë në faturën e shitjes së energjisë elektrike duke e bërë drejtpërdrejt të ekzekutueshëm. Ligji i njëh cilësinë e titullit ekzekutiv, vetëm energjisë së matur sipas regjistrimit të matësit, ndërsa llogaritja e dëmit ekonomik nga njëra palë kontraktore në rastin e ndërhyrjeve në matës ose në rrjetin e shpërndarjes interpretohet si vlerësim i njëanshëm i dëmit në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve në marrëdhënien kontraktore dhe për këtë shkak fatura për këtë pjesë nuk ka cilësinë e titullit ekzekutiv. Në këtë logjikë dëmi ekonomik i pretenduar nga furnizuesi mund të jenë objekt hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor vetëm në gjykata në gjykime të padive me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga konsumatori i energjisë elektrike, paditë këto të iniciuara nga pala e dëmtuar OSHEE sh.a., ku gjykata duhet të përcaktojë nëse ekziston dëmi, vlerën e tij dhe se kujt i ngarkohet sipas nenit 608 e vijues të Kodit Civil.” Mbi këtë argumentim çmojmë se nuk qëndron dhe pretendimi i shumicës se jemi para një “paqartësia të vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore”, por përkundrazi kemi një qartësi të vazhdueshme në kohë, e pajtueshme kjo me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike.

Së treti: Shumica në këtë vendim ka argumentuar se bazuar në një arsyetim historik, gramatikor, tërësor dhe teologjik të parashikimeve ligjore, OSHEE sh.a. ka të drejtë që të faturojë këtë zë të veçantë “dëm ekonomik” të llogaritur prej saj, në faturën e energjisë elektrike, duke i dhënë atij cilësinë e titullit ekzekutiv. Në fakt po të shohim me kujdes dispozitat ligjore të cituara edhe në argumentet më lart, me këtë arsyetim shumica ka krijuar ligj, duke i dhënë fuqi një parashikim ligjor të munguar, në kundërshtim kjo edhe me parimin e ligjshmërisë. Fatura e shitjes së energjisë elektrike është titull ekzekutiv sipas nenit 1 të ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000. Neni 1 i ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000 parashikon se: *“Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre.”* Për llogaritja e dëmit ekonomik sipas prapësimeve të palës së paditur është bërë bazuar në nenit 51 pika 14 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar me ligjin nr. 9913, datë 5.5.2008, ligjin nr. 9997, datë 22.9.2008 dhe ligjin nr. 10362, datë 12.12.2010, dhe vendimit nr. 42, datë 22.4.2011 të Entit Rregullator të Energjisë “Metodologjia e përlllogaritjes së dëmit ekonomik” i ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.7.2012 të ERE-s “Për miratimin e disa ndryshimeve në metodologjinë e llogaritjes së dëmit ekonomik”.

Sipas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë në fjalë, metodologjia e llogaritjes së dëmit ekonomik është e zbatueshme nga një entitet i caktuar me ligj, i cili llogarit dëmin ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të kompanisë së shpërndarjes. Pra, vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nuk ka parashikuar se cili është ky entitet i caktuar me ligj që ka kompetencë të përlllogarisë dhe të vendosë dëm ekonomik dhe aq më pak të ketë përcaktuar se ky entitet është pala e paditur Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Shkodër (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.).

Në kuadër të ligjshmërisë merr rëndësi dhe parimi i përcaktueshmërisë që ka të bëjë me gjuhën dhe fjalorin e përdorur nga ana e ligjvënësit në normën materiale, pra mbi tekstin e dispozitës ligjore. Sa më e saktë të jetë gjuha e përdorur dhe të përcaktueshme konceptet e referuara aq më shumë do të jetë e mundur zbatimi i normës ligjore sipas vullnetit të ligjvënësit dhe sidomos në përcaktimin e saktë të faktit, së drejtës, garancive dhe sanksioneve për shkeljen e saj, duke u siguruar që pushteti gjyqësor të qëndrojë në kontekstin e interpretimit letrar të dispozitës. Këto aspekte të parimit të ligjshmërisë,

mendojmë së në rastin konkret, nuk janë mbajtur parasysh duke i dhënë fuqi ligjore një parashikimi të munguar në ligj.

Referuar këtyre argumenteve dhe arsyetimit të vendimit të gjykatave të faktit arrijmë në përfundimin se vendimi i gjykatës së Apelit Vlorë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se rekursi i OSHEE sh.a. nuk duhej pranuar. Gjithashtu edhe sentenca njehsuese në rastin konkret, duhet të ishte ashtu si dhe praktika gjyqësore e gjithë këtyre viteve ka pranuar, dhe konkretisht: *Fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar me ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, nuk ka cilësinë e titullit ekzekutiv.*

PËR SA MË SIPËR,

Në bazë të nenit 308/1 e 485/b të Kodit të Procedurës Civile

Mendimi ynë në pakicë për zgjidhjen e çështjes është;

- Mospranimin e rekursit të bërë nga OSHEE sh.a. ndaj vendimit nr. 117, datë 9.2.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke e konsideruar zbatimin e ligjit material nga ana e saj si të drejtë.

Anëtarë: Vojsava Kola, Valbon Çekrezi